

2020

Aktiviteti Institucional i FSHZH-së

RAPORT VJETOR

Programet e Investimeve

Realizimi Financiar

Projekte te reja

Auditi i Brendshëm

Monitorimi & Vlerësimi

Ndërtimi i Kapaciteteve

Komunikimi & Informimi



FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
ALBANIAN DEVELOPMENT FUND

SHKURTIME

| | |
|--------|--|
| AEM | Agjencia Ekonomike Mbështetëse |
| AKPT | Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit |
| ARRSH | Autoriteti Rrugor Shqiptar |
| ASHK | Agjencia Shtetërore e Kadastrës |
| BB | Banka Botërore |
| BERZH | Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim |
| BEI | Banka Europiane e Investimeve |
| CEB | Banka e Këshillit të Europës |
| DZHR | Departamenti i Zhvillimit Rajonal |
| FK | Fondi Kuvajtian |
| FS | Fondi Saudit |
| FSHZH | Fondi Shqiptar i Zhvillimit |
| FUZR | Furnzimi me Ujë i Zonave Rurale |
| FZHR | Fondi për Zhvillimin e Rajoneve |
| GoA | Government of Albania - Qeveria Shqiptare |
| IBRD | Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim |
| IPA | Instrumenti i Ndhmës së Paraaderimit |
| ISTN | Instituti i Studimeve Teknologjike Të Ndërtimit |
| IVR | Infrastruktura Vendore Rajonale |
| KD | Komiteti Drejtues |
| KfW | Banka Gjermane për Zhvillim |
| KZHR | Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve |
| MFE | Ministria e Financave dhe Ekonomisë |
| NJAB | Njësia e Auditit të Brendshëm |
| NJVV | Njësitë e Vetqeverisjes Vendore |
| PBA | Projekt Buxheti Afatmesëm |
| PDyV | Plane të Detyruara Vendore |
| PIUTD | Project for Integrated Urban and Tourism Development |
| PK | Punët në Komunitet |
| PKST | Plani Kombëtar Sektorial i Turizmit |
| POZHR | Programi Operacional për Zhvillimin Rajonal |
| PZHIUT | Projekti për Zhvillimin e Integruar Urban dhe Turistik |
| QMMSH | Qendra Multifunksionale për Mbështetjen e Shërbimeve për |
| SR | Sipërmarrjet e reja |
| QSH | Qeveria Shqiptare |
| SME | Small and medium-sized enterprises |
| ToR | Terma Reference |
| WBIF | Kuadri i Investimeve për Ballkanin Perëndimor (Western Balkans Investment Framework) |

TABELA E PËRMBAJTJES

| | | |
|--------|--|----|
| 1. | PËRMBLEDHJE | 5 |
| 1.1. | Misioni i FSHZH-së dhe orientimi i aktivitetit..... | 5 |
| 1.2. | Politikat dhe drejtimet e zhvillimit | 6 |
| 1.3. | Aktorët dhe partneriteti për zhvillim | 7 |
| 1.4. | Financimi i aktivitetit dhe realizimi i limiteve buxhetore..... | 7 |
| 1.5. | Organizimi i brendshëm dhe suporti i aktivitetit | 8 |
| 1.6. | Prokurimi dhe kontraktimi i shërbimeve..... | 9 |
| 1.7. | Rezultatet dhe arritja kryesore | 9 |
| 1.8. | Puna dhe produkte kryesore | 11 |
| 1.9. | Kontrolli dhe përputhshmeria e aktivitetit | 11 |
| 1.10. | Transparenca dhe komunikimi me publikun | 13 |
| 2. | ZHVILLIMI RAJONAL DHE PROGRAMET | 15 |
| 2.1. | Ligji, politikat, takimet, planet e zhvillimit rajonal..... | 15 |
| 2.2. | Portofoli ADF: programet e zhvillimit rajonal dhe vendor | 20 |
| 2.3. | Programet e detajuara..... | 22 |
| 2.3.1. | Programi për Rindërtim dhe Zhvillim në Zonat e Prekura nga Tërmeti | 22 |
| 2.3.2. | Programi i Zhvillimit Rajonal me financim të brendshëm | 23 |
| 2.3.3. | Programi i Zhvillimit të Qëndrueshëm i Integruar në “100 Fshatrat” | 30 |
| 2.3.4. | Programi i Konektivitetit të Rrugëve Rajonale dhe Lokale..... | 30 |
| 2.3.5. | Programi i Rehabilitimit të Rrugës së Lumit të Vlorës | 33 |
| 2.3.6. | Programet e Turizimit dhe Zhvillimit Urban | 34 |
| 2.3.7. | Programi I Rural Water..... | 43 |
| 2.3.8. | Programet IPA dhe grantet nga donatorë | 44 |
| 3. | MENAXHIMI FINANCIAR | 49 |
| 3.1. | Limitet buxhetore dhe ndryshimet në PBA 2020-2022 | 49 |
| 3.2. | Limitet buxhetore dhe ndryshimet në buxhetin e vitit 2020..... | 49 |
| 3.3. | Realizimi financiar sipas programeve për 2020 | 50 |
| 4. | LIGJSHMËRIA DHE MARRËDHËNIET | 62 |
| 4.1. | Marrëveshjet e reja me donatorë dhe qëndrore | 62 |
| 4.2. | Parteneritete me bashkitë..... | 63 |
| 4.3. | Shpronësimet | 64 |
| 4.4. | Gjyqet..... | 66 |
| 5. | PROKURIMI DHE KONTRAKTIMI I SHËRBIMEVE | 69 |
| 5.1. | Programet/projektet në zbatim..... | 69 |
| 5.2. | Baza ligjore dhe rregulloret e ndjekura | 69 |

| | | |
|--------|---|-----|
| 5.3. | Procedurat e prokurimit të zhvilluara sipas kategorive të caktuara..... | 70 |
| 5.4. | Pjesëmarrja e arritur në procedurat e prokurimit..... | 72 |
| 5.5. | Përdorimi i fondeve - uljet mesatare dhe kursimet | 73 |
| 5.6. | Proçesi i ankimimit në procedurat e prokurimit | 73 |
| 6. | MENAXHIMI I PROGRAMEVE | 74 |
| 6.1. | Progresi fizik i programeve të zhvillimit | 75 |
| 6.2. | Menaxhimi i cilësisë së programeve të zhvillimit..... | 90 |
| 7. | ZBATIMI I PROGRAMEVE..... | 91 |
| 7.1. | Projektimi..... | 91 |
| 7.2. | Lejet | 92 |
| 7.3. | Ndërtimi | 95 |
| 7.4. | Shëndeti, siguria, mjedisi dhe përgjegjësia sociale..... | 96 |
| 7.5. | Dorëzimet, kolaudimet, dhënia në përdorim e objekteve | 98 |
| 8. | AKTIVITETI I BRENDSHËM | 99 |
| 8.1. | Strukturat dhe Njësitë Rajonale, rishikimi i procedurave dhe akreditimi i FSHZH. 99 | |
| 8.2. | Menaxhimi i Burimeve Njerëzore | 101 |
| 8.3. | Shëndeti dhe Siguria në Punë | 101 |
| 8.4. | Infrastruktura mbështetëse dhe logjistika e FSHZH-së..... | 101 |
| 8.5. | Protokolli, arkiva, marrëdhënia me të tretët | 102 |
| 9. | AKTIVITETI EKONOMIK..... | 104 |
| 9.1. | Instrumentë të rinj..... | 104 |
| 9.2. | Aktiviteti i Njësive Ekonomike | 107 |
| 9.2.1. | Administrimi dhe funksionimi i shërbimit të parkimit brenda QSUT..... | 107 |
| 9.2.2. | Ndërtimi i godinës së parkimit dhe hapësirave mbështetëse në Berat..... | 108 |
| 9.2.3. | Ndërtimi i godinës së parkimit dhe hapësirave mbështetëse në Gjirokastrë .. | 109 |
| 9.3. | Qendrat e Turizmit: Valbonë, Vermosh, Korçë..... | 109 |
| 9.4. | Qendrat e teknologjisë dhe inovacionit..... | 112 |
| 9.4.1. | Laboratori i fertilizmit të inovacionit FILA | 112 |
| 9.4.2. | Rehabilitimi i ISTN, Betahaus-Tirana..... | 113 |
| 9.4.3. | Projekti për zhvillimin e turizmit në Liqenin Marinez, Bashkia Belsh | 113 |
| 10. | ANEKSE | 114 |
| 10.1. | Aneks 1: Miratimi i buxhetit faktik sipas kategorive përkatëse | 114 |
| 10.2. | Aneks 2: Informacion mbi numrin e kontratave të nënshkruara sipas kategorive dhe programeve | 115 |
| 10.3. | Aneks 3: Informacion mbi vlerën e kontratave të nënshkruara sipas kategorive dhe programeve | 115 |

1. PËRMBLEDHJE

1.1. MISIONI I FSHZH-SË DHE ORIENTIMI I AKTIVITETIT

Fondi Shqiptar i Zhvillimit është organizatë zhvillimore që shënon një eksperiencë 27-vjeçare në zhvillimin e infrastrukturës, urbanizimit, turizmit dhe bashkëpunimit ndërkufitar, duke iu përgjigjur sfidave dhe partnerëve të saj, në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të vendit. Në përmbushjen e funksioneve dhe të kompetencave të parashikuara në ligjin Nr.10 130, datë 11.5.2009, FSHZH-ja synon:

- . përmirësimin e infrastrukturës social-ekonomike vendore;
- . përmirësimin e shërbimeve publike vendore;
- . forcimi institucional i njësisve të qeverisjes vendore;
- . nxitja e qeverisjes së mirë në nivel vendor.

Gjithashtu, Ligji 102/2020 “Për Zhvillimin Rajonal dhe kohezionin” duke përcaktuar FSHZH-në, si Sekretariat i Komitetit Kombëtar dhe Sekretariat i Bordeve të Monitorimit, i caktohet një rol kyç në përgatitjen e dokumenteve të planifikimit dhe programimit të Zhvillimit Rajonal nga njëra anë, dhe nga ana tjetër përcaktimi i FSHZH si Autoritet Menaxhues i jep përgjegjësinë për menaxhimin e programit operacional në përputhje me parimin e menaxhimit të qëndrueshëm financiar dhe arritjen e objektivave e treguesve të matshëm të tij.

Në këtë mënyrë, viti 2020 ka shënuar një zgjerim të rolit të FSHZH-së përgjatë gjithë ciklit të jetës së zhvillimit, si një organizatë që:


- . mbështet hartimin e politikave të zhvillimit rajonal;
- . ka një rol aktiv në hartimin dhe zbatimin e planeve dhe programeve të zhvillimit;
- . menaxhon dhe implementon në bashkëpunim me NJVV programet dhe projektet zhvillimore;
- . hyrjen në treg si një operator zhvillimi, duke ngritur dhe vënë në funksionim modele të integruara zhvillimi në partneritet më njësitë vendore.

FSHZH-ja po hyn në një dekadë të re të funksionimit të saj dhe detyrimisht ky moment kohor duhet të shihet si një cikël i ri i zhvillimit dhe veprimtarisë së vetë institucionit. Për shkak të ndryshimeve të sipërpërmendura lind natyrshëm edhe nevoja e përditësimit ose ripërcaktimit të marrëdhënieve të FSHZH-së me institucionet e tjera.

1.2. POLITIKAT DHE DREJTIMET E ZHVILLIMIT

Përgjate vitit 2020 FSHZH ka orientuar aktivitetin e saj në funksion të zhvillimit rajonal dhe vendor, duke u përpjekur të vlerësojë ndërhyrjet zhvillimore në funksion të realizimit të vizionit për “Shqipërinë që duam” dhe jo duke u përpjekur t’i ikim Shqipërisë që kemi, duke shfrytëzuar potencialet dhe adresuar sfidat e së ardhmes, dhe jo thjesht duke zgjidhur problematikat e se shkuarës apo plotësimit të nevojave të momentit. Në këtë frymë, aktiviteti i FSHZH-së është shtrirë në të gjitha drejtimet e sistemit tonë të jetës, duke synuar zhvillimin e kapaciteteve njerëzore, kapaciteteve prodhuese, ndërveprimit social, kapaciteteve qeverisëse, duke mbrojtur dhe përmirësuar burimet dhe pasuritë natyrore.

Gjatë këtij viti FSHZH ka menaxhuar 15 programe investimesh, 11 programe/projekte me financim të huaj dhe 4 prej tyre me financim të brendshëm. Deri në dhjetor 2020, janë ndjekur punimet për rreth 830 objekte, si dhe janë duke u iniciuar disa programe të reja.



1.3. AKTORËT DHE PARTNERITETI PËR ZHVILLIM

Gjatë aktivitetit të vitit 2020, FSHZH ka vazhduar marrëdhëniet e saj me një numër të madh aktorësh dhe partnerësh për zhvillim sipas kategorive kryesore:

- . Marrëdhëniet me Qeverisjen Qendore, ku veçojmë marrëdhëniet dhe komunikimin e vazhdueshëm me Zyrën e Zv/Kryeministrit, Ministrin e Rindërtimit, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrinë e Mjedisit dhe Turizimit, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, etj., marrëdhënie që lidhen me përcaktimin e prioritetëve, hartimin dhe miratimin e akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe financimin e programeve zhvillimore;
- . Marrëdhëniet me Institucionet Ndërkombetare Financiare të cilat financojnë programe të ndryshme zhvillimi bazuar në marrëveshjet e huave apo të granteve, ku veçojmë, BB, Berzh, KfË, CEB, Fondi Kuvajtian, Fondi Saudit, Delegacioni Evropian, etj
- . Marrëdhëniet me Institucionet e tjera qendore, të cilat lidhen apo kane përgjegjesi të ndryshme në funksion të realizimit të projekteve zhvillimore, si ARRSH, AKUM, OSHE, AKPT, AZHT, etj.
- . Marrëdhëniet me Njësitë Vendore, ku përgjatë aktivitetit të FSHZH-së ka pasur ndërveprim të vazhdueshëm pothuajse me të gjitha njësitë vendore, në funksion të realizimit të projekteve të ndryshme dhe detyrimeve të ndërsjellta sipas marrëveshjeve të investimeve dhe që lidhen kryesisht me pajisjet me leje, shpronësimet, adresimit të problematikave sociale, monitorimin e investimeve dhe marrjen në dorëzim prej tyre, si përfituesit kryesorë të këtyre investimeve.


1.4. FINANCIMI I AKTIVITETIT DHE REALIZIMI I LIMITEVE BUXHETORE

Buxheti i FSHZH për vitin 2020 arrin në vlerën 25,825 milionë Lekë. Buxheti i realizuar gjatë vitit 2020 është rreth 98 % të buxhetit vjetor, pa përfshirë *Programin për Rindërtim dhe Zhvillim në Zonat e Prekura nga Tërmeti*. Periudha ka përkuar me situatën e pandemisë e cila ka sjellë problematika dhe vështirësi në punën e institucionit. Rritja e besueshmërisë ndaj institucionit të FSHZH është reflektuar në rritjen e numrit të projekteve dhe programeve për menaxhim, si dhe njëkohësisht është reflektuar në rritjen e buxhetit të menaxhuar. Referuar një analize të buxhetit të FSHZH në 10 vitet e fundit rezulton se në vitin 2020 buxheti i FSHZH-së është 6-fishuar krahasuar me buxhetin e vitit 2010. Ndërkohë, krahasuar me buxhetin e vitit 2019 është rreth 1,7 herë më i lartë.

Tabela e mëposhtme pasqyron ecurinë e buxhetit të FSHZH-së për periudhën 2010-2020:

Tabela 1. Ecuria e buxhetit të FSHZH-së ndër vite (në mijë Lekë)

| Viti | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 |
|---------|-----------|-----------|-----------|-----------|------------|-----------|-----------|-----------|------------|------------|------------|
| Buxheti | 4,412,393 | 6,719,327 | 7,606,690 | 9,627,055 | 10,584,222 | 9,139,254 | 8,401,230 | 8,550,000 | 10,240,000 | 15,399,000 | 25,825,591 |



1.5. ORGANIZIMI I BRENDSHËM DHE SUPORTI I AKTIVITETIT

Në kuadër të mbështetjes së organizatës për kryerjen me efikasitet të funksioneve të saj, drejtimet kryesore të aktivitetit kanë qenë përshtatja e strukturës dhe procedurave në përputhje me funksionet e reja të deleguara gjatë vitit 2020, menaxhimi i burimeve njerëzore për të garantuar cilësinë profesionale, si dhe sigurimi i infrastrukturës dhe logjistikës së nevojshme për mbarëvajtjen e aktivitetit. Fokus i veçantë i është dhënë sigurisë në punë dhe masave të marra për ruajtjen dhe parandalimin prej Covid -19.

Përgjatë këtij viti, ndërhyrjet strukturore në organizimin e brendshëm të FSHZH-së kanë synuar fuqizimin e njësive rajonale, ngritjen e njësive të menaxhimit dhe fuqizimin e njësive të tjera funksionale në funksion të përballimit të ngarkesës me *Programin për Rindërtim dhe Zhvillim në Zonat e Prekura nga Tërmeti*, si dhe auditimi i jashtëm i bërë nga konsulenti i RDPA-s dhe analiza e boshllëqve për t'u adresuar, në mënyrë që FSHZH të jetë insitucion i akredituar për menaxhimin e fondeve të BE-së për zhvillimin rajonal.

Për vitin 2020, FSHZH-së i janë miratuar shpenzime operacionale në vlerën 570 mln Lekë. Këto shpenzime gjatë janë realizuar në vlerën 452 milionë Lekë ose rreth 80% kundrejt buxhetit të miratuar.

1.6. PROKURIMI DHE KONTRAKTIMI I SHËRBIMEVE

Gjatë vitit 2020 janë ndjekur dhe zhvilluar gjithsej 362 procedura prokurimi. Nga këto peshën kryesore e zënë procedurat për Punë me 113 procedura dhe Shërbim/Shërbim konsulence, me 233 procedura të zhvilluara dhe finalizuara me nënshkrimin e kontratave.

Referuar procedurave të prokurimit të cilat kanë konkluduar me kontrata të nënshkruara, rezulton se nga Fondi Limit prej rreth 60 mld Leke me tvsh janë kursyer rreth 23.5 mld lekë, të cilat përbëjnë **40%** të fondit total të shpallur për tenderim.

1.7. REZULTATET DHE ARRITJA KRYESORE

Gjatë vitit 2020 FSHZH ka menaxhuar dhe vazhdon të menaxhojë nëpërmjet njësive të saj 15 programe të financuara nga burime të ndryshme, si Qeveria Shqiptare dhe nga Donatorët. Njëri prej programeve, ai i Punëve në Komunitet IV financiar nga CEB është finalizuar me sukses në fund të vitit 2020. Programet në zbatim përfshijnë një fushë të gjërë ndërhyrjesh të të gjitha tipologjive, si: infrastruktura rrugore, rikualifikime urbane, ujësjellës-kanalizime, mbrojtje mjedisore, rikonstruksione dhe ndërtim godinash, ndërtime dhe rehabilitime shëtitore, etj. Programet, përveç punimeve fizike, shoqërohen edhe me komponentë soft, siç janë projektimi, mbikëqyrja, kolaudimi, ngritja e kapaciteteve menaxheriale për bashkitë, konsulenca mbi elementët e turizmit, krijimi dhe organizimi i eventeve, etj.

Portofoli i programeve në zbatim arrin një shumë rreth 600 mln \$ e shpërndarë sipas komponentëve të secilit program:

- Programi i Furnizimit me Ujë të Zonave Rurale III realizuar në masën 77%
- Programi i Furnizimit me Ujë të Zonave Rurale IV realizuar 5 %;
- Programi për Zhvillimin e Integruar Urban dhe Turizmin realizuar 16%;
- Programi për Zhvillimin e Integruar të Zonave me Potencial Turistik realizuar 5%;
- Programi Konektiviteti i BB realizuar në masën 40% dhe ai i BERZH realizuar në masën 5%;
- Rehabilitimi i Rrugës së Lumit të Vlorës realizuar në masën 60%;
- Programi i Ndërhyrjeve të Financuara nga Buxheti i Shtetit: GoA01 realizuar në masë 41%;
- Programi i Ndërhyrjeve të Financuara nga Buxheti i Shtetit: IVR realizuar në masën 51%;
- Punët në Komunitet IV realizuar në masën 100%;

- Programi për Rindërtim dhe Zhvillim në Zonat e Prekura nga Tërmeti: Banesat Individuale, realizuar në masen 40%;
- Programi për Rindërtim dhe Zhvillim në Zonat e Prekura nga Tërmeti: Infrastruktura Publike, realizuar në masën 37%;
- Programi për Rindërtim dhe Zhvillim në Zonat e Prekura nga Tërmeti: Banesat Kolektive, realizuar në masën 10%;
- Programi për Rindërtim dhe Zhvillim në Zonat e Prekura nga Tërmeti: Objektet Arsimore, realizuar në masën 75%;

Janë menaxhuar dhe janë në ndjekje gjatë këtij viti mbi 180 kontrata zbatimi.

Ndër arritjet e menaxhimit të programeve të zhvillimit theksojmë se:

- Është realizuar i gjithë objekti i punës i përcaktuar në të gjitha kontratat e mbyllura. Në procesin e rindërtimit, një risi ishte dhe aplikimi i formës së kontratës “me çelësa në dorë”, që garantoi mbylljen e të gjitha objekteve arsimore në një kohë rekord, të plota dhe funksionale, pa asnjë fond shtesë;
- Aktualisht, për të gjitha kontratat e mbyllura apo ato në zbatim, nuk kemi asnjë shtesë kontrate, si pasojë e mirëmenaxhimit të kostove të projekteve dhe akomodimin e çdo problematike brenda fondit të kontraktuar, pa cënuar funksionalitetin e objekteve;
- Projektet janë realizuar në afat, dhe një pjesë e mirë e tyre, sidomos në programin e rindërtimit para afatit, duke pasur shtyrje të afatit të punimeve vetëm në rastet kur nuk janë vënë në dispozicion lejet apo sheshi i ndërtimit, si një detyrim i NJVV-ve.
- Objektet dhe punimet ndërtimore kanë një cilësi në rritje të vazhdueshme, pavarësisht sfidave që vijnë si pasojë e kontratave të fituara me ulje të mëdha nga ana e operatoreve ekonomikë, duke patur një monitorim të vazhdueshëm, si nga mbikëqyrësit ligjorë të punimeve, përfituesit e investimit dhe inspektorët rajonalë dhe ekipet e kontrollit të cilësisë të FSHZH-së.
- Ndër arritjet spektakolare të këtij viti duhet të vecojmë ndërtimin e 35 Objekteve Arsimore, pjesë e Programit për Rindërtim dhe Zhvillim në Zonat e Prekura nga Tërmeti. Këtu vlen të theksohet realizimi i objekteve arsimore, ku në harkun kohor të 8 muajve u përgatitën projekt-idetë, u realizuan procedurat e prokurimit, u hartua projekti i zbatimit dhe u ndërtuan mbi 100 mijë m² sipërfaqe ndërtimore, duke akomoduar mbi 30 mijë fëmijë në ambiente moderne sipas standarteve më të mira bashkëkohore.

1.8. PUNA DHE PRODUKTE KRYESORE

Puna dhe produktet e realizuara në zbatimin e programeve dhe projekteve të ndryshme zhvillimore, përgjatë vitit 2020 mund të përmbledhet si më poshtë:

Projektimi: Gjatë vitit 2020 janë përgatitur dhe kontrolluar rreth 420 projekt-propozime të zhvillimit, sipas përcaktimeve të programeve të FSHZH-së, nga të cilat mbi 80% e tyre janë konsideruar si projekte të maturuara të cilat mund të vijojnë procesin e detajimit apo prokurimit. Gjithashtu, për të garantuar cilësinë, si dhe çertifikimin e projekteve, FSHZH ka siguruar oponencë teknike nga institucionet përkatëse për rreth 360 projekte zbatimi. Për realizimin e këtyre projekt-propozimeve, janë kryer të gjitha fazat e kontrollit sasior dhe cilësor, si edhe janë realizuar Termat e Referencës për projekt-propozimet e kërkuara.

Pajisja me Leje: Gjatë vitit 2020 FSHZH në zbatim të legjislacionit shqiptar për pajisjen me lejet përkatëse të të gjitha projekteve ka aplikuar dhe bërë të mundur plotësimin e të gjithë dokumentacionit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM), leje mjedisi, leje ndërtimi, Vlerësimin e Impaktit Social, Ruajtjen dhe Sigurinë në Punë për 116 objekte.

Punime Ndërtimore: Gjatë këtij viti janë realizuar volume punimeve ndërtimore kryesore:

- Gërmim/Mbushje 4,5 milionë m³,
- Betone 500 mijë m³,
- Shtresa Asfaltike 2 milionë m²

Shëndeti, Siguria në punë dhe Mbrojtja e Mjedisit: Janë kryer 288 inspektime në terren për zbatimin e rregullave të shëndetit dhe sigurisë në punë dhe 83 inspektime për zbatimin e kushteve dhe detyrimeve për mbrojtjen dhe minimizimin e impaktit në mjedis. Për të gjitha inspektimet janë përgatitur raportet përkatëse, ku janë dhënë këshilla dhe rekomandime për çdo objekt të inspektuar. Inspektimet janë kryer në mënyrë periodike dhe në varësi të problematikave në terren.

1.9. KONTROLLI DHE PËRPUTHSHMERIA E AKTIVITETIT

Raporti Vjetor mbi veprimtarinë e Auditimit të Brendshëm të Fondit Shqiptar të Zhvillimit komunikon rezultatet e veprimtarisë së auditimit të brendshëm për vitit 2020, si dhe jep informacione mbi auditimet e jashtme nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, auditime nga Donatorë dhe kompani auditimi për pasqyrat financiare të çdo viti ushtrimor të përzgjedhur nga Ministria e Financave.

Njësia e Auditimit të Brendshëm zhvilloi veprimtarinë e mëposhtme:

- Auditimi i përputhshmërisë mbi: “Zbatimin e kontratave të punëve publike dhe të mbikqyrjes së tyre” të financuar nga buxheti i shtetit, në bashkëpunim me Laboratorin e ARRSH-së për realizimin e testeve laboratorike mbi materialet e përdorura në këto vepra infrastrukturore;
- *Auditimin tematik “Rikonstruksioni i rrugës së Beratit (Plasma-Karbunarë)”, si dhe testim me prova laboratorike në terren”, duke u bazuar në teste në terren në bashkëpunim me ARRSH-në. Auditimi specifik u përzgjodh nga % e lartë e zbritjes nga fondit limit, rreth 50%;*
- “Programin e Rrugëve Lidhëse Rajonale dhe Lokale”, financuar nga BB, i cili është në proces të hartimit të projekt-raportit;
- Ndjekje në terren e vlerësimit të objekteve të dëmtuara nga tërmeti 26.11.2019 sipas grupeve të punës në periudhën dhjetor 2019- janar 2020, bazuar në Urdhrin e Ministrit Nr.4, datë 15.12.2019 nga Komiteti i Emergjencave Civile;
- Hartimi i Planit Strategjik dhe Vjetor 2021-2023 të NJAB, sipas kërkesës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Harmonizimit të Audit të Brendshëm;
- Hartimi i manualit të Menaxhimit të Riskut në kuadër të rekomandimeve të lëna nga RDPA mbi sistemin e kontrollit të brendshëm, bazuar në kërkesa të MFE mbi “Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.
- Koordinimi i marrdhënieve ndërmjet grupit të auditimit të KLSH-së dhe FSHZH-së për 4 Auditime të zhvilluara gjatë 2020.

Auditimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit gjatë 2020 në FSHZH:

Program auditimi përputhshmërie me temë: “Programi i Zhvillimit të Integruar Urban dhe Turizmit”, i cili nuk ka akoma një raport perfundimtar nga KLSH që nga korrik 2020 me dërgimin e projekt-raportit.

Program auditimi përputhshmërie me temë: “Projekti i rehabilitimit të rrugës së Lumit të Vlorës, Loti I”. KLSH ka dërguar projekt-raportin gjatë muajit tetor 2020 dhe një njoftim për ri-auditim të këtij projekti përsëri gjatë 2021.

Program auditimi përputhshmërie me temë: “FSHZH për programet dhe projektet e financuara nga Buxheti i Shtetit”. Projekt-raporti përkatës u dërgua nga KLSH më 20.09.2020. Raporti perfundimtar nuk është dorëzuar akoma.

Program auditimi tematik me temë: *“Rikonstruksioni i shkolles 9 vjecare dhe ndertim palestre Thumane”*. KLSH ka dërguar projekt-Raportin e Auditimit në nëntor 2020. Pritet raporti përfundimtar i KLSH-së për këtë auditim tematik.

Misione monitorimi dhe vlerësimi të donatorëve

Misioni i Bankës Bankës Botërore në kuadër të Projektit për Zhvillimin e Integruar Urban dhe Turizmin u zhvillua në Qershor 2020, në mënyre virtuale.

Misioni i Bankës Bankës Botërore në kuadër të Projektit Rruget Lidhese Rajonale dhe Lokale u zhvillua në Nëntor 2020.

Auditimi i jashtëm financiar

FSHZH për çdo vit kalendarik auditohet nga kompani ndërkombëtare dhe të pavarura auditimi, të cilat kontrollojnë dhe çertifikojnë pasqyrat financiare të deklaruara nga institucioni sipas projekt/programave në proces zbatimi, sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshjet e financimit.

Gjatë vitit 2020 auditimi i pasqyrave financiare të 2019 është kryer nga kompania ndërkombëtare e auditimit Grant Thornton, e kontraktuar nga Ministria e Financave. Janë miratuar Pasqyrat financiare për vitin ushtrimor 2019, ku opinioni i dhënë nga kompania audituese është i pastër dhe pa gjetje. Aktualisht, është në përfundim procesi i auditimit për vitin ushtrimor 2020.

1.10. TRANSPARENCA DHE KOMUNIKIMI ME PUBLIKUN

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2020, FSHZH ka vijuar punën për të koordinuar në mënyrë efektive komunikimin e brendshëm dhe të jashtëm. Qëllimi është konsolidimi i imazhit të FSHZH përballë palëve të treta, si dhe bashkëpunimi me departamentet e tjera për mbajtjen e marrëdhënieve me aktorët e interesit.

Gjatë 2020 janë administruar **126 kërkesa zyrtare**/ ankesa për informacion nga qytetarë, media, zyra avokatie, gazetarë të pavarur si dhe të deleguara nga Platforma e Bashkëqeverisjes. Kërkesat kanë konsistuar në ecurinë e objekteve në zbatim, dorëzimet e objekteve të përfunduara, ankesa të banorëve të zonave të projekteve, si dhe për Programin për Rindërtim, etj.

Platformat e komunikimit online si Facebook, Instagram dhe YouTube janë përdorur si një instrument për të konsoliduar reputacionin dhe imazhin e organizatës si zbatuese të projekteve në terren, por edhe orientuese e zhvillimit ekonomik afatgjatë. Gjatë vitit 2020 në kanalet zyrtare të FSHZH janë gjeneruar këto të dhëna:

| Janar-Dhjetor 2020 | | | |
|-------------------------------|-----------------|------------------|----------------|
| | Facebook | Instagram | YouTube |
| Postimet | 473 | 297 | 17 |
| Ndjekësit në total | 15.864 | 2369 | 522 |
| Shikueshmëria në total | 325.426 | | |

Gjithashtu janë zhvilluar **13 “Histori Njerëzore” – 32 intervista** deri më tani, në vendndodhje të ndryshme si: Roskovec, Fier, Belsh, Lushnjë, Borsh, Konispol, Shirokë, Dhërmi, Pogradec, Gjirokastrë, Drishtë.

Janë përgatitur gjithsej **22 materiale audiovizuale**, të postuara në kanalet zyrtare të FSHZH –së, përkatësisht:

- Janë realizuar **51 materiale audiovizuale** për prezantimin e punimeve të Programit për Rindërtim dhe Zhvillim në Zonat e Prekura nga Tërmeti;
- Gjatë vitit 2020, në faqen e Internetit janë publikuar **282 materiale** në gjuhën shqipe dhe angleze. Materialet (artikuj, histori njerëzore, njoftime) e shpërndara përkthyer në **629 raportime mediatike**;
- Gjatë periudhës janar-dhjetor 2020, ka pasur **48,531 vizitorë në faqen e internetit**. Koha mesatare e qëndrimit të vizitorëve në faqe për këtë vit është 2m 16s. Google reviews (vlerësime për FSHZH-në në faqen e internetit) janë regjistruar 4.5 nga 5 të mundshme.

2. ZHVILLIMI RAJONAL DHE PROGRAMET

2.1. LIGJI, POLITIKAT, TAKIMET, PLANET E ZHVILLIMIT RAJONAL

Qeveria shqiptare prej disa vitesh po ndërmerr një reformë për zhvillimin rajonal duke e konsideruar atë si një nga objektivat kombëtare. Reforma rajonale vjen si nevojë për një koordinim më të mirë horizontal të politikave sektoriale dhe investimeve dhe integrimin e tyre në territor.

Reforma synon riorganizimin e sistemit të zhvillimit rajonal duke përcaktuar drejtimit kryesore, ngritjen e kuadrit ligjor, strategjik dhe institucional për zhvillimin rajonal.

Fondi shqiptar i zhvillimit prej vitit 2018 ka marrë rolin e agjencisë përgjegjëse për mbarëvajtjen, dhe koordinimin e këtyre proceseve të deleguara nga zyra e Zv. Kryeministrit. Në këtë rol, FSHZH përveç të tjerash është angazhuar në mbështetje të politikëbërjes për çuarjen përpara të reformës për zhvillimin rajonal, përgatitjen e kuadrit ligjor, angazhimit të aktoreve dhe krijimin e institucioneve të zhvillimit rajonal, përgatitjes së kuadrit strategjik, programimin e ndërhyrjeve dhe investimeve.

Për sa më sipër, gjatë 2020, FSHZH është angazhuar në realizimin e një sërë produktesh si vijon më poshtë:

A. Kuadri ligjor

Gjatë 2020, u përgatit, u konsultua dhe u miratua Ligji për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin, Ligji Nr.102/2020.

Ligji për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin përcakton parimet bazë të pargjegjësive dhe të rregullave për zhvillimin rajonal dhe kohezionin në Shqipëri dhe ka për qëllim:

- të përcaktojë instrumentet e posaçme dhe kuadrin institucional e financiar për zhvillimin rajonal dhe kohezionin në Republikën e Shqipërisë;
- të përcaktojë kuadrin strategjik dhe institucional të hartimit të politikave afatgjata zhvillimore rajonale në zbatim të politikave kombëtare, duke siguruar nxitjen e zhvillimit të balancuar ekonomik, shoqëror e kulturor rajonal;
- të sigurojë që autoritetet politikëbërëse të bashkërendojnë veprimtaritë e tyre planifikuese për të nxitur planifikimin e harmonizuar e të integruar të rajoneve;

- të sigurojë harmonizimin e strategjive sektoriale në një politikë të përbashkët zhvillimore rajonale, duke e mbështetur atë edhe me buxhetin përkatës.

Për konsultimin e ligjit, u realizua publikimi i tij në sistemin elektronik të Kryeministrit, u organizuan 13 takime online me përfaqësues të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të nivelit të parë dhe të dytë, dy takime individuale me Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme, u amblodhen komentet e Ministrive të tjera të linjës.

Ligji shërben si një kornizë për zhvillimin rajonal dhe kohezionin, si rezultat, ai do të plotësohet nga aktet nënligjore që derivojnë prej tij. Gjatë vitit 2020, është bërë identifikimi i 10 akteve nënligjore, dhe përgatitja e drafteve të 5 prej tyre: draf akti për rajonet, për procedurat e hartimit të Planit Kombëtar dhe Planeve Rajonal, për ngritjen dhe funksionimin e Komitetit Kombëtar për Zhvillimin Rajonal, për ngritjen e Bordeve të Monitorimit të Zhvillimit Rajonal, për politikën e zhvillimit rajonal.

Më 17.12.2020 filloi procesi i konsultimit publik për aktet nënligjore të përgatitura në Rajonin Shkodër-Lezhë-Kukës, ku brenda këtij viti u realizuan takimet me aktorët publik dhe jopublik të Qarkut Kukës dhe Lezhë. Inicimi i këtij procesi (i cili do të shtrihet edhe gjatë muajve të parë të vitit 2021) shënon një hap të rëndësishëm përpara drejt finalizimit të këtyre drafteve.

B. Kuadri strategjik

Pjesë e ngritjes së kuadrit strategjik janë përgatitja e Politikës së Zhvillimit Rajonal, Planit Kombëtar për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin, si dhe Planet Rajonale për Zhvillimin Rajonal.

Politika për Zhvillimin Rajonal është dokumenti strategjik që përcakton drejtimet e zhvillimit rajonal të qëndrueshëm socio-ekonomik për të përmirësuar cilësinë e jetës së qytetarëve shqiptarë. Mbi bazë të këtij dokumenti do të hartohen dhe zbatohen Plani Kombëtar për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin, Planet Rajonale, Programi Operacional dhe do të bëhet shpërndarja e fondeve që adresojnë zhvillimin rajonal në Shqipëri.

Gjatë vitit 2020, është përgatitur një draft i dokumentit të Politikës, i cili do të diskutohet dhe miratohet në muajt e parë të vitit 2021.

Plani Kombëtar për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin është dokumenti kombëtar që orienton drejtimet strategjike të zbatimit të politikës për zhvillimin rajonal dhe investimet përkatëse, nëpërmjet vendosjes së objektivave dhe parimeve të përbashkëta në nivel kombëtar. Plani Kombëtar për Zhvillim Rajonal dhe

Kohezionin përmban vizionin, parimet, objektivat strategjike, prioritetet dhe drejtimet e zhvillimit rajonal, fushat tematike dhe potencialet rajonale, ndikimin hapësinor të synuar të politikës rajonale, sistemin e zbatimit për programet e zhvillimit rajonal, mekanizmin financiar e instrumentet dhe sistemin e tij të monitorimit e të vlerësimit.

Planet Rajonale të Zhvillimit Rajonal janë dokumenta strategjike rajonale, që kanë për qëllim të përcaktojnë drejtimet e zhvillimit të rajoneve zhvillimore, në mënyrë që të garantohet zhvillimi rajonal dhe kohezioni, sipas vizionit të përcaktuar nga Plani Kombëtar.

Gjatë vitit 2020, është përditësuar baza e të dhënave që do të shërbejnë për përditësimin e analizës së Planit Kombëtar dhe Planeve Rajonale. Përmbajtja e këtyre dokumentave do të përditësohet gjatë muajve të parë të 2021, pas ngritjes së strukturave përkatëse përgjegjëse për miratimin e tyre.

C. Kuadri Programues

Dokumenti i tretë, nëpërmjet të cilit do të zbatohet Politika e Zhvillimit Rajonal, është Programi Operacional për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin.

Programi Operacional është instrumenti i programimit të prioriteteve e drejtimeve të zhvillimit rajonal dhe përfshin instrumentat financiare dhe mjetet e financimit, zbatimin dhe monitorimin, në mënyrë që të sigurojë zhvillimin social, ekonomik dhe territorial të rajoneve zhvillimore.

Gjatë vitit 2020, është diskutuar struktura e Programit Operacional, si dhe është draftuar akti nënligjor përkatës. Me përfundimin e draftit të Programit Operacional, si dhe ngritjen e strukturave përkatëse rajonale dhe kombëtare, parashikohet miratimi i tij në fund të vitit 2021.

D. Kuadri institucional

Ligji Nr.102/2020 'Për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin' parashikon ngritjen e Strukturave qëndrore dhe rajonale si: Komiteti Kombëtar për Zhvillimin Rajonal dhe Bordet e Monitorimit të Zhvillimit Rajonal.

Komiteti Kombëtar për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin krijohet nga Këshilli i Ministrave dhe është organi përgjegjës për zhvillimin, hartimin dhe zbatimin e politikës së zhvillimit rajonal, si dhe për koordinimin e zbatimit të masave për zhvillimin rajonal. Komiteti Kombëtar për Zhvillimin Rajonal është autoriteti programues dhe monitorues, përgjegjës për miratimin, monitorimin dhe vlerësimin e programit operacional.

Bordet e monitorimit të zhvillimit rajonal janë organet kryesore që promovojnë interesat e rajoneve të zhvillimit dhe veprojnë si një organ i përbashkët i njësisë të vetëqeverisjes vendore të rajonit të zhvillimit. Bordet bashkëpunojnë me autoritetet e pushtetit qendror dhe aktorët e tjerë të përfshirë në planifikimin, programimin dhe zbatimin e politikës rajonale, në përputhje me parimin e partneritetit. Bordet e monitorimit të zhvillimit rajonal janë përgjegjëse për hartimin dhe dakordësimin përpara përcjelljes për miratim të planeve të zhvillimit rajonal dhe bashkëpunojnë në përgatitjen e programit operacional për zhvillimin rajonal.

Gjatë 2020, janë draftuar aktet nënligjore përkatëse të Komitetit Kombëtar dhe Bordeve që përcaktojnë strukturën, procedurat dhe funksionimin e këtyre institucioneve, të cilat priten të miratohen në fillim të vitit 2021.

Fondi Shqiptar i Zhvillimit, merr dy funksione të reja sipas Ligjit 102/2020 “Për Zhvillimin Rajonal dhe kohezionin”:

- Funksioni Programues

Ligji i përcakton FSHZH-në, si Sekretariat i Komitetit Kombëtar dhe Sekretariat i Bordeve të Monitorimit duke i përcaktuar një rol kyç në përgatitjen e dokumenteve të planifikimit dhe programimit të Zhvillimit Rajonal. Në këtë pozicion FSHZH, koordinon punën me strukturat dhe aktorët përgjegjës për përgatitjen dhe aprovimin e këtyre dokumentave, dhe kryen edhe funksionin monitorues dhe raportues.

- Funksioni Menaxhues

Në ligj FSHZH përcaktohet si Autoritet Menaxhues i Programit Operacional.

Autoriteti menaxhues është përgjegjës për menaxhimin e programit operacional në përputhje me parimin e menaxhimit të qëndrueshëm financiar dhe për arritjen e objektivave dhe treguesve të matshëm të tij.


Gjatë këtij viti janë realizuar:

- Ligji për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin, Ligji Nr.102/2020 i miratuar;
- 5 draft VKM të përgatitura;
 - . draf akti për rajonet,
 - . draft akti për procedurat e hartimit të Planit Kombëtar dhe Planeve Rajonal,
 - . draft akti për ngritjen dhe funksionimin e Komitetit Kombëtar për Zhvillimin Rajonal,


-
- . draft akti për ngritjen e Bordeve të Monitorimit të Zhvillimit Rajonal, për politikën e zhvillimit rajonal.
 - . draft i dokumentit të Politikës, i perfunduar.
 - Plani Kombëtar për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin dhe 4 Planet Rajonale të përfunduar;
 - Baza e të dhënave social - ekonomike për analizën e Planit Kombëtar dhe Planeve Rajonale e ngritur dhe e përditësuar;
 - 15 konsultime publike të kryera për ligjin;
 - Dy takime me aktoret aktorët publikë dhe jopublik të realizuara.

2.2. PORTOFOLI ADF: PROGRAMET E ZHVILLIMIT RAJONAL DHE VENDOR


PORTOFOLI FSHZH




GRAFIKU 1. NDARJA E BUXHETIT SIPAS FINANCUESIT



GRAFIKU 2. NDARJA E PROJEKTEVE SIPAS FINANCUESIT



AKTIVITETI FSHZH



2.3. PROGRAMET E DETAJUARA

2.3.1. PROGRAMI PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM NË ZONAT E PREKURA NGA TËRMETI

Qeveria Shqiptare në përgjigje të situatës emergjente të krijuar nga fatkeqësia natyrore, tërmeti i vitit 2019, në mënyrë energjike ka hartuar programin prioritar për reduktimin e problematikave dhe kthimin e kësaj fatkeqësie në një oportunitet për një cilësi më të mirë jetese dhe zhvillim të territorit.

Objektivi i Programit për Rindërtim dhe Zhvillim në Zonat e Prekura nga Tërmeti është ndërtimi i infrastrukturës për strehim, edukim dhe shërbimet bazë për banorët e këtyre zonave.

Në veçanti, në kuadrin e Programit për Rindërtim dhe Zhvillim në Zonat e Prekura nga Tërmeti, synimi për vitin 2020 është:

- a) Ndërtimi i banesave individuale të përqendruara dhe pikësore;
- b) Ndërtimi i objekteve arsimore.

Me Vendim të Këshillit të Ministrave, Fondi Shqiptar i Zhvillimit është shpallur Njësi Zbatuese për Rindërtimin dhe Zhvillim në Zonat e Prekura nga Tërmeti në bashkitë: Krujë, Fushe Krujë, Shijak, Vorë, Durrës, Kavajë, Kurbin, Lezhë.

Ndërhyrjet e parashikuara në kuadër të këtij programi janë të grupuara sipas drejtimeve të mëposhtme:

- **Strehimi**, i cili parashikon ndërtimin e banesave të reja të dëmtuara;
- **Edukimi**, i cili parashikon ndërtimin e ndërtesave publike të lidhura me sistemin e edukimit si, çerdhe, kopshte, shkolla;
- **Rikualifikim urban**, i cili parashikon ndërtimin e zonave dhe lagjeve të reja të banimit;
- **Infrastruktura mbështetëse**, e cila parashikon ndërtimin e infrastrukturës rrugore, ujësjellës-kanalizime, ndriçim, mjedise çlodhese dhe rekreative, etj;

Rezultatet e pritshme të programit janë:

- 1,978 banesave individuale me sipërfaqe totale 187,000 m²;
- 3,556 banesave kolektive me sipërfaqe totale 570,000 m²;
- 37 shkolla, kopshte, çerdhe;
- 17 zona të reja urbane dhe sub-urbane të reja.

Impakti i programit parashikon:

- Strehimin e rreth 6,000 familjeve;

- Arsimimin në mjedise të përshtatshme të mbi 20,000 nxënësve në të gjitha nivelet e arsimit;
- Krijimin e 17 zonave të reja të banimit.

Programi financohet nga Qeveria Shqiptare në shumën 32.6 mld Lekë, Banka e Këshillit të Europës për Zhvillim në shumën 500 mijë Euro(CEB) dhe KfW në shumën 11 milione Euro.

Kohëzgjatja e projektit është 2 vjet, gjatë periudhës 2020-2021.

2.3.2. PROGRAMI I ZHVILLIMIT RAJONAL ME FINANCIM TË BRENDSHËM

Zhvillimi rajonal përbën një ndër prioritet kryesore të Qeverisë Shqiptare. Ai përfaqëson një mjet të rëndësishëm nëpërmjet të cilit synohet një qasje më e koordinuar dhe e integruar e politikave ndaj zhvillimit social - ekonomik, duke reduktuar pabarazitë dhe duke dhënë shanse të barabarta individeve, bizneseve dhe rajoneve.

Duke konsideruar sa më sipër, FSHZH gjatë periudhës 2019-2020 ka bërë një programim të integruar të ndërhyrjeve zhvillimore, duke synuar të maksimizojë përdorimin e burimeve dhe impaktit në territor.

Programi i Zhvillimit Rajonal ka si **objektiva:**

- Përmirësimin e kushteve të jetesës të banorëve në të gjithë vendin;
- Rritjen e aksesit në shërbimet bazë;
- Zhvillimin ekonomik nëpërmjet promovimin e turizmit dhe nxitjen e sektorit bujqësor;
- Zhvillimin e kapitalit njerezor.

Programi i zhvillimit rajonal, që është pararendës i programit të zhvillimit rajonal dhe kohezionit, zhvillohet në këto **drejtime kryesore:**

- Infrastruktura vendore rajonale;
- Përmirësimi i transportit rrugor dhe aksesit;
- Zhvillimi i turizmit;
- Zhvillimi rural;
- Edukimi.

Secili drejtim zbatohet si një zë i veçantë i buxhetit të shtetit.

Në total projektet dhe programet e financuara nga buxheti i shtetit që përbejnë Programin e Zhvillimit Rajonal përbëjnë një buxhet prej rreth 64 Milionë Euro në vitin 2020.

INFRASTRUKTURA VENDORE RAJONALE

Qëllimi i Programit është që në vitin 2027, rajonet e Shqipërisë të jenë një vend më i mirë për të jetuar si rezultat i përmirësimit të standardeve dhe cilësisë së jetesës, si dhe krijimit të një kuadri social-ekonomik dhe institucional që do të rrisë mundësitë për realizimin e ambicieve dhe mundësive të rajoneve dhe komuniteteve lokale.

Rezultatet e pritshme: Programi për Zhvillimin Rajonal (IVR) i adresohet të gjitha rajoneve në Shqipëri dhe përmban masa konkrete për nxitjen e rritjes ekonomike, punësimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës nëpërmjet investimeve strategjike.

Ndërhyrjet që realizohen nga ky projekt pritet të mundësojnë rritjen e të ardhurave në rajon, nxitjen e punësimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës.

Drejtimet kryesore të Programit janë:

- Ndërhyrje urbane dhe mjedisore;
Përmirësimi i mjedisit urban me fokus në rivitalizimin urban të zonave urbane, rurale, zonave historike dhe përmirësim mjedisi;
- Ndërhyrje në funksion të zhvillimit ekonomik;
Mbështetje për zhvillimin e sektorëve të ekonomisë si: turizmi, bujqësia, agropërpunimi, industria dhe tregtia;
- Investime në informacion dhe dije;
Mbështetje për krijimin e një baze informacioni të detajuar sasior dhe cilësor dhe ngritje kapacitetesh;
- Ndërhyrje në infrastrukturën e shërbimeve publike.
Mbështetje për zhvillimin dhe përmirësimin e infrastrukturës së shërbimeve publike (transporti, kanalizime, ujësjellës, shërbime sociale)

Përfituesit

Programi Infrastruktura Vendore dhe Rajonale ka një numër përfituesish direkt prej 1 mln banorë. Sipas grupeve të interesit përfituesit ndahen në:

- Niveli qendror dhe lokal i qeverisjes: Nëpërmjet këtij programi, këto dy nivele përfitojnë në terma të realizimit të investimeve të suksesshme në zonat në nevojë, qartësimin e kornizës së zhvillimit në të ardhmen duke realizuar ndërhyrje të orientuara sipas nevojave të zhvillimit dhe alokimit eficient të burimeve financiare;

- Bizneset: janë përfitues direkt të programit. Ndërhyrjet e orientuara sipas nevojave lehtësojnë mundësitë e zhvillimit të aktiviteteve fitimprurëse në sektorë të ndryshëm. Përmirësimet që vijnë nga programi kanë impakt në rritjen e qarkullimit dhe të ardhurave të bizneseve, rritjen e mundësisë për zgjerim të tyre etj;
- Komunitetet dhe individët: Programi ndikon drejtëpërdrejt në përmirësimin e cilësisë së jetës së komuniteteve dhe individëve. Ky përmirësim i cilësisë së jetës vjen jo vetëm nga plotësimi dhe rritja e aksesit ndaj shërbimeve bazë, por edhe nga rritja e përgjithshme ekonomike që ndodh në rajon.

Rezultatet e pritshme

Deri në vitin 2020, janë programuar për financim 53 projekte, nga të cilët:

- 32 janë ndërhyrje infrastrukturore;
- 13 janë ndërhyrje urban-mjedimore;
- 5 janë ndërhyrje të zhvillimit ekonomik;
- 3 janë ndërhyrje investim në informacion dhe dije.

PROJEKTI I INVESTIMEVE PRIORITARE ME IMPAKT TË LARTË NË ZHVILLIMIN EKONOMIK DHE PROMOVIMIN E TURIZMIT 2018 – 2020

Ky projekt ka si synim nxitjen e zhvillimit ekonomik në sektorit e turizmit nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës parësore.

Drejtimet kryesore të ndërhyrjeve janë:

- Ndërhyrje në infrastrukturën e shërbimeve publike;
- Ndërhyrje në rikualifikimin urban;
- Ndërhyrje në infrastrukturën turistike.

Rezultate & Impakte

- Rritje e ofertës turistike;
- Intensifikim i aktiviteteve të lidhura me turizmin;
- Rritje e numrit të turistëve;
- Shtim i njësive akomoduese;
- Klime motivuese për bizneset;
- Përmirësim i kushteve të jetesës;
- Rritje e të ardhurave familjare;
- Rritje e nivelit të punesimit;
- Përgjysmim i kohës së udhëtimit;
- Rritje prodhimit bujqësor dhe blegtoral;

- Akses i shtuar në tregje;
- Akses i shtuar në shërbimet bazë.

Aktualisht kanë përfunduar punimet për:

- Asfaltimin e rrugës Kryqëzimi Shëngjin-qyteti Shëngjin-Porti Ushtarak; Tepelenë-Bënçë-Lekdush punime shtesë;
- Rikonstruksionin e rrugës Agim-Babunjë, Bashkia Divjakë;
- Rikonstruksionin e rrugës së Beratit (Segmenti Ish-Fabrika Plasmasit-Karbunarë);
- Rrugën Qendër Gosë-Hekurudha-Gosë e Madhe, Bashkia Rrogozhinë;
- Rikonstruksionin e Rrugës Ramize Gjebrea Faza II, (Lidhja e rrugës së Pyllit të Sodës me rrugën Transballkanike dhe Autostradën);
- Bulevardin e Vlorës, faza II;
- Rikonstruksionin/ rikualifikimin urban pranë qendrës së qytetit Vlorë, Zona B drejtim i rrugës Justin Godart;
- Rikonstruksionin e rrugëve të brendshme dhe rikualifikimi i hapësirave publike tek zona e plazhit të Shkëmbi i Kavajës;
- Rivitalizimin urban, Bulevardi Maliq-Drithas;
- Ndërtimin e stacionit të pompimit, Depos 50m³ dhe rrjetit elektrik TU dhe TM për furnizimin e depos 2,000 m³ të Lugut të Dardhës, Sarandë;
- Rikonstruksionin e sheshit të Shirokës;
- Ndërtimin e Pedonales dhe Korsisë së Bicikletave të Liqeni Belshit, Faza III;
- Rikonstruksionin e rrugës Balldre-Bend;
- Ndërtimin e sheshit të Roskovecit;
- Ndërtimin e Urës Zezë dhe mbrojtje nga përmbytjet qyteti Fushë-Krujë;
- Rikonstruksionin e Unazës Bujqësore të Myzeqesë: Segmentet Rrethrotullim Imësht-Ngurrëz, Fier i Ri-Kashtbardh, Qerret-Kadiaj-Savër;
- Rikonstruksionin e Shëtitorës Taulantia, Durrës;
- Ndërtimin e Depos dhe rrjetit Shpërndarës të ujësjellësit të Grabianit.

Ndërkohë vijon puna për objektet:

- Rehabilitimi i Lumit Gjanica dhe rikonceptimi i qendrës së qytetit të Fierit;
- Vazhdimi i Shëtitorës së Vlorës, Segmenti jugor nga Fusha e Sportit deri te Tuneli;
- Rikualifikimi i Parkut Industrial Kuçovë.

Duke marrë në konsideratë fondet e nevojshme për të mbyllur objektet në vazhdim dhe parashikimet buxhetore në PBA 2020-2022, FSHZH filloi procesin e programimit të investimeve të reja në një vlerë rreth 6.5 mld Lekë.

Kështu, bazuar mbi studimet dhe nevojat për ndërhyrje në zonat e kthyer në destinacione të mirëfillta turistike, të dhënat ndër vite që FSHZH disponon, vlerësimet në terren nga vetë inxhinierët e FSHZH, kërkesat e shprehura në takime të ndryshme me përfaqësues të interesave në zona, etj., është hartuar lista e projekteve për financim nga Buxheti i Shtetit, Programe Zhvillimi, Kapitulli 01. Kjo listë përmban 11 objektet si më poshtë:

- Sistemim, asfaltim i rrugës Përmet-Çarshovë;
- Ndërhyrje e integruar për përmirësimin e aksesit, shërbimeve dhe rikualifikimit urban në Zonën e Plazhit-Palasë-Dryhmades;
- Ndërhyrje e Integruar për përmirësimin e aksesit, shërbimeve dhe atraksionit turistik në zonën e Alpeve Shqiptare;
- Rikualifikim urban i Bllokut në qendër të Kamzës;
- Rivitalizim i rrugës Andon Pofka dhe hapësirave përreth saj, Bashkia Fier;
- Rehabilitim i sheshit Ahmet Zogu dhe parkut Geraldinë në Qytetin e Burrelit;
- Ndërhyrje e integruar për përmirësimin e konektivitetit dhe rikualifikim urban në Bashkinë e Kavajës;
- Ndërtim i rrugës Rrëshen-Sheshaj;
- Ndërtim i bypass të Gjirokastrës;
- Rruga e vendit të shenjtë Mali i Tomorrit, Loti 2.
- Rikualifikim Urban dhe ndërtimi i agjinaturës për mbrojtjen nga Vjosa I Nj.A. Novoselë.

Rezultate sipas drejtimeve:

- 7 projekte infrastrukture;
- 1 projekt mbi zhvillimin ekonomik;
- 3 projekte lidhur me zhvillimin urban/mjedisor.

Nëpërmjet këtyre ndërhyrjeve përfitojnë 11 bashki, me një popullsi përfituese direkte prej 610 mijë banorësh.

Janë lidhur kontratat, janë marrë lejet e zhvillimit dhe janë në fazën e implementimit të punimeve projektet:

- Sistemim, asfaltim i rrugës Përmet-Çarshovë;
- Rikualifikim urban i Bllokut në qendër të Kamzës;
- Rivitalizim i rrugës Andon Pofka dhe hapësirave përreth saj, Bashkia Fier;
- Rehabilitim i sheshit Ahmet Zogu dhe parkut Geraldinë në Qytetin e Burrelit;
- Ndërhyrje e integruar për përmirësimin e konektivitetit dhe rikualifikim urban në Bashkinë e Kavajës;

- Ndërtim i rrugës Rrëshen–Sheshaj;
- Ndërtim i bypass të Gjirokastrës;
- Rruga e vendit të shenjtë Mali i Tomorrit, Loti 2.

Janë lidhur kontrata dhe janë në proces të marrjes së lejes së zhvillimit projektet:

- Ndërhyrje e integruar për përmirësimin e aksesit, shërbimeve dhe atraksionit turistik në zonën e Alpeve Shqiptare;
- Rikualifikim Urban dhe ndërtimi i agjaturës për mbrojtjen nga Vjosa i Nj.A. Novoselë.

Referuar Aktit Normativ nr. 28 datë 02.07.2020, këtij programi iu shtuan edhe 20 objekte me vlerë rreth 10 mld lekë:

- Rehabilitimi i Lagjeve 4, 5 dhe 6 të bashkisë Kukës;
- Sistemimi i Përroit të Llixhave, Segmenti Ura e Pazarit-Llixha dhe Rikualifikim urban i zonës;
- Rikualifikimi urban i hyrjes së qytetit të Shkodrës dhe Parkut për pushuesit;
- Rikualifikimi i qendrës së Çorovodës (Faza II);
- Rehabilitimi i Rrugëve, Shesheve dhe fasadave, Blloku tek Lagjia Nr. 2, Pogradec;
- Rikualifikimi Urban i Unazës së Re, Berat;
- Riveshje Aksi Rrugor Çermë-Divjakë si dhe degëzimet për fshatrat: Grabian, Çermë, Shkumbin–Bishçukas, Dushkuçan-Hallvaxhias-Gërmenj i Madh;
- Rikonstruksioni i Fasadave të objekteve përgjatë Lumit Drin në qytetin e Lezhës, Blloku Nr. 1 dhe Rruga Lalmiri, Naim Frashëri;
- Rikualifikimi urban i qendrës së qytetit dhe krijimi i hapësirës rekreative në zonën e liqenit artificial, Ballsh;
- Ndërtimi, Asfaltimi, Rrjeti inxhinierik, Rruga Nr. 1, Lëkurës, Lot 1+2;
- Rikualifikimi dhe sistemimi i Lumit Gjanica, Loti II, Fier;
- Rikualifikimi urban pranë qendrës së qytetit Vlorë, Zona A drejtimi i kullës së Sahatit, Kulla e Sahatit dhe Sheshi i Flamurit;
- Rikualifikimi urban i zonës turistike, Golem;
- Rikonstruksioni i Rrugës Miras-Arrëz;
- Rikonstruksioni i Rrugës Çamëria dhe i Unazës së qytetit, Kavajë;
- Përmirësimi i shtresave asfaltike për rrugët në Rajonet 1, 2 (Marrëveshje Kuadër);
- Përmirësimi i shtresave asfaltike për rrugët në Rajonet 3, 4 (Marrëveshje Kuadër);
- Rehabilitimi i Rrugës Nivicë-Salari;

- Rikonstruksioni i Rrugës nga kryqëzimi Dardhë-Arrëz deri në fshatin Nikolicë;
- Asfaltimi i Rrugës Labinot-Fushë/Qafë Renas si dhe Rrugës së re të varrezave Elbasan dhe ndërtimi i mbikalimit hekurudhor në kryqëzimin e Rrugës Nacionale Elbasan-Librazhd, me rrugën "Borodin Mitarja";
- Mbështetje për programin (Oponencë, Mbikqyrje dhe Kolaudim Punimesh).

Nëpërmjet këtyre ndërhyrjeve përfitojnë 16 bashki, me **një popullsi përfituese** direkte prej 1 mln banorësh. Sipas drejtimeve:

- 11 projekte infrastrukturore;
- 8 projekte lidhur me zhvillimin urban/mjedisor.

Projekti: Rikualifikim urban i hyrjes së qytetit të Shkodrës dhe Parkut për pushuesit, pas diskutimeve me Autoritetin Rrugor Shqiptar dhe Bashkinë e Shkodrës, është anuluar pasi kishte mbivendosje me projektin e ndërtimit të bypass-it të Shkodrës.

Janë lidhur kontratat, janë marre lejet e zhvillimit dhe janë në fazën e implementimit të punimeve 18 projekte:

- Rehabilitimi i Lagjeve 4, 5 dhe 6 të bashkisë Kukës;
- Sistemimi i Përroit të Llixhave, Segmenti Ura e Pazarit-Llixha dhe Rikualifikim urban i zonës;
- Rikualifikimi i qendrës së Çorovodës (Faza II);
- Rehabilitimi i Rrugëve, Shesheve dhe fasadave, Blloku tek Lagjia Nr. 2, Pogradec;
- Rikualifikimi Urban i Unazës së Re, Berat;
- Riveshje Aksi Rrugor Çermë-Divjakë si dhe degëzimet për fshatrat: Grabian, Çermë, Shkumbin-Bishçukas, Dushkuçan-Hallvaxhias-Gërmenj i Madh;
- Rikonstruksioni i Fasadave të objekteve përgjatë Lumit Drin në qytetin e Lezhës, Blloku Nr. 1 dhe Rruga Lalmiri, Naim Frashëri;
- Rikualifikimi urban i qendrës së qytetit dhe krijimi i hapësirës rekreative në zonën e liqenit artificial, Ballsh;
- Ndërtimi, Asfaltimi, Rrjeti inxhinierik, Rruga Nr. 1, Lëkurës, Lot 1+2;
- Rikualifikimi dhe sistemimi i Lumit Gjanica, Loti II, Fier;
- Rikualifikimi urban i zonës turistike, Golem;
- Rikonstruksioni i Rrugës Miras-Arrëz;
- Rikonstruksioni i Rrugës Çamëria dhe i Unazës së qytetit, Kavajë.

- Është lidhur kontrata dhe është në proces të marrjes së lejes së zhvillimit projekti;
- Rikualifikimi urban pranë qendrës së qytetit Vlorë, Zona A drejtimi i kullës së Sahatit, Kulla e Sahatit dhe Sheshi i Flamurit.

2.3.3. PROGRAMI I ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM I INTEGRUAR NË “100 FSHATRA”

Programi synon të ketë një 'fshat të gjallë', një force magnet për turizmin në rajon, një fshat që prodhon për vete e për eksport, një fshat brand për traditën që mbart, një fshat që siguron cilësi e siguri në jetesë.

Objektivat e zhvillimit të këtij programi janë:

- Nxitja e zhvillimit ekonomik të qëndrueshem në zonat rurale, si dhe ;
- Përmirësimi i cilësisë së jetesës në zonat rurale.

Programi është i përbërë nga 4 komponentë, të cilët janë grupuar sipas funksionit që ato kryejnë përkundrejt zhvillimit në territor, si më poshtë:

- Komponenti 1: Zhvillimi i Atraksionit turistik;
- Komponenti 2: Zhvillimi I Aktivitetit Ekonomik;
- Komponenti 3: Zhvillimi indërveprimit social;
- Komponenti 4: Përmirësimi i shërbimeve publike.

Rezultatet e pritshme të programit:

- 134,000 përfitues të drejtpërdrejtë;
- 150 produkte turistike;
- 250 persona të trajnuar lidhur me sipërmarrjen;
- 250 persona të trajnuar në sektorin publik;
- 15% më shumë të punësuar në sektorin jo bujqësor;
- 20% më shumë turistë;
- Rrije e ditëve të qëndrimit të vizitorëve me 2 ditë;
- 300 biznese të reja jobujqësore.

Për shkak të tërmetit të 26 Nëntorit të vitit 2019, buxheti i planifikuar 2020 për këtë program u përdor për financimin e Programit për Rindërtim dhe Zhvillim në Zonat e Prekura nga Tërmeti.

2.3.4. PROGRAMI I KONEKTIVITETIT TË RRUGËVE RAJONALE DHE LOKALE

Ky Program synon të mbështesë zhvillimin e sektorëve të turizmit dhe bujqësisë dhe konektivitetin rajonal përmes përmirësimit të aksesit rrugor, si faktorët kryesorë të rritjes ekonomike dhe punësimit në Shqipëri.

Gjithashtu Programi i Konektivitetit synon të zhvillojë një kornizë të përgjithshme investimesh në infrastrukturën e transportit me fokus në rrjetin rrugor rajonal në zonat me potencial bujqësor dhe turistik në të gjithë vendin.

Drejtimet kryesore të programit janë:

- Ndërhyrje në infrastrukturën rrugore turistike dhe bujqësore;
- Ngritja e kapaciteteve të Njësive vendore për menaxhimin e rrjetit rrugor.

Rezultatet e programit:

- Rehabilitimi total i 9 rrugëve ekzistuese dhe ndërtimi i një segmenti të ri (bypassi i Tushemishtit) në 8 bashki të Shqipërisë;
- Zhvillimin dhe mirëmbajtjen e një sistemi informacioni gjeografik (GIS) dhe bazës së të dhënave për rrugët rajonale dhe lokale
- Projektet pjesë e këtij programi do të sjellin impakt në përmirësimin e cilësisë së jetesës së rreth 190,000 banorëve direktë dhe rreth 200,000 banorëve indirekt;
- Akses më të mirë për rreth 300,000 turistë në zonat e projektit.

Përfitimet e pritshme te projektit janë si më poshtë:

- Rrugë të kalueshme gjatë gjithë vitit dhe rritje deri 200% të trafikut duke qenë se një pjese e mire e trafikut do të devijohet nga rruga e bregdetit;
- Mundësi alternative transporti e shtuar shërbime me kosto dhe kohë transporti të reduktuar;
- Lidhje me tregjet rajonale dhe lokale për të shitur produktet lokale;
- Përmirësimi i ndërveprimit social dhe i aksesit në aktivitetet sociale, sportive dhe kulturele;
- Përmirësohet aksesit për shërbimet e arsimit dhe shëndetësisë.
- Diversifikimi i ekonomisë lokale nëpërmjet agro përpunimit dhe agroturizmit dhe zhvillimit të SME-ve;
- Rritja e mundësive për punësim dhe të ardhurat për popullsinë lokale.

Deri më sot ky program po financohet nga Qeveria Shqiptare mes marreveshjeve të huasë me Bankën Botërore dhe BERZH me vlerë financimi 100 milionë USD.

Pjesa tjetër e nevojave për financim, do të plotësohet me anë të marrëveshjeve të reja financimi në vazhdim, duke plotësuar kështu fazat e mëpasshme të këtij programi.

FAZA E PARË – FINANCIMI NGA BANKA BOTËRORE

Faza e I-rë e Programit të Konektivitetit financohet nga një hua e IBRD prej 50 milion USD dhe ka për synim realizimin e komponentëve si me poshtë:

Komponenti 1: Përmirësimi i aksesit (Kostoja totale 46.88 milion dollarë; IBRD 46,88 milion dollarë amerikanë).

Ky komponent do të financojë rehabilitimin e rrugëve rajonale dhe lokale; shërbime projektimi, mbikëqyrjen e punëve civile, auditimin e sigurisë rrugore; implementimin e masave për përmirësimin e sigurisë rrugore.

Rrugët që financohen prej kësaj huaje janë:

- Qafë Thore-Theth;
- Pogradec-Tushemisht;
- Bënçë-Lekdush;
- Gusmar-Kuç;
- Fier Seman.

Programit të financuar nga Banka Botërore (IBRD) pritet t'i shtohen edhe kontratat e zbatimit si me poshtë:

- Rruga Roskovec-Poshnjë;
- Rruga “Zona turistike-Golem-Kavajë”;
- Rruga Pogradec -Tushemisht Loti 2;
- Ndërtimin i Urës Dermans (rruga Fier Seman në kuadër të masave për përmirësimin e sigurisë rrugore).

Komponenti 2: Ngritja e kapaciteteve për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (Kostoja totale 1,0 milion dollarë amerikanë; IBRD: 1,0 milion dollarë amerikanë).

Ky komponent do të sigurojë mbështetje për NjVV- të në dy fusha të përgjegjësi të tyre, që janë menaxhimi dhe mirëmbajtja e rrjeteve të tyre rrugore dhe mbështetja në zbatimin e programeve të zhvillimit rural që mund të financohen nga vete NjVV-të, nga Qeveria apo partnerë të tjerë të zhvillimit.

Komponenti 3: Mbështetja e Menaxhimit të Zbatimit (Kostoja totale 2.0 milion dollarë; IBRD: 2.0 milion dollarë).

Ky komponent përfshin koston operacionale të FSHZH-së, zhvillimin dhe mirëmbajtjen e një sistemi informacioni gjeografik (GIS) dhe bazës së të dhënave për rrugët rajonale dhe lokale, vlerësimin afatmesëm dhe ngritjen e kapaciteteve për FSHZH-në.

FAZA E DYTË – FINANCIMI NGA BERZH

Në fazën e dytë, që financohet me një hua të BERZH, është finalizuar një listë projektsh prioritare për të cilat po vijohet me realizimin e dokumentacionit të nevojshëm për t'i hapur rrugë zbatimit të punimeve.

2.3.5. PROGRAMI I REHABILITIMIT TË RRUGËS SË LUMIT TË VLORËS

Projekti kontribuon në përmirësimin e kushteve të jetesës për vendasit dhe ridimensionimin e sektorit të turizmit si një nga shtyllat kryesore të ekonomisë lokale dhe rajonale.

Objektivat specifikë të projektit janë:

- Krijimi i një korridorit të ri, i cili është me tërheqës, i sigurt dhe më i shkurtër se rruga ekzistuese dhe që do të lidhë qarkun e Vlorës me bregdetin Jonian;
- Kontributi pozitiv në përmirësimin e kushteve të jetesës së popullsisë rurale në zonën e Lumit të Vlorës.

Projekti ka si qëllim rikonstruksionin e rrugës së Lumit të Vlorës, e cila, përveç lidhjes së kësaj zone me bregdetin Jonian dhe rivierën shqiptare përmes lotit të IV-të, do të mundësojë lidhjen e dy rrugëve nacionale (SH4-SH8).

Rruga e Lumit të Vlorës ka një gjatësi prej rreth 90.4 km.

Impakti

Përfitimet e pritshme të projektit janë si më poshtë:

- Rrugë e kalueshme gjatë gjithë vitit dhe rritje deri 200% të trafikut duke qenë se një pjesë e mirë e trafikut do të devijohet nga rruga e bregdetit
- Mundësi alternative transporti e shtuar shërbime me kosto dhe kohë transporti të reduktuar;
- Lidhje me tregjet rajonale dhe lokale për të shitur produktet lokale;
- Përmirësimi i ndërveprimit social dhe i aksesit në aktivitetet sociale, sportive dhe kulturele;
- Përmirësohet aksesit për shërbimet e arsimit dhe shëndetësisë.
- Diversifikimi i ekonomisë lokale nëpërmjet agro përpunimit dhe agroturizmit dhe zhvillimit të SME-ve;
- Rritja e mundësive për punësim dhe të ardhurat për popullsinë lokale.

Financues të projektit janë Fondi Kuvajtian me 40 milionë USD dhe Qeveria Shqiptare, që, pas rialokimit të fondit rezervë nga marrëveshja me Fondin Kuvajtian, bashkëfinancon me rreth 11.17 milionë USD, për zbatimin e projektit (punimet civile dhe konsulenca) dhe me një vlerë të TVSH prej 16.23 milionë

USD. Projekti ka filluar në vitin 2017 dhe parashikohet të përfundojë në vitin 2022.

2.3.6. PROGRAMET E TURIZIMIT DHE ZHVILLIMIT URBAN

Një nga sektorët ekonomikë e me potencial të lartë zhvillimi dhe punësimi është sektori i turizmit.

FSHZH ka programuar dhe filluar nga puna për realizimin e një serie projektesh të grupuara nën programin për Turizmin dhe Zhvillimin Urban, që synojnë të përmirësojnë turizmin e qëndrueshëm dhe të përgjegjshëm, duke rigjeneruar kështu strukturën ekonomike lokale dhe mjedisin urban. Destinacione turistike më të shumta dhe më tërheqëse do të rrisin shpenzimet e turistëve, kohëzgjatjen e sezonit turistik, mundësitë e punësimit për popullsinë lokale dhe të ardhurat në zonat e ndërhyrjes.

PUNËT NË KOMUNITET IV - ZHVILLIMI I ALPEVE SHQIPTARE DHE ZONËS BREGDETARE

Objektivi i projektit “Punët në Komunitet IV - Zhvillimi i Alpeve Shqiptare dhe Zonës Bregdetare” është nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm social-ekonomik në komunitetet me potencial të lartë turistik, nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës së integruar publike, duke respektuar mjedisin dhe duke ruajtur trashëgiminë kulturore dhe historike.

Drejtimit e projektit janë:

- Investime në infrastrukturë dhe shërbimet lokale publike (rikualifikim urban e rrugë, ujësjellës-kanalizime, menaxhim i mbetjeve urbane, etj.);
- Asistencë teknike & ngritje kapacitetesh (studime fizibiliteti, përgatitje strategjish lokale, hartim projektesh, trajnime).

Rezultate:

- 20 projekte infrastrukturore;
- 34,000 m rrugë;
- 145,000 m² shtresa asfaltike;
- 28,500 m² trotuare;
- 68,000 m² sheshe, shetitore,
- 42,000 m rrjet ujësjelles kanalizimesh;
- 30,000 m ndricim;
- 45,000 m² gjelberim;
- 9 ura;
- 6,000 m² mobilim urban.

Impakt:

- një klimë motivuese për bizneset;
 - . 93% më shumë njësi akomoduese
 - . 41% biznese të reja
- intensifikim i veprimeve të bizneseve për të zgjeruar aktivitetin;
- potencial dhe dinamikë në punësim;
 - . 67% më pak të papunë
 - . 41% sipërmarrje individuale
- dyfishim i numrit të turistëve;
- përmirësim i dukshëm lidhur me kushtet e jetesës ;
- 25% më pak familje në nevojë;
- 22% e familjeve me më shumë të ardhura.

Projekti me vlerë 36.7 milionë Euro bashkëfinancohet nga Banka për Zhvillim e Këshillit të Europës (CEB), Qeveria Shqiptare dhe NJQV-të përfituese, WBIF.

Burimet e financimit përfshijnë 28.7 milionë euro kredi nga CEB, 1 milion Euro grant nga CEB Social Dividend Account (SDA), një kontribut 6 milionë Euro nga Qeveria e Shqipërisë dhe NJQV përfituese, si dhe një 1 milion Euro grant nga WBIF.

Marrëveshja e financimit midis Qeverisë Shqiptare dhe CEB për këtë projekt është firmosur në datë 21 maj 2015 dhe është ratifikuar nga Parlamenti në datë 2 korrik 2015. Projekti ka filluar nga puna në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2015 dhe duhet të përfundonte në shtator 2019. Duke marrë në konsideratë problematikat sociale të hasura gjatë zbatimit të projektit në zonën bregdetare të Jugut, data e përfundimit të projektit është shtyrë me një vit deri në shtator 2020.

Përsa i përket komponentit të investimeve në infrastrukturë, kanë përfunduar punimet civile për të gjitha objektet e parashikuara në komponentin Ndërtim:

- Rikonstruksionin e rrugës së Ulzës;
- Restaurimin e fasadave dhe rikualifikimin e qendrës Gjirokastër;
- Ndërtimin e qendrës së turizmit Valbonë;
- Rikualifikimin urban të Tamarës (faza II) dhe rikonstruksionin e rrugës së Vermoshit;
- Rikualifikimin urban dhe mjedisor të qendrës dhe Liqenit të Pukës, Fazat I & II;
- Rikualifikimin urban në Bashkinë Himarë, Fazat I & II;
- Rigjenerimin urban të zonave bregdetare në fshatrat Jalë dhe Dhërmi;

- Asfaltimi i Bypass-eve Jalë dhe Dhërmi;
- Rikualifikimin urban në fshatin Dhërmi;
- Rikualifikimin urban në fshatin Vuno;
- Rikonstruksionin e rrugës së Kaninës;
- Rikualifikimin urban në Bashkinë Vlorë, fazat I & II;
- Rikonstruksionin e rrugës Port-Pylli i Sodës;
- Rikonstruksionin e Bulevardit "Ismail Qemali";
- Rikonstruksionin e sistemit të kullimit të ujërave të shiut në zonën e lagjeve Hajro Çakerri, 4 Heronjtë, 28 Nëntori, Vlorë;
- Rehabilitimin e fasadave përgjatë Bulevardit të Vlorës;
- Rikualifikimin urban dhe ndërtimi i qendrës së turizmit në Vermosh;
- Ndërtimin e qendrës së urgjencës Palasë;
- Rehabilitimin e përroit dhe zonës së parkimit në fshatin Dhërmi.

Për të gjitha objektet që janë në fazë zbatimi kanë përfunduar procedurat e tenderimit dhe janë lidhur kontratat për supervizionin e punimeve. FSHZH është angazhuar maksimalisht që punimet të përfundojnë brenda afateve të kontratave respektive. Sezoni turistik 2019 i gjeti këto zona me infrastrukturë të transformuar.

Përsa i përket komponentit të asistencës teknike dhe ngritjes së kapaciteteve, po punohet për realizimin e disa studimeve dhe organizimin e trajnimeve për Njësitë e Qeverisjes Vendore në territorin e zbatimit të projektit.

Janë ndjekur në terren Plani i Menaxhimit Mjedisor dhe Social si dhe çështje të sigurisë së shëndetit në punë

Procedurat e prokurimit janë kryer në mbështetje të rregullores respektive që Banka për Zhvillim e Këshillit të Europës (CEB) ka në fuqi.

PROJEKTI PËR ZHVILLIMIN E INTEGRUAR URBAN DHE TURISTIK

Projekti ka si qëllim uljen e varfërisë dhe promovimin e prosperitetit të përbashkët në bashkitë e përzgjedhura nëpërmjet pilotimit të një qasje të integruar të zhvillimit rajonal dhe sigurimit të një model për replikim në rajone të tjera ekonomike në vend.

Projekti mbështetet në realizimin e një paketë aktivitetesh që synojnë:

- përmirësimin e infrastrukturës urbane,
- nxitjen e turizmit dhe
- forcimin i kapaciteteve institucionale për të mbështetur turizmin dhe zhvillimin e ekonomisë lokale në zonat e përzgjedhura në jug të Shqipërisë Gjirokastër, Berat, Përmet dhe Sarandë.

Drejtimit kryesore të projektit janë:

Drejtimi 1 - Zhvillimi Urban dhe përmirësimi i Infrastrukturës për qendrat urbane të: Sarandës, Gjirokastrës, Beratit dhe Përmetit

Ky komponent financon përgatitjen e projekteve urbane, studimeve të fizibilitetit, projekteve inxhinierike dhe supervizimin e projekteve ndërtimore. Infrastruktura nëntokësore do të përfshihet si pjesë e përmirësimit të rrjetit rrugor kur të jetë e nevojshme.

Drejtimi 2 Përmirësimi i siteve turistike të përzgjedhura përgjatë korridorit turistik në Shqipërinë e Jugut.

Investimet përfshijnë restaurimin e objekteve të trashëgimisë dhe aseteve kulturore dhe përmirësimin e infrastrukturës mbështetëse. Ky komponent financon gjithashtu përgatitjen e studimeve të fizibilitetit, planet e menaxhimit të siteve, projektet inxhinierike dhe supervizimin e projekteve ndërtimore.

Drejtimi 3 Zhvillimi i Tregut të turizmit dhe produkteve, financon aktivitetet për përmirësimin e menaxhimit në nivel bashkiak dhe ofrimin e shërbimeve, si dhe zhvillimin e zinxhirit të vlerës.

Ky komponent financon:

- i. Kërkimin e tregut për të udhëhequr aktivitetet e zhvillimit të produktit;
- ii. Aktivitetet që mbështesin krijimin e partneriteteve për menaxhimin e destinacionit në nivel bashkiak dhe rajonal;
- iii. Zhvillimin e së paku 20 produkteve të reja turistike në zonën e projektit; dhe,
- iv. Krijimin e një sistemi të statistikave kombëtare të turizmit.

Rezultate të pritshme:

- 100 mijë m² hapësira publike të rehabilituara;
- 11 site turistike të rehabilituara me akses të përmirësuar;
- Rritje me 5 % e të turistëve të kënaqur në sitet turistike e rehabilituara;
- 4 bashki me sistem menaxhimi të përmirësuar dhe partneritet funksional të menaxhimit të destinacionit;
- 14 km rrugë urbane të rehabilituara;
- 19 km rrugë me ndriçim të përmirësuar;
- 16 km rrugë këmbësore të rehabilituara;
- 5 plane të menaxhimit të sitit;
- 25 produkte të zhvilluara me mbështetjen e menaxhimit të destinacionit;
- 20 trajnime mbi rritjen e kapaciteteve të bashkive.

Impakti:

- 92 mijë përfitues;
- Rritje e ofertës turistike;
- Intensifikim i aktiviteteve të lidhura me turizmin;
- Rritje e numrit të turistëve;
- Shtim i njësive akomoduese;
- Klime motivuese për bizneset;
- Përmirësim i kushteve të jetesës;
- Rritje e të ardhurave familjare;
- Rritje e nivelit të punesimit.

Gjatë kësaj periudhe, FSHZH ka punuar intensivisht me ekipin e Bankës Botërore, Njësitë e Qeverisjes Vendore dhe MZHU me qëllim realizimin e objektivave të zbatimit të projektit. Gjatë vitit 2020 është punuar për:

Komponenti 1: Projektimi urban dhe përmirësimi i infrastrukturës (44.3 milionë Euro) i cili financon hartimin e projekteve për zbatimin e projektimit urban dhe investime për përmirësim të infrastrukturës bashkiake në katër qendrat urbane: Saranda, Gjirokastra, Berati dhe Përmeti.

Komponenti 2: Përmirësimi i siteve turistike (8.4 milionë Euro) financon investime që kanë për qëllim përmirësimin e siteve turistike të përzgjedhura përgjatë korridorit turistik në Shqipërinë e Jugut.

Komponenti 3: Gjatë 2020 është punuar për 5 konsulenca

PIUTD+

Duke parë ecurinë e projektit, komplementaritetin dhe sinergjinë e mundshme me investime të tjera në zonën ku shtrihet ky projekt, është propozuar dhe gjatë 2020 është punuar në bashkëpunim të ngushtë me Qeverinë shqiptare për kërkesën për shtrirjen e tij në dy zona të reja (Ksamil dhe Oriku) dhe shtim të këtij projekti me një vlerë prej 30 milion euro

Financimi shtesë do të përdoret për të mbështetur rritjen e investimeve në përmirësimin e infrastrukturës urbane dhe gjithashtu zhvillimin e produkteve turistike dhe zhvillimin e tregut në dy zona të reja në jug të Shqipërisë. Investimet e financimit shtesë do të përqëndrohen në Ksamil dhe Oriku, të dyja këto janë të lidhura ngushtë me bashkitë që marrin pjesë në projektin mëmë dhe sitet e tyre turistike.

Gjithashtu me propozim të Bankës Botërore është kërkuar që të shtohet dhe një komponent i ri në projekt i quajtur CERC (Contingency Emergency Response

Component), i cili do jetë një mjet për ndërhyrje të shpejta me procedura lehtësuese në përgjigje të një situatë emergjente. Ky komponent do ketë zero fonde të alokuara si fillim dhe në rast të një situatë emergjente do aktivizohet dhe pranë tij do të mund të alokohen fonde nga përbrenda projektit të cilat do jenë të paangazhuara.

PROGRAMI PËR ZHVILLIMIN E INTEGRUAR TË ZONAVE ME POTENCIAL TURISTIK (TLED)

Objektivi i përgjithshëm i këtij programi është rritja e kontributit të turizmit të cilësisë dhe turizmit të qëndrueshëm në rritjen ekonomike dhe konkurrueshmërinë e rajoneve shqiptare.

Programi do të zbatojë dhe të testojë modelin e zhvillimit ekonomik lokal të udhëhequr nga turizmi, i përqendruar në një numër të modeleve pilot të trashëgimisë kulturore dhe natyrore si dhe mjeteve të destinacioneve të tjera lokale.

Programi parashikon investime strategjike rajonale në zonat me potencial turistik në Bashkitë e Shkodrës, Korçës, Fierit, Beratit. Programi do të financohet nga BERZH dhe IPA me vlerë të pritshme financimi 100 milionë Euro dhe kohëzgjatje 4 vjeçare.

Programi ka dy drejtime kryesore:

- *Drejtimi 1:* Përmirësimi i ofertës turistike përmes rehabilitimit, rivitalizimit, ndërtimit dhe restaurimit të infrastrukturës në sitet e trashëgimisë kulturore dhe natyrore në katër terriore pilot Berat, Fier, Korçë dhe Shkodër.
- *Drejtimi 2:* Ndërtimi i infrastrukturës së transportit dhe asaj bashkiake.

Rezultatet e pritshme për drejtimin 1:

- Paketa e turizmit të integruar tregtar për zonën e synuar;
- Iniciativat e krijuara lokale të turizmit bazuar në qëndrueshmërinë, partneritetet, grupimet dhe zhvillimin e zinxhirit të vlerave;
- Aftësi të përmirësuara nëpërmjet trajnimeve të ofruara ofruesve të shërbimeve/ produkteve potenciale turistike lokale në zonat e synuara;
- Standarde të përmirësuara të turizmit dhe të dhënat në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare;
- Ruajtja dhe restaurimi i trashëgimisë kulturore, pasurive natyrore dhe të tjera lokale;
- Përmirësim i aksesit dhe qëndrueshmëri më e madhe e trashëgimisë kulturore, pasurive natyrore dhe të tjera lokale;

- Aftësi të përmirësuara në ruajtjen, restaurimin dhe menaxhimin e ekspertëve të institucioneve përkatëse publike, dhe trashëgiminë kulturore dhe vendet natyrore.

Rezultatet e pritshme për Drejtimin 2:

- Përmirësimi i zbatimit të infrastrukturave prioritare të tubacionit Kombëtar të Projekteve të Veçanta në kuadër të planeve zhvillimore lokale;
- Rezultatet e pritshme për Komponentin 3:
- Instrumentet e përmirësuara të përshpejtuesve për mbështetjen e fillimit të punës;
- Përmirësim i qasjes në financa për fillimin e sistemit të inovacionit.

Rezultate të përgjithshme:

- Në kuadër të këtij programi do të realizohen 4 grupime projektsh të integruara për përmirësimin e ofertës turistike kulturore në shtet historike dhe kulturore të 4 bashkive;
- Do të realizohen 6 grupime projektsh të integruara për zonat natyrore të 5 bashkive;
- Do të realizohen 5 grupime projektsh që lidhen me përmirësimin e ofertës turistike nëpërmjet rikonstruksionit dhe përmirësimit të infrastrukturës së transportit dhe asaj bashkiake.

Impakti:

- Ndërhyrjet e këtij programi do të kenë impakt të drejtpërdrejtë në përmirësimin e cilësisë së jetesës në më shumë se 8 bashkive përfituese;
- Ndikim të tërthortë në më shumë se 360,000 banorë dhe ndikim të drejtpërdrejtë në 40,000 banorë të bashkive përfituese;
- Do të sigurojë akses më të mirë për rreth 500,000 turistë në zonat e projektit.

Gjatë vitit 2020, FSHZH në cilësinë e përfaqësuesit të përfituesit, ka ngritur Komitetin Drejtues të Programit, si edhe ka organizuar mbledhjen e parë të Steering Committee me përfaqësues nga Ministrinë dhe Bashkitë përfituese të programit për diskutime. Kanë përfunduar negociatat ndërmjet Qeverisë Shqiptare, FSHZH dhe BERZH lidhur me Marrëveshjen e Huasë dhe Grantit dhe Marrëveshja është miratuar gjatë gjashtë mujorit të dytë të vitit 2020.

Është përgatitur dhe është dakordësuar lista prioritare e investimeve dhe në bashkëpunim me BERZH janë hartuar Termat e Referencës për prokurimin e asistencës teknike. Janë shpallur procedurat e prokurimit për dy konsulencia: T-Led që pritet të zhvillojë e marketojë produktin turistik të secilës nga bashkitë

përfituese si dhe EGI që ka synim rritjen e kapaciteteve të aktorëve lokalë, përfshirë bizneseve në fushën e turizmit.

Në kuadër të këtij programi, FSHZH po përgatit me financim të buxhetit të shtetit projektet teknike për një grup investimesh infrastrukturore të përfshira në listën e ndërhyrjeve të këtij Programi.

PROJEKTI PORTA BREGDETARE E ALPEVE

Projekti Porta bregdetare e Alpeve është një projekt i ri që ndodhet në fazën studimore dhe fokusohet në bashkitë Shkodër, Malësi e Madhe dhe Lezhë dhe specifikisht në zonën liqenore të Liqenit të Shkodrës, në fashën lumore të Bunës si dhe në bregdetin Adriatik të Velipojës dhe Shëngjinit. Asistenca teknike në vlerën 2.5 milion Euro ka dy komponentë kryesorë:

- Studimin e integruar urban dhe turistik të zonës;
- Përgatitjen e projekteve teknike specifike për zonën.

Gjatë 2020 është nënshkruar marrëveshja ndërmjet Bankës Europiane të Investimeve (BEI) dhe Ministrisë së Financave dhe është hartuar Marrëveshja e Bashkëpunimit midis FSHZH dhe BEI. Projekti përfshin zonat urbane por gjithashtu edhe zonat natyrore dhe mjedisore të këtyre bashkive.

Lidhur me këtë projekt, studimi i integruar urban dhe turistik i zonës së projektit financohet nga BEI, në vlerën 220,000 Euro, vlerë kjo që përfaqëson transhin e parë të vlerës totale të asistencës teknike. Studimi po kryhet përmes konsulencës së kontraktuar nga BEI në bashkëpunim të ngushtë me FSHZH. Konsulenca ka nisur punën; është zhvilluar takimi i parë me grupin e punës dhe BEI si dhe është hartuar drafti i parë i Inception Report. Megjithatë, për shkak të situatës së krijuar nga Covid-19, aktiviteti i konsulencës është pezulluar dhe po punohet së bashku me BEI dhe Konsulentin mbi riaktivizimin e saj gjatë vitit 2021.

PROGRAMI I INVESTIMEVE PËR ZHVILLIM TË INTEGRUAR RAJONAL

Objektivi i përgjithshëm i këtij programi është rritja e kontributit të turizmit të cilësisë dhe turizmit të qëndrueshëm në rritjen ekonomike dhe konkurrueshmërinë e rajoneve liqenore dhe bregdetare shqiptare.

Programi parashikon ndërhyrje të integruara në funksion të nxitjes së zhvillimit ekonomik të zonave me potencial turistik, dhe përfshin dy rajone kryesore:

A. Rajoni Korçë

Bashkia Pogradec

Përsa i përket Bashkisë Pogradec si zonë ndërhyrjeje është përcaktuar zona e vijës liqenore në qytetin e Pogradecit deri në fshatin Tushemisht. Projekti është ende në fazë konceptuale dhe maturimi i tij nuk ka nisur ende. Pjesë e programit është edhe fshati Lin. Për këtë ndërhyrje është përgatitur fisha konceptuale dhe investimet parashikohet të përfshijnë ndërhyrje infrastrukturore, kulturore dhe mjedisore të zonës liqenore dhe urbane të fshatit Lin.

Bashkia Pustec

Programi përfshin ndërhyrje në zonën e Zaroshkës dhe Pustecit. Për të dyja zonat është përgatitur koncepti dhe është dërguar pranë KfW. Ndërhyrjet në zonat urbane dhe liqenore të Zaroshkës dhe Pustecit përfshijnë të njejtat tipologji ndërhyrjeje si në rastin e fshatit Lin.

B. Rajoni Vlorë

Në rajonin e Vlorës përfshihen zonat bregdetare Qeparo - Borsh - Lukovë - Piqeras. Ndërhyrjet do të prekin disa aspekte të territorit të këtyre zonave:

- Përmirësimin e infrastrukturës publike;
- Përmirësimin e infrastrukturës turistike etj.

Programi bashkëfinancohet nga Qeveria Gjermane, ku parashikohet që faza e I-rë të financohet përmes një kredie të butë nga KfW në vlerë të përgjithshme deri në 50 milionë Euro (pjesa e parë 20 milion Euro) dhe bashkëfinancim nga Qeveria Shqiptare për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikqyrjen e projektit në vlerë të përgjithshme deri në 1 milion euro.

Gjatë 2020 janë kontraktuar dy konsulenca për të dy rajonet të cilat kanë zhvilluar konceptet specifike për zonat e projektit si dhe kanë përgatitur programin e investimeve prioritare që do të financohen në një fazë të dytë. Konsulencat po menaxhohen nga KfW në bashkëpunim të ngushtë me FSHZH.

Gjatë vitit 2020, konsulencat kanë organizuar takimet e para në terren me stakeholders përkatës, kanë dorëzuar Inception Reports, kanë prezantuar konceptet paraprake për zonat e ndërhyrjeve dhe po finalizojnë studimin e integruar për të përcaktuar listën prioritare të ndërhyrjeve që do të kryhen në bashkitë përbërëse të programit, për të cilat është dakordësuar me të gjithë aktorë e përfshirë.

2.3.7. PROGRAMI I RURAL WATER

RURAL 3

Projekti “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale III”, parashikon ndërhyrje në shkallë të gjerë në të gjithë vendin. Financues të këtij programi janë:

- KfW me **25.5 milionë Euro**;
- Bashkimi Europian përmes IPA 2013, me **9.8 milionë Euro**;
- Qeveria Shqiptare me **4 milionë Euro**.

Realizimi i punimeve fizike per **Rural 3** është si më poshtë:

- Për Lot I, ka përfunduar në **15 shtator 2020**.
- Për Lot II, Punimet për këtë kontratë kanë përfunduar në **25 shtator 2020**.
- Për Lot III, Data e fillimit të punimeve është 02.09.2019. Progresi është në masën **85%**.
- Për Lotin IV, Kontrata për zbatimin e punimeve civile është nënshkruar më 18 prill 2019 dhe progresi është në masën **98%**.

RURAL 4

FUZR IV parashikon ndërhyrje të integruar në Bashkinë Himarë dhe vlerë financimi rreth **45.15 milionë Euro**. Ky projekt përfshin zonën e qytetit të Himarës, fshatrat Kuç, Buronjë (afër Kuç), Pilur, Kudhës, Vuno, Jal, Livadhet, Himara Fshat, Qeparo.

Njëkohësisht, projekti parashikon një studim për gjendjen e sistemit të kanalizimeve, ndërhyrje për sistemin e furnizimit me ujë në Orikum, zgjatim të sistemit të kanalizimeve në Nj.A. Orikum dhe riparime dhe masa plotësuese për vënien në funksionim të impiantit ekzistues në Orikum. Studimi i Fizibilitetit për Orikumin është miratuar nga KfW në datë 22 maj 2019. Në datë 3 qershor 2019, është nënshkruar Marrëveshja e Investimit ku përfshihen ndërhyrjet në Bashkinë Himarë dhe Nj.A. Orikum për masat e sipërpërmendura.

Nga ky projekt parashikohet të përfitojnë mbi 80,000 përfitues të drejtpërdrejtë dhe turistë që frekuentojnë zonën.

Realizimi për **Rural 4** është si më poshtë:

- Loti I përfunduar projekti i zbatimit;
- Loti II është në proces projektimi;
- Loti III është në proces përgatitja e konceptit të projektit dhe zgjidhjes teknike;
- Loti IV është në proces projektimi.

2.3.8. PROGRAMET IPA DHE GRANTET NGA DONATORE

Fondi Shqiptar i Zhvillimit është përzgjedhur si partner në 12 projekte IPA (Instrumenti i ndihmës së para-aderimit). 6 nga projektet financohen nga programi Interreg Adrion, 3 nga programi Itali-Shqipëri-Mal i Zi, një nga programi Interreg MED, një nga programi Greqi-Shqipëri dhe një nga Programi Shqipëri-Kosovë. Zbatimi i këtyre projekteve ka për qëllim nxitjen e bashkëpunimit dhe solidaritetit midis shteteve partnere në këto programe, përfitimin nga zhvillimet e ndërsjellta në burimet e pasura natyrore, kulturore dhe njerëzore, si dhe kontribut në rritjen e kohezionit ekonomik, social dhe territorial në rajon.

PROGRAME PËR ZHVILLIMIN E EKONOMISË, TURIZMIT, MJEDISIT, BUJQËSISË DHE BLEGTORISË

Programi Adrion investon në sistemet rajonale të inovacionit, trashëgiminë kulturore dhe natyrore, ndryshimet në mjedis, transportin e qëndrueshëm dhe lëvizshmërinë, të kombinuara me ngritjen e kapaciteteve. Në kuadër të këtij programi FSHZH po implementon projektet IMPRECO, Blue Boost, Innoxenia, ADRION 5 senses, Smart Heritage dhe Adrilink. Nëpërmjet këtyre projekteve arrihet krijimi i strategjive të përbashkëta dhe praktikat më të mira për të përmirësuar mbrojtjen rajonale të ekosistemit dhe shërbimeve ndaj tij; Rritja e potencialit të sektorëve tradicionale dhe atyre emergjente të ekonomisë blu me qëllim mbështetjen në zonën Adriatiko-Joniane; Inovacionin në turizëm në zonën Adriatiko-Joniane; Krijimi i emrit tregtar ADRION në fushën e turizmit si edhe nxitja e kënaqja e 5 shqisave të turistëve; Menaxhim i qëndrueshëm dhe promovim i trashëgimisë së përbashkët kulturore; Krijimi i rrjetit të interpretimit të peisazhit në Adriatik. Nga implementimi i këtyre projekteve është arritur:

- Kryerja e 11 trajnimeve diverse me përfitues në Bashkitë e Shkodrës, Lezhës, Durrësit dhe Sarandës mbi bujqësinë organike dhe ndikimin pozitiv në tkurrjen e kërcënimeve të mjedisit, mbi zgj
- idhjet innovative për përmirësimin e proceseve të biznesit të SME-vë në sektorët e peshkimit, akuakulturës dhe turizmit bregdetar e detar, mbi marketimin digjital të operatorëve në rajonin e Alpeve Shqiptare, mbi qëndrueshmërinë në destinacionet e turizmit natyror dhe kulturor.
- Hartëzimi i prodhuesve të artizanatit përreth Liqenit të Shkodrës dhe promovimi në pikat e informacionit në Shkodër dhe Malësi të Madhe.
- Ngritja e Rrjetit Ndërkombëtar të Aktorëve të Turizmit dhe Observatori i Inovacionit në Turizëm si pjesë e Platformës Teknologjike për Turizmin në rajonin Adriatik - Jon, që do të sjellë së bashku 4 grupet kryesore të interesit (akademia/qendra kërkimore, bizneset, politikëbërësit dhe

shoqërinë civile) për të ndarë njohuri, kapitalizuar eksperiencat më të mira në fushën e turizmit, si dhe për të shërbyer si një strukturë që do të mundësojë konsultim dhe benchmarking.

- Promovimi në nivel ndërkombëtar i destinacioneve të Alpeve Shqiptare në Hartën Shqisore dhe Platformën Elektronike shumëgjuhëshe.
- Përgatitja e një Libri Audio i cili promovon në mënyrë shumë interesante disa nga destinacionet më të spikatura turistike të shteteve partnere në këtë projekt, përfshirë Shqipërinë.
- Mbështetja e 5 SME në fushën e ekonomisë Blu nëpërmjet granteve prej 10,000 Euro për të implemetuar një inovacion.

Në fund të vitit 2020 ka nisur dhe vijon puna për ngritjen e Qendrës Virtuale të Ekspozimit për Shqipërinë. Kjo qendër do të ketë një funksion të trefishtë, duke promovuar brandin Adrion në turizëm, informuar dhe promovuar destinacionet turistike që ofrojnë eksperiencë të paharrueshme gjithëpërfshirëse për vizitorët, si dhe duke mundësuar një eksperiencë multisensoriale virtuale për të gjithë të interesuarit nëpërmjet turit virtual.

Programi Interreg MED ka objektiv kryesor promovimin e rritjes së qëndrueshme në zonën e Mesdheut duke nxitur konceptet dhe praktikën e reja dhe përdorimin e arsyeshem të burimeve. Programi mbështet integrimin social përmes një qasjeje të integruar dhe të bashkëpunimit bazuar në territor. Investimet në kuadër të këtij programi fokusohen në fusha si mbrojtja e burimeve natyrore dhe kulturore dhe fuqizimi i inovacioneve. Në kuadër të këtij programi FSHZH ka implemtuar projektin 4 Helix+. Ky projekt synon fuqizimin e grupeve të interesit të zonave detare përmes krijimit të platformës elektronike për ndarjen e njohurive dhe qasjen në favor të komunitetit për zhvillimin e ekonomisë blu. Në kuadër të këtij projekti janë kryer 8 trajnime midis SME-ve dhe Knoëledge providers për ekonominë Blu dhe i janë dhënë grante me një vlerë prej 10,000 Euro, gjashtë SME-ve që operojnë në zona bregdetare për të zhvilluar inovacionin në bizneset e tyre me qëllim rritjen e konkurrueshmërisë.

Programi i Bashkëpunimit ndërkufitar Greqi-Shqipëri (2014-2020) ka si objektiv të përgjithshëm "rritjen e standardit të jetesës së popullsisë duke promovuar zhvillimin e qëndrueshem lokal, në zonën ndërkufitare". Programi përqëndrohet në prioritetet që karakterizohen nga efekte të rëndësishme ndërkufitare ose paraqesin një potencial të lartë për arritjen e vlerës së shtuar nëpërmjet bashkëpunimit. Ky program mbështetet në dy akse prioritare si promovimi i mjedisit dhe infrastrukturës së qëndrueshme të transportit dhe infrastrukturës publike dhe nxitja e ekonomisë lokale. Në kuadër të këtij programi FSHZH po implemton projektin COMPLETE. Ky projekt ka si objektiv të mbështesë sipërmarrjen dhe të rrisë konkurrueshmërinë e SME-ve të

perfshira në sektorin blegtoral përmes inovacioneve të aplikuara në kujdesin shëndetsor të kafshëve dhe në sipërmarrjen e fermave të gjësë së gjallë. Në kuadër të këtij projekti janë organizuar disa trajnime për fermerët blegtoral të Zonave të Gjirokastrës dhe Vlorës për të rritur konkurrueshmërinë e tyre dhe organizuar ata në “clusters” ndërkufitar. Gjithashtu është përgatitur hartëzimi I sëmundshmërisë së dhenve në Bashkitë Vlorë dhe Gjirokastrë si edhe studimi dhe analiza për parandalimin e përhapjes së sëmundshmërive të kafshëve blegtorale.

Programi i Bashkëpunimit ndërkufitar Shqipëri-Kosovë (2014-2020), nxit bashkëpunimin midis Shqipërisë dhe Kosovës në zonat që kanë lidhje të drejtpërdrejta në kufi ose në afërsi të tyre. Programi synon të trajtojë sfidat e përbashkëta të identifikuar në rajonet kufitare dhe të shfrytëzojë potencialet ekonomike në zonat kufitare, duke rritur procesin e bashkëpunimit. Projekti në të cilin FSHZH është përzgjedhur, projekti VipDinarica, inkurajon turizmin dhe promovon trashëgiminë natyrore dhe kulturore në zonën e Bjeshkëve të Nemuna. Nëpërmjet këtij projekti janë shtuar 30 km shteg ecje në natyrë dhe markuar një total 115 km shteg ecje dhe biciklete, të cilat janë promovuar nëpërmjet organizimit të një Touri Familjarizues me përfaqësues të aktorëve të interesit dhe përfituesit në sektorin e turizmit të aventurës nga Shqipëria dhe Kosova. Janë identifikuar 110 atraksione natyrore, kulturore dhe historike përgjatë kësaj gjurme si dhe janë përcaktuar 15 itinerare të ecjes në natyrë.

Programi i Bashkëpunimit ndërkufitar Itali-Shqipëri-Mal i Zi (2014-2020), është një program i bashkëfinancuar nga Bashkimi Europian nëpërmjet instrumentit të para-aderimit dhe ka një buxhet total prej 92 Milion Euro. Ky program menaxhohet nga rajoni i Puljas, Itali dhe ka si objektiv të promovojë rritjen ekonomike dhe të intensifikojë bashkëpunimin në pjesën e poshtme të zonës së Adriatikut, duke zbatuar aksione të përbashkëta midis institucioneve kombëtare dhe rajonale dhe aktorëve jo-fitimprurës, duke mbështetur zhvillimin gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm. Ky program është i bazuar në 4 akse prioritare:

- Konkurrueshmëria e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme;
- Turizmi dhe Kultura;
- Mjedisi dhe Energjia;
- Transporti i Qendrueshëm.

FSHZH është angazhuar në bashkëpunim me organizatat dhe agjencitë partnere në detajimin e objektivave të projekteve, analizën e gjendjes aktuale për secilën nga tematikat dhe fushat e ndërhyrjes, hartimin e metodologjisë së ndërhyrjeve, planifikimin e aktiviteteve, identifikimin e aktorëve të interesuar dhe planifikimin

e përfshirjes së tyre në zbatimin e projektit. Në kuadër të këtij programi FSHZH po implementon projektet FILA, CoCoTour dhe ALMONIT. Nga implemtimi i këtyre projekteve FSHZH synon të krijojë në rang ndërkombëtar laboratorët FILA, të cilët janë “mjedise inovacioni” ku do të favorizohet bashkëpunimi ndërmjet aktorëve të sistemit të inovacionit për të përmirësuar aksesin në proceset kerkimore dhe në rezultatet e sipërmarrjeve; Ruajtjen, rritjen dhe promovimin e trashëgimisë natyrore dhe kulturore të komuniteteve bregdetare nëpërmjet nxitjes së modelit të eko-muzeut me qëllim menaxhimin e zgjuar dhe të qendrueshëm të turizmit; Krijimi i partneritetit afatgjatë midis palëve të interesuara nëpërmjet lidhjeve multimodale në ujërat e brendshem liqenore (liqeni i Shkodrës) dhe ato detare me Italinë. Përgjatë implementimit të këtyre projekteve:

- Janë identifikuar dhe hartëzuar pikat turistike të interesit në zonën e Himarës.
- Është rikonstruktuar shkolla 4 vjeçare Kampi, Fshat për ta kthyer në ekomuze.
- Është organizuar "Aksioni Pilot i Inkubacionit të Sipërmarrjeve të reja" për transferimin e njohurive dhe aftësive për krijimin e biznesit dhe ndryshimin në sektorin agro-ushqimor, duke përdorur modelin FILA.

Ka përfunduar studimi batimetrik i Liqenit të Shkodrës dhe vlerësimi i trafikut të mjeteve lundruese liqenore për ti hapur rrugë rikonstruksionit dhe rehabilitimit të tre moleve të Zogaj, Shirokë dhe Shkodër.

PROGRAMI “PARA PËR PUNË PUBLIKE NË BASHKITË E SHKODËR, FIER DHE DIMAL”

Për të minimizuar ndikimet e pafavorshme të përmbytjeve në Bashkitë Shkodër, Fier dhe Dimal, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ), financuar nga BMZ, janë partnerizuar në këtë projekt afatshkurtër që synon "Të krijojë perspektivë për emigrantët e rikthyer dhe familjet e tyre, si dhe njerëzit e tjerë në nevojë, përmes sigurimit të të ardhurave bazë dhe njëkohësisht të përmirësojë situatën e rrjeteve të kullimit përmes pastrimit të kanaleve”.

U vendos që projekti të përfshinte Njësitë Administrative Ana e Malit, Dajç, Bërdicë, Velipojë në Bashkinë e Shkodrës ku u pastruan 113.77 ml kanale kulluese, të cilat shërbyen 1035 hektarë tokë, Njësitë Administrative Topojë, Qendër, Dërmënas në Bashkinë e Fierit ku u pastruan 79,927 ml kanale kulluese, duke shërbyer në një sipërfaqe toke prej 474.5 hektarësh dhe Njësitë

Administrative Poshnje dhe Qendër në Dimal ku u pastruan 10.48 ml kanale kulluese, duke shërbyer 950 hektarë tokë.

Ndërhyrja e projektit rriti ndërgjegjësimin dhe ndjeshmërinë e komunitetit për mirëmbajtjen e kanaleve kulluese, ndërsa rriti paralelisht të ardhurat e familjeve për ata që janë të punësuar (njerëz të papunë, të kthyer nga emigrimi dhe me të ardhura të ulëta). Një total prej më shumë se 319 njerëz / muaj kanë përfituar drejtpërdrejt përmes rritjes së të ardhurave për tre bashkitë përkatëse duke injektuar kështu në një periudhë më pak se 2-mujore një total prej 26,241,505,92 lekë në ekonominë lokale.

Përveç atyre që ishin të punësuar, komunat e prekura ishin gjithashtu përfituese të drejtpërdrejta të projektit, pasi ato ishin në gjendje të pëfitonin pronësinë e mjeteve në fund të projektit, duke pasur parasysh që sigurimi i mjeteve (të tilla si sharra elektrike të certifikuara nga BE, grepa korrëse, pompa etj.) dhe rrobat e punës ishin masa shoqëruese të këtij projekti.

SKEMA E GRANTEVE PËR ZHVILLIMIN RAJONAL

Fondi Shqiptar i Zhvillimit mbështetur në Marrëveshjen dy-palëshe me Programin e RDPA është caktuar si “Mandated Body” për monitorimin e implementimit të 8 projekteve në 7 Bashkitë e prekura nga tërmeti, specifikisht në Bashkinë e Tiranës, Kavajës, Rogozhinës, Krujës, Lezhës Mirditës dhe Kamzës. Fondi i vënë në dispozicion për këto Bashki nga Programi RDPA është 2 milion Euro. Bashkitë pas lidhjes së kontratave të Grantit me Programin e RDPA në datë 27.11.2020 kanë filluar implementimin e projekteve të mëposhtme:

Tabela 2. Projektet të cilat po implementohen, pas lidhjes së kontratave të Grantit me Programin e RDPA

| Nr | Bashkia | Emërtimi | Vlera Lek (me TVSH) |
|-----------|----------------|---|----------------------------|
| 1 | Tiranë/ Farkë | Parku i liqenit të Farkës | 25,881,064.00 |
| 2 | Kavajë | Rikualifikim i qendrës kulturore ‘Aleksandër Moisiu’ | 38,997,383.00 |
| 3 | Tiranë/Petrelë | Monumenti që zgjon turizmin | 7,680,980.00 |
| 4 | Rrogozhinë | Rikonstruktimi i strukturës dhe hapësirave të Pallatit të Kulturës Rrogozhinë | 40,251,072.00 |
| 5 | Krujë | Rehabilitimi i sallës së koncerteve ‘Ibrahim Bërdaku’ | 26,123,608.00 |
| 6 | Lezhë | Përmirësim i infrastrukturës dhe sigurisë në shëtitoren e lumit Drin | 32,297,011.00 |
| 7 | Mirditë | Përmirësim i rrjetit ujitës Malaj-Tarazh | 39,382,738.00 |
| 8 | Kamëz | Cerdhe e re për vogelushë të lumtur. | 42,505,851.00 |

3. MENAXHIMI FINANCIAR

3.1. LIMITET BUXHETORE DHE NDRYSHIMET NË PBA 2020-2022

Me Ligjin nr. 88/ 2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, është miratuar buxheti i Fondit Shqiptar të Zhvillimit për vitin 2020 dhe vitet 2021-2022. Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 2169/ 19 Prot, datë 26.02.2020, protokolluar në FSHZH me nr. 28/ 3 Prot, datë 27.02.2020, “Dërgohet detajimi i buxhetit të vitit 2020-2022”, Ministria e Financës dhe Ekonomisë ka miratuar detajimin e shpenzimeve kapitale për Fondin Shqiptar të Zhvillimit, në vlerën 14,898 milionë Lekë, sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela 3. Informacion mbi buxhetin e miratur 2020-2022

| Nr. | Programet | Viti 2020 | Viti 2021 | Viti 2022 |
|--|-------------------------------------|-----------------------|-----------------------|-----------------------|
| 1 | Programe Zhvillimi | 2,956,279,000 | 1,712,155,578 | 1,677,593,765 |
| 2 | Kosto Lokale | 740,750,000 | 1,020,391,534 | 710,406,235 |
| 3 | TVSH | 798,971,000 | 1,067,452,888 | 1,212,000,000 |
| 4 | Infrastruktura Vendore dhe Rajonale | 4,500,000,000 | 3,000,000,000 | 3,000,000,000 |
| 5 | Programi "100 Fshatrat" | 200,000,000 | 700,000,000 | 700,000,000 |
| Financim i Brendshem, IVR, 100 Fshatrat | | 9,196,000,000 | 7,500,000,000 | 7,300,000,000 |
| 1 | Financim i Huaj | 5,702,000,000 | 6,260,000,000 | 6,160,000,000 |
| Total | | 14,898,000,000 | 13,760,000,000 | 13,460,000,000 |

Shenim: Sipas Ligjit 88/2019 "Per Buxhetin e vitit 2020"

3.2. LIMITET BUXHETORE DHE NDRYSHIMET NË BUXHETIN E VITIT 2020

Gjatë vitit ushtrimor financiar 2020, buxheti i FSHZH-së ka pësuar ndryshime në zbatim të Akteve të ndryshme Normative apo Vendimeve të Këshillit të Ministrave. Konkretisht buxheti i fillestar është rishikuar me Aktin Normativ Nr. 28 datë 02.07.2020 dhe Aktin Normativ nr. 34 datë 16.12.2020, si dhe me VKM nr. 356, datë 26.02.2020 dhe VKM nr. 1127, datë 30.12.2020 në kuadër të Blerjes së godinës "Poli i Drejtësisë" (Transfertë). Efekti financiar në buxhetin e FSHZH-së për vitin 2020 ndryshon me një rritje rreth 1,322 milionë lekë. Pra nga 14,898 milionë lekë bëhet 16,220 milionë lekë.

Tabela e mëposhtme pasqyron efektet financiare në buxhetin e FSHZH-së në zbatim të ndryshimeve të sipërcituara.

Tabela 4. Informacion mbi ndryshimet në buxhet 2020

| Nr. | Programi | Buxheti Filjestar 2020 | VKM nr 356, dt 26.02.2020 | AN nr 28, dt 02.07.2020 | Rialokim tetor | Rindertimi kosto menashimi | Buxheti 2020 pas AN 28 dhe VKM 356 | Rialokim 11.11.2020 | AN 34, dt 16.12.2020 | VKM nr 1127, dt 30.12.2020 | Buxheti pas AN 34 Dhjetor 2020 | Tot. dif. Buxhet 2020 (Lekë) |
|-----|--|------------------------|---------------------------|-------------------------|----------------|----------------------------|------------------------------------|---------------------|------------------------|----------------------------|--------------------------------|------------------------------|
| 1 | Programi Zhvillimi | 2,956,279,000 | | 3,000,000,000 | (405,741,222) | | 5,550,537,778 | (425,016,716) | (1,300,000,000) | 170,000,000 | 3,995,521,062 | 1,039,242,062 |
| 2 | Infrastruktura Vendore Rajonale | 4,500,000,000 | | | | | 4,500,000,000 | - | (1,000,000,000) | | 3,500,000,000 | (1,000,000,000) |
| 3 | Programi "100 Fshatrat" | 200,000,000 | (200,000,000) | | | | 0 | | | | | (200,000,000) |
| 4 | Programi Blerje e Godines "Poli i Drejtessise " Transferte | 0 | 200,000,000 | | | | 200,000,000 | | | | 200,000,000 | 200,000,000 |
| 5 | Financim i Kostose se Menaxhimit te Projekteve qe zbatohen nga FSHZH/Kosto lokale dhe Bashkefinancim | 740,750,000 | | | 102,745,271 | 302,042,996 | 1,145,538,267 | 295,266,133 | | | 1,440,804,400 | 700,054,400 |
| 6 | Fondi Shqiptar i Zhvillimit (TVSH) | 798,971,000 | | | 302,995,951 | | 1,101,966,951 | 129,750,583 | | | 1,231,717,534 | 432,746,534 |
| | Total Financimi i Brendshem | 9,196,000,000 | 0 | 3,000,000,000 | 0 | 302,042,996 | 12,498,042,996 | 0 | (2,300,000,000) | 170,000,000 | 10,368,042,996 | 1,172,042,996 |
| | Financim i Huaj | 5,702,000,000 | 0 | 0 | 0 | 0 | 5,702,000,000 | - | 150,000,000 | 0 | 5,852,000,000 | 150,000,000 |
| | Total buxhet 2020 (FH+FE) | 14,898,000,000 | 0 | 3,000,000,000 | 0 | 302,042,996 | 18,200,042,996 | 0 | (2,150,000,000) | 170,000,000 | ***** | 1,322,042,996 |

Gjithashtu gjatë vitit 2020 me Vendime të Këshillit të Ministrave është angazhuar rast pas rasti si njësi zbatuese për Programin për Rindërtim dhe Zhvillim në Zonat e Prekura nga Tërmeti për komponentët e projektimit, rindërtimit dhe rikonstruksionit të objekteve arsimore, rindërtimin e shtëpive individuale, infrastrukturës publike si dhe njërive të banimit në pallat. Në kuadër të këtij programi FSHZH-së i janë miratuar VKM-të përkatëse nëpërmjet të cilave i janë akorduar fonde për zbatimin e këtij programi në vlerë totale 31,241,111,742 Lekë. Ndërkohë, për vitin 2020, totali i fondeve të akorduara për Programin për Rindërtim dhe Zhvillim në Zonat e Prekura nga Tërmeti, në zbatim të VKM-ve të miratuara, është 9,907,591,025 Lekë.

Tabela 5. Informacion mbi ndryshimet në buxhet për Programin për Rindërtim dhe Zhvillim në Zonat e Prekura nga Tërmeti

| Nr. | Programi i Rindërtimit | Ishte (në mijë Lekë) | Bëhet (në mijë Lekë) | Ndryshimi (në mijë Lekë) |
|-----|----------------------------------|----------------------|----------------------|--------------------------|
| 1 | Rindertimi i objekteve arsimore | 1,086,938 | 4,125,707 | 3,038,769 |
| 2 | Rindertim i banesave individuale | 6,528,564 | 2,492,978 | -4,035,586 |
| 3 | Banesa Kolektive | 3,442,311 | 1,925,444 | -1,516,867 |
| 4 | Infrastruktura Publike | 1,088,094 | 1,363,462 | 275,368 |
| | Total | 12,145,907 | 9,907,591 | -2,238,316 |

Pra, në total buxheti i FSHZH për vitin 2020 së bashku me Programin për Rindërtim dhe Zhvillim në Zonat e Prekura nga Tërmeti, llogaritet në rreth 25,825 milionë lekë.

3.3. REALIZIMI FINANCIAR SIPAS PROGRAMEVE PËR 2020

Gjatë vitit 2020, FSHZH ka pasur në zbatim 11 programe/projekte me financim të huaj dhe 4 programe me financim të brendshëm.

Programme me Financim të Huaj

- Programi PKIV, “Zhvillimi i Alpeve Shqiptare dhe Zonave Bregdetare”, financuar nga CEB, WBIF dhe Qeveria Shqiptare;
- Programi “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale III”, financuar nga KfW, IPA 2013, WBIF, Qeveria Shqiptare dhe përfituesit e drejtpërdrejtë;
- Programi “Rehabilitimi i Rrugës së Lumit të Vlorës”, financuar nga Fondi Kuvajtian, dhe Qeveria Shqiptare;
- Programi “Rehabilitimi i Rrugës së Lumit të Vlorës” financuar nga Fondi Saudit dhe Qeveria Shqiptare;
- Programi “Për Zhvillimin e Integruar Urban dhe Turizmin”, financuar nga Banka Botërore;
- Programi “Rrugët Lidhëse Rurale dhe Rajonale” financuar nga Banka Botërore dhe BERZH;
- Programi “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale IV”, financuar nga KfW;
- Programi IPA Adrion, Intereg-Med, Vip Dinarica CBC-Kosovo dhe IPA Trilateral;
- Programi për Rindërtim dhe Zhvillim në Zonat e Prekura nga Tërmeti (Qeveria Shqiptare, CEB Grant);
- Programi GIZ për punime në bashkitë Shkodër, Fier dhe Dimal.

Programme me Financim të Brendshëm

- Programi për Rehabilitimin e Segmenteve Rrugore Prioritare;
- Programi Infrastruktura Vendore Rajonale;
- Programi 100 Fshatrat, I cili nuk nisi zbatimin gjatë vitit 2020 për shkak të heqjes së fondeve në zbatim të VKM nr.356, datë 26.02.2020;
- Programi për Rindërtim dhe Zhvillim në Zonat e Prekura nga Tërmeti.

Gjatë vitit 2020, realizimi në total i buxhetit të FSHZH është në masën 87%. Realizimi financiar i programeve me financim të huaj në masën 97% dhe realizimi financiar për programet me financim të brendshëm në masën 99%. Ndërkohë, realizimi financiar i Programit për Rindërtim dhe Zhvillim në Zonat e Prekura nga Tërmeti është në masën 68%. Paraqitur në tabelën si më poshtë:

Tabela 6. Informacion mbi realizimin financiar gjatë vitit 2020 sipas financimit

| Nr. | Programet | Buxheti 2020 | Realizimi buxhetor 31.12.2020 | % e realizimit |
|-----|---|-----------------------|-------------------------------|----------------|
| 1 | Punet ne Komunitet IV Zhvillimi i Alpeve Shqiptare dhe zonave bregdetare | 464,736,206 | 464,736,206 | 100% |
| 2 | Punet ne Komunitet IV Zhvillimi i Alpeve Shqiptare dhe zonave bregdetare /Grant | 31,046,067 | 31,046,067 | 100% |
| 3 | Programi i Rehabilitimit te Lumit te Vlores (Kuvait)/Kredi | 1,943,943,052 | 1,939,684,392 | 100% |
| 4 | Programi i Rehabilitimit te Lumit te Vlores (Kuvait)/ Grant | - | - | 0% |
| 5 | Programi i Rehabilitimit te Lumit te Vlores (Saudit) /Kredi | - | - | 0% |
| 6 | Projekti per Zhvillim te Integruar Urban dhe Turistik | 500,000,000 | 499,343,107 | 100% |
| 7 | Mbeshtetje per sistemin e furnizimit me Uje ne zonat rurale III/Kredi | 1,424,419,124 | 1,303,807,345 | 92% |
| 8 | Mbeshtetje per sistemin e furnizimit me Uje ne zonat rurale /GRANT | 389,620,221 | 377,645,759 | 97% |
| 9 | Mbeshtetje per sistemimin e furnizimit me Uje ne Zonat Rurale RWS IV Himare-Kredi | - | - | 0% |
| 10 | Mbeshtetje per sistemimin e furnizimit me Uje ne Zonat Rurale RWS IV Himare-Grant | 83,235,330 | 83,235,330 | 100% |
| 11 | IPA ADRION + CROSS BORDER + INTERREG MED+IPA AZHR | 50,000,000 | 37,339,050 | 75% |
| 12 | Projekt Trilateral Nderkufitar | 15,000,000 | 10,068,212 | 67% |
| 13 | BERZH-IPA Program Per Zhvillimin e Turizmit/ kredi | - | - | 0% |
| 14 | BEI - Asistence Teknike; Porta E Alpeve | - | - | 0% |
| 15 | Programi i rrugeve Rurale (konektiviteti) BERZH | - | - | 0% |
| 16 | Programi i rrugeve Rurale (konektiviteti) BB | 950,000,000 | 945,471,837 | 100% |
| 17 | Programi I rindertimit Kredi Grant | - | - | 0% |
| 18 | IPA Program per Zhvillimin e Turizmit, Grant | - | - | 0% |
| 19 | KfW Zhvillim Rajonal/ Kredi | - | - | 0% |
| | Financimi i Huaj | 5,852,000,000 | 5,692,377,305 | 97% |
| 1 | Qeveria Shqiptare (Investime) | 3,995,521,060 | 3,910,966,438 | 98% |
| 2 | Projekte te grantit infrastruktura vendore dhe Rajonale | 3,500,000,000 | 3,492,349,467 | 100% |
| 3 | Projekte te programit "100 Fshatrat" | - | - | 0% |
| 4 | Blerje e godines "Poli I Drejtesise" (Transferte) | 200,000,000 | 200,000,000 | 100% |
| 5 | Fondi Shqiptar i Zhvillimit (TVSH) Ujesjellesa | 516,962,229 | 477,567,903 | 92% |
| 6 | Financim i Kosos se Menaxhimit te Projekteve qe zbatohen nga FSHZH/Kosto lokale Ujesjellesa etj | 100,000,000 | 100,000,000 | 100% |
| 7 | Financim i Kosos se Menaxhimit te Projekteve qe zbatohen nga FSHZH/Kosto lokale CEB | | | |
| 8 | Financim i Kosos se Menaxhimit te Projekteve qe zbatohen nga FSHZH/Kosto lokale Rruge etj | 1,340,804,401 | 409,136,056 | 100% |
| 9 | Financim i Kosos se Menaxhimit te Projekteve qe zbatohen nga FSHZH/Kosto lokale /Kuwait | | 629,625,805 | |
| 10 | Financim i Kosos se Menaxhimit te Projekteve qe zbatohen nga FSHZH/Kosto lokale /Rindertimi | | 302,042,540 | |
| 11 | Fondi Shqiptar i Zhvillimit (TVSH) Rruge etj paguar nga Thesari | 714,755,305 | 714,755,305 | 100% |
| | Financim i Brendshem | 10,368,042,995 | 10,236,443,513 | 99% |
| 1 | Rindertimi i objekteve arsimore | 3,999,073,290 | 3,122,374,707 | 78% |
| 2 | Rindertim i banesave individuale | 2,413,362,355 | 1,730,176,335 | 72% |
| 3 | Banesa Kolektive | 1,852,808,523 | 390,364,701 | 21% |
| 4 | Infrastruktura Publike | 1,340,303,861 | 1,279,305,198 | 95% |
| | Programi i Rindertimit | 9,605,548,028 | 6,522,220,940 | 68% |
| | Total Buxhet 2020 | 25,825,591,023 | 22,451,041,759 | 87% |

Realizimi i kategorive të Buxhetit për vitin 2020

Gjatë këtij viti, FSHZH ka menaxhuar një fond prej rreth 16,070 milionë Lekë, me një realizim financiar në masën 98% kundrejt buxhetit të rishikuar, ndërkohë, sipas VKM-ve përkatëse, FSHZH ka menaxhuar dhe një fond prej rreth 6,580 milionë Lekë në kuadër të Programit për Rindërtim dhe Zhvillim në Zonat e Prekura nga Tërmeti.

- Infrastruktura: Ky zë përbën aktivitetin kryesor të institucionit dhe përfaqëson investimet në infrastrukturë për:
- Punime civile për rikonstrukcion dhe përmirësim të infrastrukturës rrugore;
- Gjelbërim të infrastrukturës rrugore dhe objekteve të tjera;
- Rehabilitim të zonave urbane;
- Rehabilitim dhe ndërtim të ujësjellësive ruralë;
- Restaurimin e objekteve të trashëgimisë kulturore, etj.

Investimet në infrastrukturë për vitin 2020 janë realizuar në masën 13,680 milionë Lekë ose rreth 97% e buxhetit të rishikuar. Realizimi i kësaj kategorie në këtë vlerë vjen si rezultat i faktit që gjatë muajit dhjetor, janë kryer pagesa direkte në kuadër të Programit “Rehabilitimi i Rrugës së Lumit të Vlorës” në vlerën 295 milionë Lekë, si dhe për Programin “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale III” në vlerën 1 mln Euro për të cilat nuk ka konfirmim nga huadhënësi brenda periudhës së raportimit. Gjatë vitit kanë qenë në proces zbatimi rreth 37 kontrata punimesh nga programe me financim të huaj. Gjithashtu, në kuadër të Programit të investimeve të Qeverisë Shqiptare, janë në zbatim rreth 74 kontrata nga të cilat 26 janë të reja. Në kuadër të programit Infrastruktura Vendore Rajonale gjatë vitit 2020 kanë qenë në zbatim 28 kontrata, nga të cilat 11 kontrata janë të reja për të cilat nuk ka pasur financim. Në kuadër të Programit për Rindërtim dhe Zhvillim në Zonat e Prekura nga Tërmeti, për Ndërtimin e Shkollave janë të lidhura 23 kontrata nga të cilat 22 kontrata janë në zbatim, ndërsa një kontratë është e re, për “Infrastrukturën rrugore dhe urbane” janë të lidhura 11 kontrata nga të cilat 8 janë në zbatim dhe 3 janë kontrata të reja, për banesa individuale janë lidhur 5 kontrata nga të cilat 4 janë në zbatim dhe një është kontratë e re dhe për banesa kolektive (pallat) janë lidhur 17 kontrata nga të cilat 3 janë në zbatim dhe 14 janë kontrata të reja.

Tabela 7. Informacion mbi realizimin financiar gjatë vitit 2020, sipas kategorive

| Nr | Kategoria | Buxheti Lekë | Realizimi vjetor 2020 | % |
|---------------|--|-----------------------|-----------------------|------------|
| 1 | Punime Civile | 14,053,661,850 | 13,680,193,275 | 97% |
| 2 | Design&superv. | 677,931,194 | 558,464,032 | 82% |
| 3 | Asistence Teknike | 67,075,000 | 65,180,371 | 97% |
| 4 | Training | 25,963,950 | 12,524,886 | 48% |
| 5 | Investime &PaisjeFZSHH | 29,041,000 | 9,418,024 | 32% |
| 6 | Kosto Operative miratuar Vendim KD 197, dt. 04.03.2020 | 570,496,000 | 452,706,937 | 79% |
| 7 | Kosto menaxhimi 2017-2018 | 205,719,000 | 205,719,000 | 100% |
| 8 | (Transferim kapital) Poli I Drejtesise | 790,200,000 | 790,200,000 | 100% |
| 9 | Veprime te kryera per llogari te vitit 2020 | | 319,539,307 | |
| 10 | Rezerve /kosto menaxhimi | 4,000,000 | - | |
| Totali | | 16,424,087,994 | 16,093,945,832 | 98% |





Tabela 8. Realizimi financiar për periudhën janar-dhjetor 2020 për kategorinë "Investime"

| Nr | Programet | Pesha Specifike në % kundrejt realizimit | Realizimi në Lekë |
|---------------|--|--|-----------------------|
| 1 | Programi PK IV Zhvillimi i Alpeve Shqiptare dhe Z. Bregdetare CE | 2.65% | 363,021,894 |
| 2 | Programi Rehabilitimi i Rrugës së Lumit të Vlorës Kuwait | 13.72% | 1,876,965,658 |
| 3 | Programi Për Zhvillimin e Integruar Urban dhe Turizmin BB | 2.73% | 372,905,904 |
| 4 | Programi Furnizimit me Uje III | 10.91% | 1,492,712,851 |
| 5 | Programi Rrugët Lidhëse Rurale dhe Rajonale | 6.22% | 850,264,116 |
| 6 | Investime te Qeverise Shqiptare per FZHR, kosto Lokale dhe TVS | 63.77% | 8,724,322,852 |
| Totali | | 100% | 13,680,193,275 |



Grafiku 1. Pesha Specifike në % kundrejt realizimit

Projektim-Supervizimi

Gjatë këtij viti ky zë është realizuar në vlerën rreth 558 milionë Lekë ose 82% kundrejt buxhetit të rishikuar dhe përfshin shpenzime për projektim dhe supervizion të punimeve civile sipas programeve përkatëse:

- Programi PK IV, “Zhvillimi i Alpeve Shqiptare dhe Zonave Bregdetare” janë financuar nga CEB dhe bashkëfinancim nga Qeveria Shqiptare rreth 110 milionë Lekë;
- Programi “Për Zhvillimin e Integruar Urban dhe Turizmin”, janë financuar nga Banka Botërore rreth 66 milionë Lekë;
- Programi “Rrugët Lidhëse Rurale dhe Rajonale”, janë financuar nga Banka Botërore rreth 60 milionë Lekë;
- Programi “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale IV”, janë disbursuar rreth 84 milionë Lekë;
- Programi “Rehabilitimi i Rrugës së Lumit të Vlorës”, janë disbursuar rreth 62 milionë Lekë;
- Programi “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale III”, janë disbursuar rreth 176 milionë Lekë.

Ndërsa, në kuadër të Programit për Rindërtim dhe Zhvillim në Zonat e Prekura nga Tërmeti, janë financuar nga CEB Grant rreth 58 milionë Lekë në kategorinë projektim.

Asistenca Teknike

Është realizuar në vlerën rreth 65 milionë Lekë ose 97% kundrejt buxhetit të rishikuar dhe përfshin shpenzime në kuadër të:

- Programit “Për Zhvillimin e Integruar Urban dhe Turizmin”, në vlerën 5 milionë Lekë;
- Programeve IPA Adrion, IPA Trilateral dhe Interreg Med, në vlerën 34 milionë Lekë;
- Programi PK IV, “Zhvillimi i Alpeve Shqiptare dhe Zonave Bregdetare”, në vlerën 20 milionë Lekë;
- Qeveria Shqiptare, si bashkëfinancues për projektet me financim të huaj, në vlerën 6 milionë Lekë.

Kualifikime

Është realizuar në vlerën rreth 13 milionë Lekë ose 48% kundrejt buxhetit të rishikuar dhe përfshin shpenzime të financuara nga IPA Adrion, Interreg Med dhe VIP Dinarica Kosova dhe me bashkëfinancim nga Qeveria Shqiptare, kryesisht për pjesëmarrje në takime me përfaqësuesit e programeve. Kjo kategori nuk është realizuar sipas parashikimit të buxhetuar për arsye të situatës së krijuar nga COVID -19.

Investime dhe pajisje

Gjatë këtij viti në këtë komponent janë disbursuar rreth 9 milionë Lekë ose 32% kundrejt buxhetit të rishikuar, për blerje pajisje kompjuterike për nevoja të stafit në zyrat qendrore dhe ato rajonale.

Të ardhura të tjera

Gjatë aktivitetit ekonomiko-financiar të saj, FSHZH realizon të ardhura në vlera monetare nga aktivitetet dytësore, si shitja e dokumentave të tenderit, interesa depozitë me afat, etj. Gjatë këtij viti, janë arkëtuar rreth 2.3 milion Lekë të ardhura nga të cilat 807 mijë Lekë nga shitja e dokumentave për tender si dhe 1.5 mln Lekë përftuar nga interesi i depozitave me afat.

Pas ndryshimeve të sipërpermendura buxheti i FSHZH-së, ndryshoi në 16,424 milionë lekë nga buxheti i miratuar prej 15,308 milionë lekë.

[Aneks 1: Miratimi i buxhetit faktik sipas kategorive përkatëse](#)

Gjatë këtij vitit 2020, në zbatim të udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, janë përgatitur Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin ushtrimor

2019, të cilat në datë 31 mars 2020 janë dorëzuar në MFE, si dhe në Degën e Thesarit.

Kompania e auditimit të jashtëm Grant Thornton, e përzgjedhur nga MFE, ka filluar në muajin janar 2020 procesin e auditimit të Pasqyrave Financiare për vitin ushtrimor 2018, proces i cili ka përfunduar dhe është dorëzuar raporti përfundimtar i auditimit.

Gjithashtu, është përcjellë pranë MFE, në cilësinë e institucionit që kryen përzgjedhjen e kompanisë audituese, kërkesa si dhe Termat e Referencës për auditimin e Pasqyrave Financiare për vitin ushtrimor 2019. Aktualisht ka filluar procesi i auditimit të jashtëm nga Grant Thornton e përzgjedhur nga MFE e cila ende është në proces auditimi.

Në zbatim të Udhëzimit nr. 9, datë 28.02.2020 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023” të MFE, pas punës përgatitore me departamentet, është përpunuar informacioni lidhur me përmbylljen e fazës së parë PBA 2021-2023, dhe është dorëzuar në MFE brenda afateve të përcaktuara dhe instruksioneve të dërguara nga MFE. Gjatë muajit Dhjetor

2020 është dërguar në MFE dhe detajimi sipas programeve dhe limitit buxhetor të miratuar për vitet 2021-2023 sipas propozimeve të dërguara nga menaxherët e projekteve.

Departamenti i Financës, gjatë këtij viti, ka raportuar në mënyrë periodike pranë MFE dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit dhe Drejtorisë së Borxhit, sipas kërkesave lidhur me:

- Monitorimin e investimeve publike me financues të huaj;
- Disbursimet dhe shpenzimet sipas programeve dhe huadhënësve respektivë.

Njëkohësisht janë dërguar raportet periodike të raportimit pranë Bankës Botërore, KfW dhe CEB në përputhje me formatet sipas marrëveshjeve respektive lidhur me burimin dhe përdorimin e fondeve për vitin 2020.

Pranë MFE, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, është dërguar kërkesa me detajimin e buxhetit për çdo program me financim të huaj, si dhe për çdo kod për objektet me financim të brendshëm për vitin 2020, si dhe është ndjekur në vazhdimësi sipas rastit çdo kërkesë për rialokim në nivel programi dhe projekti.

Kosto Administrative e FSHZH-së

FSHZH në rolin e agjencisë zbatuese menaxhon projekte/programe zhvillimore të cilat janë financuar nga Qeveria Shqiptare dhe/ose donatorë të ndryshëm, që kanë si qëllim zhvillimin rajonal, vendor dhe kostoja e menaxhimit të zbatimit të këtyre programeve është burimi i të ardhurave mbi bazën e të cilave FSHZH realizon funksionimin dhe përmbushjen e detyrave dhe objektivave të saj.

Me Vendimin Nr 226, dt. 21.03.2017, të Këshillit të Ministrave “Për financimin e koston së menaxhimit të projekteve që zbatohen nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit” u vendos financimi i koston së menaxhimit të projekteve që zbatohen nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, të cilat nuk e kanë të parashikuar këtë kosto në marrëveshjet përkatëse të financimit në masën 3% mbi vlerën totale të financimit të çdo programi/projekti.

Në zbatim të VKM-së Nr. 226, dt. 21.03.2017, të Këshillit të Ministrave “Për financimin e koston së menaxhimit të projekteve që zbatohen nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit” për vitin 2020, kosto e manxhimit e përfutur është rreth 935 milion Lekë. Ndërkohë kosto e menaxhimit për projektet, të cilat e kanë të përfshirë këto kosto brenda marrëveshjes së financimit për vitin 2020 ka qenë rreth 238 milionë. Nga kosto e menaxhimit të vitit 2020, mbetet e disponueshme për t’u përdorur për vitin 2021 rreth 640 milionë lekë.

Kosto menaxhimi FSHZH për vitin 2020

FSHZH në rolin e agjencisë zbatuese menaxhon projekte/programe zhvillimore të cilat janë financuar nga Qeveria Shqiptare dhe/ose donatorë të ndryshëm, që kanë si qëllim zhvillimin rajonal, vendor dhe kostoja e menaxhimit të zbatimit të këtyre programeve është burimi i të ardhurave mbi bazën e të cilave FSHZH realizon funksionimin dhe përmbushjen e detyrave dhe objektivave të saj.

Me Vendimin Nr 226, dt. 21.03.2017, të Këshillit të Ministrave “Për financimin e koston së menaxhimit të projekteve që zbatohen nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit” u vendos financimi i koston së menaxhimit të projekteve që zbatohen nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, të cilat nuk e kanë të parashikuar këtë kosto në marrëveshjet përkatëse të financimit në masën 3% mbi vlerën totale të financimit të çdo programi/projekti.

Në zbatim të VKM-së Nr. 226, dt. 21.03.2017, të Këshillit të Ministrave “Për financimin e koston së menaxhimit të projekteve që zbatohen nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit” për vitin 2020, kosto e manxhimit e përfutur është rreth 935 milionë Lekë, nga të cilat 206 milionë lekë kosto e menaxhimit të projekteve të periudhës 2017-2018 dhe rreth 302 milionë lekë kosto menaxhimi e Programit për Rindërtim dhe Zhvillim në Zonat e Prekura nga Tërmeti. Ndërkohë, kosto e

menaxhimit për projektet, të cilat e kanë të përfshirë këto kosto brenda marrëveshjes së financimit, për vitin 2020, ka qenë rreth 238 milionë ose rreth 1,173 mld lekë në total. Nga kosto e menaxhimit të vitit 2020, mbetet e disponueshme për t'u përdorur për vitin 2021 rreth 640 milionë lekë.

Shpenzime operacionale 2020

Me Vendim Bordi nr 197 datë 04.03.2020, për vitin 2020, FSHZH-së i janë miratuar shpenzime operacionale në vlerën 570 mln Lekë.

Këto shpenzime gjatë janë realizuar në vlerën 452 milionë Lekë ose rreth 79% kundrejt buxhetit të miratuar.

Realizimi i zërave të shpenzimeve të kësaj kategorie kundrejt buxhetit vjetor është paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Tabela 9. Informacion mbi realizimin e zërave të shpenzimeve të kësaj kategorie kundrejt buxhetit vjetor

| Nr. | Zerat | Buxhet 2020 | Realizimi i kostos Viti 2020 (Lekë) | Realizimi ne % (Lekë) |
|--------------|--------------------------------|--------------------|-------------------------------------|-----------------------|
| 1 | Pagat | 470,400,000 | 394,992,897 | 84% |
| 2 | Kanceleri | 4,420,000 | 4,239,632 | 96% |
| 3 | Karburant | 13,000,000 | 9,187,117 | 71% |
| 4 | Servis makinash/siguracion | 11,000,000 | 8,866,236 | 81% |
| 5 | Dieta | 5,500,000 | 2,058,618 | 37% |
| 6 | Telefon dhe PT | 3,300,000 | 2,650,945 | 80% |
| 7 | Internet | 1,000,000 | 589,730 | 59% |
| 8 | Energji Elektrike/Ujë | 4,000,000 | 2,672,723 | 67% |
| 9 | Zyra me qera | 7,000,000 | 5,413,039 | 77% |
| 10 | Mirembajtje/Sigurim godine | 27,326,000 | 8,811,147 | 32% |
| 11 | Te tjera/Petty cash/PCU Admi | 5,200,000 | 5,200,000 | 100% |
| 12 | Publikimi & Promovime | 6,000,000 | 3,325,720 | 55% |
| 13 | Kontrata Sherbimi/PCU | 7,000,000 | 1,338,890 | 19% |
| 14 | Shp. gjyqesore/perkthime | 4,000,000 | 961,606 | 24% |
| 15 | Servis kompjuter dhe fotokopje | 1,350,000 | 1,217,533 | 90% |
| 16 | Bank charges | | 1,439,239 | |
| TOTAL | | 570,496,000 | 452,965,072 | 79% |

a. Shpenzimet për paga, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore

Shpenzimet për pagat dhe sigurimet shoqërore për vitin 2020 janë parashikuar në shumën 470 milionë Lekë. Ky zë është realizuar në masën 84% kundrejt buxhetit të miratuar. Në këtë zë janë përfshirë shpenzimet e pagave, sigurimi i jetës, shëndetit dhe pensionit suplementar si dhe trajtimi ushqimor. Gjatë vitit

2020 numri në strukturën organizative të FSHZH është 164 punonjës, nga të cilat gjatë vitit 2020 janë faktikisht të punësuar 139 punonjës. Numri i vendeve të paplotësuara impaktoi në uljen e shpenzimeve krahasuar me buxhetin e zërit paga gjatë vitit 2020.

b. Shpenzimet për kancelari

Shpenzimet kryesore në këtë zë janë kryesisht për blerje materiale zyre, kancelari të ndryshme, letër, bojra për fotokopje dhe printera, etj. Buxheti vjetor për këtë zë është parashikuar 4,42 milionë Lekë. Shuma e përdorur gjatë këtij viti është 4,20 milionë Lekë ose në masën 96% të buxhetit të parashikuar.

c. Shpenzimet për karburant

Buxheti vjetor për këtë zë të shpenzimeve është 13 milionë Lekë, gjatë kësaj periudhe shuma e përdorur është 9.20 milionë Lekë ose rreth 71% kundrejt buxhetit të miratuar. Ulje e cila është impaktuar edhe nga efekti i pandemisë.

d. Shpenzimet për mirëmbajtje dhe siguracion të automjeteve

Këto shpenzime përfshijnë shërbimet periodike, shërbimet e veçanta, blerjen e pjesëve të këmbimit, gomave dhe siguracionin e mjeteve. Buxheti i parashikuar për këtë zë është rreth 11 milionë Lekë. Realizimi gjatë këtij viti është rreth 8.90 milionë Lekë ose në masën 81% kundrejt buxhetit vjetor të parashikuar.

e. Shpenzimet për dieta e shërbime

Shpenzimet për dieta dhe shërbime për vitin 2020 janë parashikuar në shumën 5.50 milionë Lekë. Ky zë shpenzimesh është realizuar në vlerën 2,1 milionë Lekë ose 37% kundrejt buxhetit të parashikuar dhe mbështet kryesisht aktivitetin e kryer për mbikëqyrjen e objekteve në terren nga ekipi i inxhinierëve si dhe ndjekjen e realizimit të objekteve të investimit të FSHZH-së në gjithë vendin. Gjatë vitit 2020 është vënë re një ulje e shpenzimeve të shërbimeve dhe dietave e ardhur kjo kryesisht nga efekti i pandemisë, ku shumë aktivitete janë realizuar online.

f. Shpenzimet e komunikimit

Në këtë zë përfshihen shpenzimet për telefoninë, komunikimin si dhe shpenzimet e shërbimit postar. Ky zë është parashikuar 3,3 milionë Lekë dhe është realizuar në vlerën 2,7 milionë Lekë ose 80% kundrejt buxhetit vjetor të parashikuar.

g. Shpenzime të tjera (Internet, energji elektrike, qera, sigurim)

Në zërat e shpenzimeve utilitare (7-11 në tabelë) përfshihen shërbimet utilitare të nevojshme për funksionimin e aktivitetit si interneti, facilitete dhe qera rajonale të FSHZH-së, energji elektrike, ujë, ruajtje e godinës, mirëmbajtje e sistemeve të zyrave qendrore, siguracione, blerje të vogla, etj. Për këtë zë në

buxhetin 2020 janë parashikuar rreth 44.52 milionë Lekë. Ky zë është realizuar në vlerën 22.70 milionë Lekë ose 51% kundrejt buxhetit të parashikuar.

Gjatë periudhës në vijim në kuadër të situatës së krijuar nga pandemia në këtë zë parashikohen shpenzime emergjente për masa anti COVID-19 për marrjen e masave përkatëse në zbatim të vendimeve të MSH, që lidhen me dezinfektimin e ambjentëve të zyrave, blerjen e maskave të përshtatshme për stafin, dezinfektuesve të duarve, alkool, sinjalistikë.

h. Publikime & Promovime

Në këtë zë përfshihen shpenzimet për analizat periodike të stafit, dizajne, printime, publikime, përgatitje video, dokumentarë dhe njoftime të ndryshme në shtyp (njoftime për tendera, punësime, etj). Në buxhetin e vitit 2020 për këtë zë janë parashikuar rreth 6 milionë Lekë. Gjatë këtij viti janë realizuar shpenzime në masën 3.30 milionë Lekë ose rreth 55% kundrejt buxhetit të parashikuar. Niveli i ulët i këtyre shpenzimeve ka ardhur si rezultat i efekteve gjyqësore të planifikuara dhe ende të papërfunduara gjatë vitit kalendarik 2020, që shtyhen si parashikim për vitin në vijim.

i. Kontrata shërbimi dhe shpenzime gjyqësore, përkthime, noterizime

Në këtë zë përfshihen shpenzime gjyqësore dhe asistencë juridike, përkthime të dokumentave si dhe pagesa për kontrata shërbimi. Për këtë zë në buxhetin 2020 janë parashikuar rreth 11 milionë Lekë. Gjatë këtij viti shpenzimet për këtë zë janë në vlerën 2.30 milionë Lekë ose 21% kundrejt buxhetit të parashikuar.

j. Servis kompjuter dhe fotokopje

Në buxhetin e vitit 2020 për këtë zë janë parashikuar rreth 1.35 milion lekë për mirëmbajtjen e pajisjeve kompjuterike dhe fotokopjeve. Shpenzimet për këtë zë janë realizuar në vlerën 1.2 milionë lekë ose rreth 90% kundrejt buxhetit të parashikuar.

4. LIGJSHMËRIA DHE MARRËDHËNIET

4.1. MARRËVESHJET E REJA ME DONATORË DHE QËNDRORE

Fondi Shqiptar i Zhvillimit në funksion të veprimtarisë dhe misionit të tij gjatë vitit 2020 është angazhuar në zbatimin e marrëveshjeve të miratuara me akte ligjore dhe nën ligjore gjatë vitit 2020, si më poshtë:

- Ndryshimi me shkëmbim letrash i Marrëveshjes kuadër të Financimit, ndërmjet RSH dhe Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës, për Punët e Komunitetit IV, të Fondit Shqiptar të Zhvillimit, projekti “Zhvillimi i alpeve dhe i zonave bregdetare” (ratifikuar me ligjin nr. 69/2015) - miratuar me VKM nr. 55, datë 29.01.2020.
- Marrëveshja e Huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin e konektivitetit të rrugëve rajonale dhe lokale në Shqipëri – ratifikuar me Ligj nr. 44/2020 datë 23.4.2020.
- Marrëveshja për një Hua Shtesë ndërmjet RSH dhe Fondit të Kuvajtit për Zhvillimin Ekonomik Arab për financimin e projektit të rehabilitimit të rrugës së Lumit të Vlorës - ratifikuar me Ligjin nr.47/2020 datë 23.4.2020.
- Marrëveshja e Huasë ndërmjet RSH dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për Programin për Zhvillimin e Turizmit dhe Infrastruktura në Shqipëri" - ratifikuar me Ligjin nr.143/2020.
- Marrëveshja e Grantit ndërmjet RSH, FSHZH dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për Programin e Mundësisit të Turizmit dhe Infrastruktura - miratuar me VKM nr. 883, dt.12.11.2020.
- Marrëveshja e Grantit ndërmjet RSH, FSHZH dhe KfW- FRANKFURT AM MAIN, për Projektin e Furnizimit me Ujë të Zonave Rurale IV- Granti 2 WBIF – miratuar me VKM nr.1024, dt.16.12.2020.
- Marrëveshja dypalëshe ndërmjet Këshillit të Ministrave të RSH-së dhe Konfederatës Zvicerane për Programin e Zhvillimit Rajonal në Shqipëri (Faza 4, 2019-2023) – ratifikuar me ligjin 99/2020.
- Marrëveshja e Grantit dhe Projektit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe KfW Frankfurt Am Main (KfW), për Programin për Rindërtim dhe Zhvillim në Zonat e Prekura nga Tërmeti të

Ndërtesave Publike (Faza I) -miratuar me Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.1150, datë 24.12.2020.

- Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të RSH dhe Fondacionit “Firdeus” në fushën e Ndërtimit të Banesave pas Fatkeqësisë ku FSHZH është caktuar agjenci zbatuese për mbikqyrje kolaudim - miratuar me VKM 629, dt 29.7.2020.

Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të RSH dhe Fondacionit “Behgjet Pacolli” , ku FSHZH është caktuar agjenci zbatuese për mbikqyrje kolaudim - miratuar me VKM 825, dt 23.10.2020.

4.2. PARTENERITETE ME BASHKITË

Në kuadër të programit “Infrastruktura Vendore Rajonale”, financuar nga buxheti i shtetit, në përputhje me parashikimet e ligjit 88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, Aneksi 3, nga FSHZH, bazuar edhe në kërkesën e përcjellë nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, bazuar në Vendimin e Këshillit Drejtues të FSHZH që ka miratuar listën e ndërhyrjeve që financohen nga ky program, janë miratuar projektet e mëposhtme:

- Ndërtimi e Godinës së parkimit dhe hapësirave mbështetëse në sheshin Cerciz Topulli”, në qytetin e Gjirokastrës.
- Ndërtimi i parkimit nëntokësor me 2 kate në sheshin “Teodor Muzaka”, në qytetin e Beratit.
- Ndërtimi i “Kompleksit Agroturistik, Bashkia Belsh”.

Nisur nga fakti se prej 2 vitesh FSHZH është duke menaxhuar me sukses shërbime publike dhe aktivitete ekonomike në fushën e turizmit që zbatohet nga Agjencia Ekonomike Mbështetëse (AEM) si përfaqësuese e Fondit Shqiptar të Zhvillimit, konkretisht, FSHZH, është duke administruar në marrëveshje me QSUT parkimin e spitalit, si dhe në marrëveshje me Bashkitë Tropojë dhe Malësi e Madhe, dy Qëndrat e Zhvillimit të Turizmit në Valbonë dhe Vermosh, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për menaxhimin e godinës dhe administrimin e aktivitetit ekonomik që do të zhvillohet në godinën e parkimit në Qytetin e Beratit, godinën e parkimit në qytetin e Gjirokastrës dhe Kompleksin Agroturistik në qytetin e Belshit.

Nisur nga lloji i partneritetit publik/publik dhe objektivat e veprimtarisë së aktorëve, marrëdhënia e vendosur midis palëve nuk ka terma përfitimi financiar, por karakter zhvillimor në përputhje edhe me vetë filozofinë e FSHZH-së, duke pasur në fokus përfitimet që vijnë si rrjedhojë e aplikimit të një skeme të tillë partneriteti si:

1. Përmirësim i një shërbimi publik të munguar;
2. Menaxhimi cilësor i investimeve që kryen nga FSHZH dhe kthimi i tyre në të vetë-qëndrueshme;
3. Rikthim i investimit, në një portofol të ri, të dedikuar për përdorim në infrastrukturën publike apo nevoja të tjera në shërbim të autoriteteve publike dhe në përfitim të publikut;
4. Krijimi i modeleve të suksesshme të menaxhimit që mund të replikohen nga sektori publik apo privat.

4.3. SHPRONËSIMET

Në kuadër të procesit të rindërtimit pas gjendjes së fatkeqësisë natyrore të tërmetit të dt. 26.11.2019, Fondi Shqiptar i Zhvillimit është caktuar njësi zbatuese për projektimin, (jo gjithmonë), ndërtimi, mbikqyrja, kolaudimi dhe dorëzimi i objekteve të përfunduara.

Në funksion të këtij procesi, Fondi Shqiptar i Zhvillimit është shpallur Njësi Zbatuese për zonat e reja për zhvillim si vijon:

Tabela 10. Informacion mbi zonat e reja për zhvillim

| Nr. | VKM | Zona e Re për Zhvillim |
|-----|--------------------------|--|
| 1 | Nr. 44, DT: 22.01.2020 | Njësia Administrative Thumana, Bashkia Krujë |
| 2 | Nr. 45, DT:22.01.2020 | Njësia Administrative Shijak |
| 3 | Nr. 61, DT: 29.01.2020 | Njësia Administrative Bubq, Bashkia Krujë |
| 4 | Nr. 62, DT: 29.01.2020" | Njësia Administrative Durrës, Zona 1 (shfuqizuar me VKM nr. 147, dt 10.3.2021) |
| 5 | Nr. 63, DT:29.01.2020" | Njësia Administrative Fushë Krujë |
| 6 | Nr. 64, DT: 29.01.2020" | Njësia Administrative Kavajë |
| 7 | Nr. 65, DT: 29.01.2020" | Njësia Administrative Lac 1,2 |
| 8 | Nr. 66, DT: 29.01.2020" | Njësia Administrative Vorë |
| 9 | Nr. 129, DT:13.02.2020" | Njësia Administrative Durrës, Zona 2 |
| 10 | Nr. 130, DT:13.02.2020" | Njësia Administrative Durrës, Zona 3 |
| 11 | Nr. 131, DT:13.02.2020" | Njësia Administrative Golem, Bashkia Kavajë |
| 12 | Nr. 132, DT:13.02.2020" | Njësia Administrative Krujë |
| 13 | Nr. 133, DT:13.02.2020" | Njësia Administrative Lezhë 1 |
| 14 | Nr. 134, DT:13.02.2020" | Njësia Administrative Lezhë 2 |
| 15 | Nr. 135, DT:13.02.2020" | Njësia Administrative Marikaj, Bashkia Vorë |
| 16 | Nr. 164, DT:19.02.2020" | Njësia Administrative Durrës, Zona 4 (Spitalë) |
| 17 | Nr. 442, DT: 03.06.2020" | Njësia Administrative Durrës Zona 5 |
| 18 | Nr. 468, DT: 10.06.2020" | Njësia Administrative Kamëz (Fshati Valias) |
| 19 | Nr. 469, DT: 10.06.2020 | Njësia Administrative Rrëshen |
| 20 | Nr. 730, DT: 16.09.2020 | Njësia Administrative Manzë, Durrës |

FSHZH, inicioi procesin e shpronësimeve duke i kërkuar informacion ASHK-ve, NJVV-ve, si dhe institucioneve të tjera për pasuritë që gjenden brenda koordinatave të zonave të reja për zhvillim.

Gjatë vitit 2020 është procesuar informacioni për 15 zonat të reja për zhvillim. Nga këto pas mbledhjes së dokumentacionit ligjor nga ASHK, NJVV etj, FSHZH ka përgatitur dhe ka depozituar kërkesat për shpronësim pranë autoritetit përgjegjës (Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë). Gjatë vitit 2020 kanë përfunduar pesë procedura shpronësimi: Thumana 1.1, Thumana 1.2, Bubqi, Fushë Kruja, dhe Kavaja. Për dy zona Thumana dhe Bubq, kanë dalë vendimet e Këshillit të Ministrave për shpronësimin, konkretisht:

- **VKM nr.528 datë 24.06.2020** “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, në funksion të procesit të rindërtimit në zonën 1/1 të re për zhvillim, në njësinë administrative Thumanë, bashkia Krujë”;
- **VKM nr.666 datë 27.08.2020** “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, në funksion të procesit të rindërtimit në zonën 1/2 të re për zhvillim, në njësinë administrative Thumanë, bashkia Krujë”;
- **VKM nr.790 date 07.10.2020** “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, dhe shkëmbimin e pronës në funksion të procesit të rindërtimit, për shpalljen e zones së re për zhvillim, në njësinë administrative Bubë, bashkia Krujë”.

Për dy zonat e tjera, Fushë Krujë dhe Kavajë, nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ASHK Krujë dhe ASHK Kavajë, ka rezultuar se pronat që ndodheshin brenda koordinatave të zonës së re për zhvillim, ishin në pronësi të shtetit.

Procedurat e shpronësimit janë bazuar në parashikimet ligjore të:

- Aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin 97/2019.
- VKM nr.7/2020, datë 06.01.2020 “Për kushtet dhe procedurën për shpronësimet dhe/ose shkëmbimin e pronës, për interes publik, në funksion të procesit të rindërtimit”.
- VKM nr.8/2020 “Për përcaktimin e kushteve dhe të kriterëve të përfitimit të sipërfaqeve ndërtimore në objektet e reja për banim nga subjektet që posedojnë ndërtime të klasifikuara si ndërtime pa leje”
- VKM-së nr. 89, datë 3.2.2016 për “ Miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”,

- VKM-së nr. 138, datë 23.3.2000 për “Kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”.
- Akte të tjera ligjore e nënligjore në kuadër të Programit për Rindërtim dhe Zhvillim në Zonat e Prekura nga Tërmeti.


Problematikat që kanë rezultuar gjatë procesit të shpronësimit kanë konsistuar në:

- Mungëse e HTR digjitale te zonave te reja per zhvillim;
- Vënie në dispozicion të HTR-ve të papërditësuara (vështirësi në evidentimin e qartë të pasurive të zonës; mospërputhje të sipërfaqeve të pronave midis gjëndjes fizike dhe sipërfaqeve të pasqyruara në dokumentacionin ligjor, prona që nuk ekzistojnë në terren, pasuri me status juridik të ndryshuar, etj)
- Pasaktësi dhe mungesë të dhënash në materialet e dërguara nga ASHK (KKP pa datë, firmë, vulë, adresa të gabuara, etj);
- Vështirësi në përcaktimin e sipërfaqeve për shpronësim të pasurive kufitare;
- Mungesa e një metodologjie të miratuar në lidhje me procedurën e vlerësimit të objekteve ndërtimore, objekte banimi dhe njësi tregëtimi. (vlerësimi me mesataren e shitblerjeve përcaktuar nga ASHK gjatv tre mujorit paraardhës, apo vlerësim me koston e ndërtimit duke përdorur si baze cmimet e Entit Kombëtar të Banesave).
- Procese gjyqësore ku dhe FSHZH është në cilësinë e palës së paditur dhe të cilat kanë pretendime për vlera të konsiderueshme monetare.

Aktualisht vazhdon procesi i mbledhjes, përpunimit dhe trajtimit të informacionit për zonat e tjera, i cili pritet të përfundojë brenda 6 mujorit të parë të vitit 2021.


4.4. GJYQET

Numri i proceseve gjyqësore të ndjekura gjatë vitit 2020 në total është 44 çështje, nga të cilat çështjet ku FSHZH është “*I Paditur*” rezulton të jenë 25 çështje, çështje ku FSHZH është “*Padites*” janë 4 çështje dhe çështje ku FSHZH është person i tretë rezulton të jenë 15 çështje.



Grafiku 2. Informacion mbi proceset gjyqësore sipas objektit

Vlerat e pretenduara në proceset gjyqësore:



Grafiku 3. Informacion mbi vlerat e pretenduara në proceset gjyqësore

Problematikat e proceseve gjyqësore

Kryesisht problematikat e procesve gjyqësore konsistojnë në:

- Qëndrimet e njëanshme dhe arbitrare të Gjykatave.
- Mos marrjen në konsideratë të prapësimeve dhe provave të depozituara nga FSHZH.
- Mungesa e përfaqësimit nga institucionet e tjera në proces.
- Cilësia e FSHZH si i paditur në proceset e shpronësimit dhe “keq interpretimi” i rolit dhe përgjegjësive të FSHZH në procesin e shpronësimit.

Masat e marra për ndjekjen e procesve gjyqësore të humbura në shkallë të ndryshme të gjykimit:

- Ankimi në të gjitha shkallët e tjera të gjyqësorit;
- Vlerësimi i vendimeve dhe qëndrimeve të njëanëshme të gjykatave duke kërkuar kryerjen e verifikimeve nga institucionet e drejtësisë si Inspektoriati i Lartë i Drejtësisë për vlerësimin e shkeljeve të pretenduara nga ana jonë;
- Negocimi dhe marrëveshje jashtë procesit gjyqësor me palët ndërgjyqëse për rishikimin e proceseve të inicjuara, duke vlerësuar heqjen dorë nga padia dhe pushimin e procesit gjyqësor.

5. PROKURIMI DHE KONTRAKTIMI I SHËRBIMEVE

5.1. PROGRAMET/PROJEKTET NË ZBATIM

Gjatë vitit 2020, FSHZH ka vijuar me ndjekjen e procedurave të prokurimit dhe nënshkrimit të kontratave në kuadër të programeve/projekteve në zbatim.

Procedurat e zhvilluara, pjesë e parashikimeve si për objektet e financuara nga qeveria shqiptare dhe ato me financim të huaj, kanë përfshirë programet si më poshtë:

- Programin për Rindërtim dhe Zhvillim në Zonat e Prekura nga Tërmeti;
- Programin e Investimeve të Qeverisë Shqiptare në të cilin përfshihen:
- Programin: “Infrastruktura Vendore dhe Rajonale 2019-2021”;
- Projekti i Investimeve Prioritare me impakt të lartë në zhvillimin ekonomik dhe promovimin e turizmit 2018 – 2020;
- Programin Punët në Komunitet IV “Zhvillimi i Alpeve Shqiptare dhe Zonës Bregdetare të vendit” (CEB);
- Projektin e Rrugëve Lidhëse Rajonale (Banka Botërore);
- Projektin e Rrugëve Lidhëse Rajonale (BERZH);
- Projektin për Zhvillimin e Integruar dhe Turizmin (Banka Botërore);
- Projektin e Lumit të Vlores (Fondi Kuvajtjan);
- Programet e financuara nga IPA, BASHKIMI EVROPIAN;
- Prejektin “Immediate post-earthquake reconstruction programme activities in Albania” (CEB);
- Projektin “Para për punë në bashkitë Shkodër, Fier dhe Dimal” (GIZ).

5.2. BAZA LIGJORE DHE RREGULLORET E NDJEKURA

Nisur nga fakti që programet të cilat janë aktualisht në zbatim, kanë burime të ndryshme financimi, FSHZH bie në detyrimin për të zbatuar gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit rregullore të ndryshme prokurimi, kjo sipas detyrimit ligjor që përcaktohet dhe diktohet në marrëveshjet e financimit respektive. Kështu,

- Procedurat e prokurimit për Programin e Rindërtimit janë kryer në përputhje të Aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” miratuar me ligjin 97/2019 si dhe në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.199, datë 04.03.2020 “Për miratimin e dokumenteve standarde të procedurës së prokurimit, të kritereve të vlerësimit të ofertës fituese, kushteve të marrëveshjes kuadër dhe të kontratës për procesin e rindërtimit”.
- Procedurat e prokurimit për financimet nga Qeveria Shqiptare janë kryer në përputhje me Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin

Publik”, i ndryshuar, dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, dhe akteve ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtaritë përkatëse.

- Procedurat e prokurimit për financimet e huaja janë kryer në mbështetje të rregulloreve respektive që ka përcaktuar cdo marrëveshje financiare Huaje apo Granti, sikurse janë:
 - . Procurement Policy in Investment Project Financing (IPF) and Other Operational Procurement Matters, July 2016 (Për projektet e financuara nga Banka Botërore)
 - . Guidelines on the internal procurement of services, supplies and works by the CEB, January 2014 (Për projektet e financuara nga Banka për Zhvillim e Këshillit të Europës - CEB)
 - . Procurement Policies and Rules (November 2017) (Për projektet e financuara nga Banka Europiane për Zhvillim dhe Rindërtim -BERZH)
 - . Practical Guide to contract procedures for European Union external actions - PRAG Rules (Per projektet e financuara nga BE)
 - . Guidelines for the Procurement of Consulting Services, Works, Plant, Goods and Non-Consulting Services in Financial Cooperation with Partner Countries (Document version January 2019, update as of January 2021) (Për projektet e financuara nga Banka për Zhvillim Gjermane - KfW Development Bank)

5.3. PROCEDURAT E PROKURIMIT TË ZHVILLUARA SIPAS KATEGORIVE TË CAKTUARA

Përtej situatës kritike dhe vështirësive që u krijuan gjatë vitit të shkuar për shkak të pandemisë së Covid-19, puna dhe aktiviteti i prokurimit në FSHZH ka vijuar me intensitet të lartë.

Gjatë vitit 2020 janë ndjekur dhe zhvilluar gjithsej 362 procedura prokurimi. Nga këto peshën kryesore e zënë procedurat për Punë me 113 procedura dhe Shërbim/Shërbim konsulence, me 233 procedura të zhvilluara dhe finalizuara me nënshkrimin e kontratave.


Fokusi dhe vëmendja kryesore e punës gjatë kësaj periudhe ka qenë e lidhur më Investimet e financuara nga Qeveria Shqiptare, kryesisht me Programin për Rindërtim dhe Zhvillim në Zonat e Prekura nga Tërmeti, për të cilin FSHZH është ngarkuar si një nga autoritetet përgjegjëse për zbatim për zonat respektive të prekura nga tërmeti i muajit Nëntor 2019. Gjithsej, 14 procedura Marrëveshje Kuadër të cilat kanë qenë të orientuara në 4 drejtime kryesore: Rindërtimin e banesave individuale dhe infrastruktures lehtësuese për to; Rindërtimin e objekteve arsimore; Ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturave publike;

Rindërtimin e banesave kolektive (njësi banimi pallate), si dhe 147 procedura minikonkursi në zbatim të këtyre marrëveshjeve, zënë një peshë prej 48% krahasuar me numrin total të procedurave të prokurimit të zhvilluara nga FSHZH gjatë vitit 2020.

Po kështu, Programi i Investimeve të Qeverisë Shqiptare ka zënë një volum të konsiderueshëm në procedurat e zhvilluara, në zbatim të programit Infrastruktura Vendore Rajonale 2019-2021 si dhe Investimeve Prioritare me impakt të lartë në zhvillimin ekonomik dhe promovimin e turizmit 2018 – 2020. Numri i procedurave të zhvilluara dhe kontratave të nënshkruara në kuadër të investimeve të këtij programi, përbëjnë rreth 32% të numrit total të procedurave të prokurimit të zhvilluara gjatë vitit 2020.

Pjesa e mbetur prej rreth 20% të numrit total të procedurave të zhvilluara, janë pjesë e programeve/projekteve me financim të huaj, sipas marrëveshjeve respektive të huave apo granteve të akorduara për zbatim. Në Aneksin 2 gjendet informacioni mbi numrin e kontratave të nënshkruara sipas kategorive dhe programeve të zhvillimit.

[Aneks 2: Informacion mbi numrin e kontratave të nënshkruara sipas kategorive dhe programeve](#)




Grafiku 4. Numri i Marrëveshjeve/Kontratave të nënshkruara

Sa i përket vlerës për kontratat e nënshkruara gjatë vitit 2020, rezulton se në total janë rreth **36.57 mld lekë me tvsh** të përfshira në këto kontrata. Nga këto, **55%** të vlerës totale të kontratave e zënë kontratat e nënshkruara në zbatim të Programit për Rindërtim dhe Zhvillim në Zonat e Prekura nga Tërmeti; rreth **35%** të vlerës, kontratat e nënshkruara në zbatim të programit të investimeve të QSH dhe **10%** kontratat e nënshkruara në zbatim të programeve të financimit të huaj.

Në Aneksin 3 gjendet informacioni mbi vlerën e kontratave të nënshkruara sipas kategorive dhe programeve.

[Aneks 3: Informacion mbi vlerën e kontratave të nënshkruara sipas kategorive dhe programeve](#)



Grafiku 5. Numri i Marrëveshjeve/Kontratave të nënshkruara

5.4. PJESËMARRJA E ARRITUR NË PROCEDURAT E PROKURIMIT

Interesi i operatorëve ekonomikë për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit të zhvilluara gjatë vitit 2020 ka qenë i lartë. Kështu rezulton se në total kanë aplikuar/shprehur interes dhe janë kualifikuar rreth **300 kompani/individë**. Nga këto:

- 130 kompani ndërtimi për procedurat e Punëve civile
- 100 kompani për procedurat e Projektimeve apo Shërbime te ndryshme konsulence
- 42 kompani për procedurat e shërbimit të mbikqyrjes dhe kolaudit
- 30 kompani për procedurat e mallrave apo shërbimeve për nevoja të brendshme të institucionit

Ndërkohë, numri mesatar i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit dhe ai i operatorëve ekonomikë të kualifikuar paraqitet si më poshtë:

- Për Programet e Investimeve të Qeverisë Shqiptare: Pjesëmarrja rezulton te jetë mesatarisht 16 operatorë për procedurë, nga të cilët numri mesatar i operatorëve ekonomikë të kualifikuar është 11, shifër që përbën rreth 70% të pjesëmarrësve.
- Për Programin për Rindërtim dhe Zhvillim në Zonat e Prekura nga Tërmeti: Pjesëmarrja rezulton te jetë mesatarisht 15 operatorë për procedurë, nga të cilët numri mesatar i operatorëve të kualifikuar është 13, shifër që përbën rreth 90% të pjesëmarrësve.

Për Programet/Projektet me financim të huaj: Pjesëmarrja rezulton të jetë mesatarisht 11 operatorë nga të cilët numri mesatar i operatorëve të kualifikuar është 6, shifër që përbën 55% të pjesëmarrësve.

5.5. PËRDORIMI I FONDEVE - ULJET MESATARE DHE KURSIMET

Referuar procedurave të prokurimit të cilat kanë konkluduar me kontrata të nënshkruara rezulton se nga Fondi Limit prej rreth 60 mld Leke me tvsh janë kursyer rreth 23.5 mld lekë, të cilat përbëjnë rreth 40% të fondit total të shpallur për tenderim.

5.6. PROCESI I ANKIMIMIT NË PROCEDURAT E PROKURIMIT

Sa i përket procesit të ankimimit, duke marrë në konsideratë dhe numrin e konsiderueshëm të procedurave të zhvilluara, janë paraqitur ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar të cilat lidhen me kriteret e përcaktuara në dokumentin e tenderit, dhe po ashtu edhe me vendimin e Autoriteti Kontraktor pas vlerësimit të aplikimeve respektive të paraqitura.

Kryesisht ankesat kanë qenë të përqëndruara tek procedurat e zhvilluara në zbatim të programeve të financuara nga buxheti i shtetit. Konkretisht nga 123 procedura të zhvilluara, rezultojnë të jenë paraqitur në total 42 raste ankesash, pranë Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

Nga këto, në vijim të shqyrtimit të tyre, vetëm në 7 raste operatorët ekonomikë nuk kanë qenë dakord me përgjigjen e dhënë nga Autoriteti Kontraktor dhe kanë drejtuar ankesën e tyre pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

Si rezultat i shqyrtimit të tyre, rezulton se vetëm për 1 (një) rast, vendimi i marrë nga FSHZH, nuk është pranuar dhe është rrëzuar në shkallën e dytë të ankimimit (KPP).

Ndërkohë sa i përket Programit për Rindërtim dhe Zhvillim në Zonat e Prekura nga Tërmeti, parashikimi ligjor në Aktin Normativ nr.9, datë 16.12.2019, përcakton të drejtën dhe detyrimin e çdo operatori të depozitojë ankesën direkt në Komisionin e Prokurimit Publik dhe jo tek Autoriteti Përgjegjës. Pavarësisht kësaj, gjatë procesit të prokurimit, kanë rezultuar vetëm 2 raste ankimimi në procedurat e zhvilluara, për të cilat është adresuar përgjigjia nga ana e FSHZH sipas përcaktimit ligjor.

Për procedurat e zhvilluara në zbatim të programeve/projekteve me financim të huaj nuk ka pasur asnjë ankesë të depozituar pranë FSHZH, të lidhur me procesin e prokurimit.

6. MENAXHIMI I PROGRAMEVE

Gjatë vitit 2020 FSHZH ka menaxhuar dhe vazhdon të menaxhojë nëpërmjet njësive të saj 15 programe të financuara nga burime të ndryshme, si Qeveria Shqiptare dhe nga Donatorët. Njëri prej programeve, ai i Punëve në Komunitet IV financuar nga CEB është finalizuar me sukses në fund të vitit 2020. Programet në zbatim përfshijnë një fushë të gjërë ndërhyrjesh të të gjitha tipologjive, si: infrastruktura rrugore, rikualifikime urbane, ujësjellës-kanalizime, mbrojtje mjedisore, rikonstruksione dhe ndërtim godinash, ndërtime dhe rehabilitime shëtitore, etj. Programet, përveç punimeve fizike, shoqërohen edhe me komponentë soft, siç janë projektimi, mbikëqyrja, kolaudimi, ngritja e kapaciteteve menaxheriale për bashkitë, konsulenca mbi elementët e turizmit, krijimi dhe organizimi i eventeve, etj.

Portofoli i programeve në zbatim arrin një shumë rreth 600 mln \$ e shpërndarë sipas komponentëve të secilit program:

- Programi i Furnizimit me Ujë të Zonave Rurale III realizuar në masën 77%
- Programi i Furnizimit me Ujë të Zonave Rurale IV realizuar 5 %;
- Programi për Zhvillimin e Integruar Urban dhe Turizmin realizuar në masën 16% ;
- Programi për Zhvillimin e Integruar të Zonave me Potencial Turistik realizuar në masën 5%;
- Programi Konektiviteti i BB realizuar në masën 40% dhe ai i BERZH realizuar në masën 5%
- Rehabilitimi i Rrugës së Lumit të Vlorës realizuar në masën 60% ;
- Programi i Ndërhyrjeve të Financuara nga Buxheti i Shtetit: GoA01 realizuar në masë 41%;
- Programi i Ndërhyrjeve të Financuara nga Buxheti i Shtetit: IVR realizuar në masën 51%;
- Punët në Komunitet IV realizuar në masën 100%;
- Programi për Rindërtim dhe Zhvillim në Zonat e Prekura nga Tërmeti: Banesat Individuale, realizuar në masen 40%;
- Programi për Rindërtim dhe Zhvillim në Zonat e Prekura nga Tërmeti: Infrastruktura Publike, realizuar në masën 37%;
- Programi për Rindërtim dhe Zhvillim në Zonat e Prekura nga Tërmeti: Banesat Kolektive, realizuar në masën 10%;
- Programi për Rindërtim dhe Zhvillim në Zonat e Prekura nga Tërmeti: Objektet Arsimore, realizuar në masën 75%;
- Programi i Zhvillimit të Qëndrueshëm të Integruar në “100 Fshatrat”, ne planifikim;
- Programet IPA.

Janë menaxhuar dhe janë në ndjekje gjatë këtij viti mbi 180 kontrata zbatimi, të cilat përkthehen në volume të realizuara në mbi 2 milionë m³ germime, rreth 500,000 m² çakëll dhe stabilizant, si dhe mbi 1 milion m² shtresa asfaltike.

Tabela 11. Informacioni mbi sasinë e tipologji të ndërhyrjeve të menaxhuara gjatë vitit 2020

| Nr. | Tipologji ndërhyrje | Sasia |
|-----|------------------------|-----------|
| 1 | Infrastrukturë rrugore | 200,000 m |
| 2 | Rikualifikime urbane | 20 |
| 3 | Ujësjetës-kanalizime | 22 |
| 4 | Projekte mjedisore | 4 |
| 5 | Ndërtime godinash | 22,000 |

6.1. PROGRESI FIZIK I PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT

Progresi fizik i deritanishëm vazhdon në përputhje me grafikun e punimeve dhe me afatet e kontratës, ku kryeson, si më i avancuar, “Programi për Rindërtim dhe Zhvillim nga Pasojat e Tërmetit”.

Të gjitha njësitë e menaxhimit të projekteve në koordinim me njësinë e planifikim-kontrollit, kanë hartuar databazën e unifikuar të kontratave në zbatim dhe atyre të parashikuara. Në këtë mënyrë kryhet monitorim i ngushtë i realizimit të objekteve, disbursimit të tyre dhe planifikimit në raport me kohën. Më poshtë paraqitet specifikisht progresi i secilit prej programeve:

PROGRAMI I NDËRHJRJEVE TË FINANCUARA NGA BUXHETI I SHTETIT: GOA01

Si rezultat i ecurisë pozitive dhe performancës së lartë në menaxhimin me sukses të objekteve të financuara në vitin 2017, Fondi Shqiptar i Zhvillimit vazhdoi procesin e identifikimit dhe pëzgjedhjes së projekteve të tjera me impakt të lartë në zhvillimin dhe promovimin e turizmit. Për këtë projekt Qeveria Shqiptare ka akorduar në vijimësi fonde për financimin e projekteve që ndikojnë në zhvillimin dhe promovimin e turizmit.

Duke marrë në konsideratë fondet e nevojshme për të mbyllur objektet në vazhdim dhe parashikimet buxhetore në PBA 2020-2022, FSHZH filloi procesin e programimit të investimeve të reja në një vlerë rreth 6.5 mld Lekë.

Kështu, bazuar mbi nevojat për ndërhyrje në zonat e kthyer në destinacione të mirëfillta turistike, të dhënat ndër vite që FSHZH disponon, vlerësimet në terren nga vetë inxhinierët e FSHZH, kërkesat e shprehura në takime të ndryshme me përfaqësues të interesave në zona, etj., është hartuar lista e projekteve për financim nga Buxheti i Shtetit, Programe Zhvillimi, Kapitulli 01. Referuar Aktit Normativ nr. 28 datë 02.07.2020, këtij programi iu shtuan edhe 20 objekte me vlerë rreth 10 mld lekë.

Tabela 12. Informacion mbi realizimin GoA01

| Nr. | Qarku | Projekti | Vlera | Planifikim Punime | Realizim Fizik | Realizimi Financiar |
|---------------|----------------------|---|-----------------------|-------------------|----------------|---------------------|
| 1 | BERAT | Rikualifikimi i Parkut industrial, Kuçovë | 154,783,515 | 15.00% | 15.00% | 6.46% |
| 2 | BERAT | Rruga e vendit të shenjtë Mali i Tomorrit, Loti 2 | 365,058,827 | 5.00% | 20.00% | 16.46% |
| 3 | BERAT | Rikualifikimi Urban i Unazës së Re, Berat | 408,044,036 | 10.00% | 20.00% | 16.42% |
| 4 | DURRËS | Rikonstruksioni i Sheshit Taulantia | 345,285,933 | 100.00% | 100.00% | 98.20% |
| 5 | DURRËS | Ndërtimi i Urës mbi Lumin Zezë dhe mbrojtje nga përmytjet qyteti Fushë Krujë | 441,897,654 | 100.00% | 100.00% | 100.00% |
| 6 | DIBER | Rehabilitimi i sheshit Ahmet Zogu dhe parkut Geraldinë në Qytetin e Burrelit | 81,995,666 | 45.00% | 60.00% | 55.90% |
| 7 | DIBER | Sistemim i Përroit të Llixhave, Segmenti Ura e Pazarit-Llixha dhe Rikualifikim urban i zonës | 150,281,750 | 10.00% | 15.00% | 13.31% |
| 8 | ELBASAN | Ndërtimi i Pedonales dhe Korsisë së Biçikletave te Liqeni i Belshit, Faza III | 122,262,462 | 100.00% | 100.00% | 98.50% |
| 9 | ELBASAN | Asfaltim, Rruga Labinot-Fushë/Qafë Renas si dhe Rruga e re e varrezave Elbasan dhe ndërtimi i mbikalimit hekurudhor në | 319,821,085 | 15.00% | 15.00% | 10.51% |
| 10 | FIER | Rehabilitimi i Lumit Gjanica dhe rikonceptimi i qendrës së qytetit të Fierit | 821,380,216 | 85.00% | 90.00% | 91.62% |
| 11 | FIER | Projekti zhvillimor i Bllokut nr 2 Roskovec | 235,448,915 | 100.00% | 100.00% | 100.00% |
| 12 | FIER | Rikonstruksioni i Unazës Bujqësore të Myzeqesë: Segmentet Rrethrotullim Imësht- Ngurrëz, Fier i Ri - Kashtbardh, Oerret - Kadiaj - | 421,232,192 | 100.00% | 100.00% | 100.00% |
| 13 | FIER | Ndërtim i Depos dhe rrjetit Shpërndarës të ujësjellësit të Grabianit | 122,688,092 | 100.00% | 100.00% | 95.92% |
| 14 | FIER | Rivitalizimi i rrugës Andon Pofka dhe hapësirave përreth saj, Bashkia Fier | 85,856,858 | 100.00% | 100.00% | 95.93% |
| 15 | FIER | Riveshje Aksi Rrugor Çermë-Divjakë si dhe degëzimet për fshatrat: Grabian, Çermë, Shkumbin-Bishçukas, Dushkucan-Halvaxhias- | 222,642,836 | 5.00% | 15.00% | 6.70% |
| 16 | FIER | Rikualifikim urban i qendrës së qytetit dhe krijimi i hapësirës rekreative në zonën e liqenit artificial, Ballsh | 180,189,249 | 5.00% | 20.00% | 15.73% |
| 17 | FIER | Rikualifikimi dhe sistemimi i Lumit Gjanica, Loti II, Fier | 636,121,556 | 5.00% | 15.00% | 13.17% |
| 18 | GJIROKASTËR | Sistemim, asfaltim i rrugës Përmet-Çarshovë | 1,150,000,000 | 2.00% | 7.00% | 4.78% |
| 19 | GJIROKASTËR | Ndërtimi i by-pass të Gjirokastërës (Ura e Nanxës-Urat e Mëdha Dunavat) | 396,646,812 | 0.00% | 0.00% | 10.00% |
| 20 | GJIROKASTËR | Rehabilitimi i Rrugës Nivicë-Salari | 140,055,260 | 5.00% | 20.00% | 20.00% |
| 21 | KORÇË | Rehabilitimi i Rrugëve, Shesheve dhe fasadave, Blloku tek Lagjia Nr. 2, Pogradec | 148,904,159 | 1.50% | 5.00% | 0.71% |
| 22 | KORÇË | Rikonstruksion i Rrugës Miras-Arrëz | 266,724,830 | 5.00% | 10.00% | 9.86% |
| 23 | KORÇË | Rikonstruksioni i Rrugës nga kryqëzimi Dardhë-Arrëz deri në fshatin Nikolicë | 152,999,532 | 10.00% | 20.00% | 19.58% |
| 24 | KUKES | Rehabilitimi i Lagjeve 4, 5 dhe 6 të bashkisë Kukës | 278,966,318 | 5.00% | 20.00% | 18.69% |
| 25 | LEZHË | Rikonstruksioni i rrugës Balldre-Bende | 382,464,640 | 100.00% | 100.00% | 100.00% |
| 26 | LEZHË | Ndërtimi i rrugës Rrëshen-Sheshaj | 133,539,133 | 5.00% | 15.00% | 10.00% |
| 27 | LEZHË | Rikonstruksioni i Fasadave të objekteve përgjatë Lumit Drin në qytetin e Lezhës, Blloku Nr. 1 dhe Rruga Lalmiri, Naim Frashëri | 150,560,713 | 5.00% | 10.00% | 5.48% |
| 28 | SHKODËR | Rikonstruksioni i Sheshit të Shirokës | 313,470,916 | 100.00% | 100.00% | 99.97% |
| 29 | SHKODER | Ndërrhyrje e Integruar për përmirësimin e aksesit, shërbimeve dhe atraksionit turistik në zonën e Alpeve Shqiptare: | 274,327,692 | 0.00% | 0.00% | 10.00% |
| 30 | TIRANE | Rikualifikim urban i Bllokut në qendër të Kamzës | 259,973,370 | 60.00% | 50.00% | 31.54% |
| 31 | TIRANE | Ndërrhyrje e integruar për përmirësimin e konektivitetit dhe rikualifikim urban në Bashkinë e Kavajës: | 114,194,040 | 65.00% | 98.00% | 96.46% |
| 32 | TIRANE | Rikualifikim urban i zonës turistike, Golem | 66,732,374 | 0.00% | 0.00% | 10.00% |
| 33 | TIRANE | Rikonstruksioni i Rrugës Çamëria dhe i Unazës së qytetit, Kavajë | 218,237,250 | 10.00% | 20.00% | 15.88% |
| 34 | VLORË | Rikonstruksioni Bulevardi i Vlorës, Faza e Dytë | 1,214,624,182 | 100.00% | 100.00% | 100.00% |
| 35 | VLORË | Rikualifikim urban pranë Qendrës së qytetit Vlore Zona A drejtimi i kullës së Sahatit | 1,090,000,000 | 0.00% | 0.00% | 10.00% |
| 36 | VLORË | Ndërtimi i shëtitores së Vlorës, Segmenti Jugor Uji i Ftohtë-Tunel | 466,460,316 | 60.00% | 65.00% | 54.62% |
| 37 | VLORË | Rikualifikim Urban dhe ndërtimi i aginaturës për mbrojtjen nga Vjosa I Nj. A Novoselë | 855,314,095 | 0.00% | 0.00% | 10.00% |
| 38 | VLORË | Ndërtim, Asfaltim, Rrjeti inxhinierik, Rruga Nr. 1, Lëkurës, Lot 1+2 | 231,213,429 | 20.00% | 25.00% | 24.10% |
| 39 | ALL | Përmirësimi i shtresave asfaltike për rrugët në Rajonet 1,2 (Marrëveshje Kuadër) | 700,000,000 | 5.00% | 10.00% | 6.89% |
| 40 | ALL | Përmirësimi i shtresave asfaltike për rrugët në Rajonet 3, 4 (Marrëveshje Kuadër) | 700,000,000 | 5.00% | 20.00% | 16.12% |
| 41 | KORÇË SHKODËR, VLORË | Rikonstruksioni i godinave të konvikteve të studentëve në qytetet Shkodër (Godina nr. 2), Vlorë (Konvikti i vajzave), Korçë (Godina nr. 1)" | 207,889,470 | 100.00% | 100.00% | 100.00% |
| TOTALI | | | 15,028,289,374 | 37.01% | 41.36% | 41.08% |

PROGRAMI I NDËRHRYJEVE TË FINANCUARA NGA BUXHETI I SHTETIT: IVR

Programi “Infrastruktura Vendore dhe Rajonale 2019-2021” është bazuar në Programin Operacional për Zhvillimin Rajonal (POZHR) i cili u miratua nga Këshilli Drejtues i FSHZH në 2019 dhe shërbeu si dokument kuadër dhe udhërrefyes për vijimin e zbatimit gjatë 2020. Ai është ndërtuar duke u mbështetur në katër drejtimet kryesore të zhvillimit rajonal:

- Ndërhyrje urbane dhe mjedisore;
- Ndërhyrje në funksion të zhvillimit ekonomik;
- Investime në informacion dhe dije;
- Ndërhyrje në infrastrukturën e shërbimeve publike.

Nga Programi Infrastruktura Vendore dhe Rajonale 2019-2021, gjatë vitit 2019-2020 janë financuar 15 projekte zhvillimore në të gjithë territorin e Shqipërisë në vlerë totale 7,38 mld lekë.

Përveç punimeve civile, pjesë përbërëse e këtij programi janë dhe shërbimet mbështetëse si më poshtë të cilat janë zhvilluar paralelisht gjatë viteve 2019-2020, si shërbime projektimi dhe oponente; mbikëqyrje dhe kolaudimi; si dhe studime fizibiliteti, plane biznesi, zhvillimore, menaxhimi dhe veprimi etj.

Deri në fund të vitit 2020, kanë përfunduar punimet në 24 nënprojekte të projekteve zhvillimore, vijon zbatimi i punimeve civile në 18 nënprojekte, janë lidhur kontratat, janë marrë lejet e zhvillimit dhe janë gati për fillim punimesh 3 nënprojekte, janë lidhur kontratat dhe janë në proces të marrjes së lejes së zhvillimit 2 nënprojekte, si dhe 4 nënprojekte mbeten në programim.

Duke konsideruar vlerat e alokuara në këtë program, vlerat e pakësuara, si dhe fondet e alokuara në vitin 2022, program i Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale u rishikua.

Duke qenë se në Ligjin Nr. 88/ 2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, PBA 2020-2022, parashikohet se fondi në dispozicion për këtë program është 3 miliardë Lekë, atëherë me këtë projekt-vendim, me vendimin e Këshillit Drejtues nr. 194, datë 04.03.2020, ky fond është përfshirë në program duke akomoduar disa nga projektet e miratuara në vitin 2019, si dhe duke parashikuar projekte të reja prioritare të propozuara nga Bashkitë apo të evidentuara nga FSHZH.

Tabela 13. Informacion mbi realizimin IVR

| Nr. | Qarku | Projekti | Vlera | Planifikim Punime | Realizim Fizik | Realizimi Financiar |
|---------------|-------------------------------|--|----------------------|-------------------|----------------|---------------------|
| 1 | Tirane | Nderhyrje emergjente ne funksion te investimeve me rendesi kombetare | 226,533,199 | 100.00% | 100.00% | 87.78% |
| 2 | Shkoder, Kukes, Lezhe, Diber | Permiresimi i aksesit ne sitet turistike dhe lehtesimi i trafikut ne zonat urbane ne rajonet veriore | 409,906,170 | 100.00% | 95.00% | 82.37% |
| 3 | Tirane, Durres, Elbasan | Permiresimi i infrastrukures rrugore ne zonat turistike te rajonit qendror dhe lehtesimi i trafikut ne zonat urbane te tij | 437,134,831 | 70.00% | 75.00% | 65.09% |
| 4 | Fier, Berat | Rivitalizimi urban i zonave me potencial te larte turistike ne Rajonin 3 dhe 4 | 294,375,037 | 100.00% | 100.00% | 87.37% |
| 5 | Elbasan, Korce | Rivitalizimi urban dhe permiresimi aksesit ne zonat me aktivitetet bujqesor ne rajonin 3 | 285,840,373 | 100.00% | 100.00% | 89.94% |
| 6 | Gjirokaster, Vlore | Permiresimi i infrastrukures rrugore ne funksion te zhvillimit te turizmit dhe agroturizmit ne Rajonin 4 | 505,544,752 | 100.00% | 90.00% | 67.80% |
| 7 | Fier | Permiresimi i aksesit ne zonat me aktivitet te larte bujqesor te Myzeqese | 374,417,786 | 100.00% | 100.00% | 75.30% |
| 8 | Shkoder, Lezhe, Durres, Korce | Permiresimi i shtresave rrugore | 429,100,429 | 95.00% | 95.00% | 66.78% |
| 9 | Shkoder, Lezhe, Durres, Korce | Permiresimi i sigurise rrugore dhe ndricimit | 275,782,245 | 25.00% | 30.00% | 19.21% |
| 10 | Vlore | Rivitalizimi urban i zonave me potencial te larte turistike ne Rajonin 4 | 762,336,499 | 10.00% | 25.00% | 14.88% |
| 11 | Fier | Permiresimi i infrastrukures se sherbimeve sociale ne funksion te zhvillimit ekonomik raional | 166,331,745 | 10.00% | 15.00% | 3.43% |
| 12 | Shkoder | Permiresimi i infrastrukures turistike ne funksion te zhvillimit ekonomik raional | 69,817,510 | 0.00% | 0.00% | 0.00% |
| 13 | Elbasan, Berat | Zhvillimi i atrkasionit turistik mbeshetetur mbi potencialet lokale | 334,021,251 | 0.00% | 0.00% | 0.00% |
| 14 | Tirane, Korce | Ngritja e qendrave te ekسلences per zhvillimin raional dhe vendor | 393,004,180 | 0.00% | 0.00% | 0.00% |
| 15 | Elbasan | Rikualifikimi i Lulishtes ne Qender te qytetit te Elbasanit | 221,010,756 | 0.00% | 0.00% | 0.00% |
| 16 | Korce | Sistemimi i hyrje daljes dhe stabilizimi i rreshqitjes ne hyrje te qytetin e Pogradecit | 33,619,664 | 70.00% | 70.00% | 44.62% |
| 17 | Elbasan | Rikonstruksioni i rruges Polis dhe Babje ne Bashkine e Librazhdit | 203,090,995 | 70.00% | 70.00% | 35.54% |
| 18 | Vlore | Rivitalizim urban dhe rruga hyrese ne portin e Vlores | 156,000,000 | 30.00% | 30.00% | 24.36% |
| 19 | Vlore | Ndertimi i ITUN ne Divjake | 26,909,488 | 0.00% | 0.00% | 0.00% |
| 20 | Kukes | Ndertimi i ITUN, Rrjetit te kanalizimeve te ujërave të zeza dhe Ujësjellësit në Valbonë | 47,494,273 | 0.00% | 0.00% | 0.00% |
| 21 | Berat | Ndertimi i godines se parkimit dhe hapësirave mbeshetese ne Berat | 322,088,705 | 0.00% | 0.00% | 0.00% |
| 22 | Gjirokaster | Ndertimi i godines se parkimit dhe hapësirave mbeshetese ne Gjirokaster | 350,545,934 | 0.00% | 0.00% | 0.00% |
| 23 | Elbasan | Rikonstruksioni i rruges Iljaz Kosova, Elbasan | 83,427,843 | 0.00% | 0.00% | 0.00% |
| TOTALI | | | 6,408,333,665 | 49.69% | 51.06% | 35.66% |

PROGRAMI I ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM I INTEGRUAR NË “100 FSHATRAT”

Programi kombëtar “100+ Fshatrat” është programi i integruar i zhvillimit të 100+ fshatrave, duke i dhënë mundësi fshatit shqiptar të ketë një trend pozitiv zhvillimi ekonomik, të diversifikuar dhe të qëndrueshëm duke koordinuar ndërhyrjet zhvillimore në hapësirën rurale të 100+ fshatrave në Republikën e Shqipërisë. Ky program do të ndihmojë në ruajtjen dhe përmirësimin e strukturës shoqërore dhe ekonomike, në veçanti në zonat më të largëta rurale të cilat ballafaqohen me uljen e numrit të popullsisë. Nxitja e investimeve në një ekonomi më të gjerë rurale dhe në komunitetet rurale janë jetësore për të rritur cilësinë e jetës në zonat rurale nëpërmjet qasjes së përmirësuar në shërbimet dhe infrastrukturën bazë dhe në një mjedis më të mirë. Për shkak të tërmetit të 26 Nëntorit të vitit 2019, buxheti i planifikuar 2020 për këtë program u përdor për financimin e Programit për Rindërtim dhe Zhvillim në Zonat e Prekura nga Tërmeti.

PROGRAMI I FURNIZIMIT ME UJË TË ZONAVE RURALE III DHE IV

Rural 3

Me financim nga WBIF(Grant) në shumën 670,000 Euro gjatë periudhës nëntor 2015-maj 2016, u hartuan fizibilitetet teknike dhe sociale. Në fund të këtij procesi u administruan 252 aplikime nga 59 bashki. Përgatitja e fizibiliteteve teknike, sociale dhe mjedisore ka përfunduar për 30 skema, nga të cilat 19 prej tyre kanë rezultuar fizibël. KfW ka dhënë miratimin për 18 skemat e para dhe ndërkohë disa skema të tjera rezervë parashikohet të financohen nga ky projekt.

Rural 4

Në maj 2018 është nënshkruar Marrëveshja e financimit të grantit 750 mijë euro, i siguruar nga Qeveria Federale Gjermane nëpërmjet KfW. Financimi u përdor për përgatitjen e studimit të fizibilitetit për Himarën.

Puna për studimin e fizibilitetit të projektit nisi në shkurt 2018. Studimi është dorëzuar dhe miratuar nga KfW në nëntor 2018.

Gjatë kësaj periudhe u realizua dhe procedura e prokurimit për përzgjedhjen e konsulentit. Më datë 27.11.2019 është nënshkruar kontrata me konsulentin për shërbimet e projektimit dhe të supervizionit. Në datë 27 nëntor 2019 u nënshkrua kontrata për këto shërbime. Aktualisht, është në fazë projektimi.

Tabela 14. Informacion mbi realizimin e Furnizimit me Ujë të Zonave Rurale III dhe IV

| Nr. | Projekti | KfW Kredi | KfW Grant | IPA Grant | Financim GOA | Kontributi Lokal | Vlera | Planifikim Punime | Realizim Fizik | Realizimi Financiar |
|----------|--------------------------------|-------------------|------------------|-------------------|------------------|------------------|----------------------|-------------------|----------------|---------------------|
| A | RURAL III | | | | | | 4,834,382,442 | 81.94% | 83.03% | 80.32% |
| 1 | RWSP-WS-ICB_2018-1 | 6,008,561 | - | 1,749,063 | - | 844,259 | 1,058,031,610 | 85.00% | 90.00% | 85.90% |
| 2 | RWSP-WS-ICB_2018-2 | 5,828,932 | - | 1,873,776 | - | 838,282 | 1,050,541,738 | 95.00% | 95.00% | 94.70% |
| 3 | RWSP-WS-ICB_2018-3 | 3,972,803 | - | 1,620,892 | - | 192,288 | 711,675,886 | 60.00% | 60.00% | 57.13% |
| 4 | RWSP-WS-ICB_2018-4 | 5,550,970 | - | 1,571,829 | - | 775,171 | 971,450,226 | 85.00% | 85.00% | 82.19% |
| 5 | Projektim dhe mbikeqyrje | 1,988,736 | - | 2,988,362 | - | - | 612,182,981 | 90.00% | 90.00% | 85.93% |
| 6 | Masat shoqeruese | - | 1,500,000 | - | - | - | 184,500,000 | 50.00% | 50.00% | 43.46% |
| 7 | Kostot Administrative te FSHZH | 650,000 | - | - | 1,350,000 | - | 246,000,000 | 68.28% | 68.28% | 68.28% |
| B | RURAL IV | | | | | | 480,850,050 | 20.00% | 20.00% | 17.00% |
| 1 | Loti 1 | 9,200,000 | - | - | - | - | - | 0.00% | 0.00% | 0.00% |
| 2 | Loti 2 | 8,300,000 | - | - | - | - | - | 0.00% | 0.00% | 0.00% |
| 3 | Loti 3 | 10,500,000 | - | - | - | - | - | 0.00% | 0.00% | 0.00% |
| 4 | Loti 4 | 7,000,000 | - | - | - | - | - | 0.00% | 0.00% | 0.00% |
| 5 | Skema Opsionale | 1,150,000 | - | - | - | - | - | 0.00% | 0.00% | 0.00% |
| 6 | Projektim dhe mbikeqyrje | - | - | 1,800,000 | 2,220,000 | - | 480,850,050 | 20.00% | 20.00% | 17.00% |
| 7 | Fondi rezerve | 3,200,000 | - | - | - | - | - | 0.00% | 0.00% | 0.00% |
| 8 | Masat shoqeruese | - | 2,000,000 | - | - | - | - | 0.00% | 0.00% | 0.00% |
| 9 | Kostot Administrative te FSHZH | 650,000 | - | - | - | 1,350,000 | - | 0.00% | 0.00% | 0.00% |
| | TOTALI | 64,000,000 | 3,500,000 | 11,603,922 | 3,570,000 | 4,000,000 | 5,315,232,492 | 76.34% | 77.33% | 74.59% |

PROGRAMI REHABILITIMI I RRUGËS SË LUMIT TË VLORËS

Gjatë vitit 2016, u evidentuan të gjitha hapat e duhura për hartimin e grafikut të realizimit të projektit dhe përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm. Fillimisht u punua me përgatitjen e termave të referencës për Supervizionin e Punimeve.

Tabela 15. Informacion mbi realizimin e Rehabilitimit të Rrugës së Lumit të Vlorës

| Nr. | Qarku | Projekti | Vlera | Planifikim Punime | Realizim Fizik | Realizimi Financiar |
|---------------|-------|---|----------------------|-------------------|----------------|---------------------|
| 1 | Vlore | Rikonstruksion i rrugës ura e Gjormit, Brataj, ura e Laskos, rajoni i Selenicës, Lot 2 | 4,236,665,117 | 70.00% | 75.00% | 68.21% |
| 2 | Vlore | Rikonstruksion i rrugës ura e Laskos - Qeparo dhe lidhje e rrugës ura e Laskos - Kuç, rajoni i Himarës, Lot 3 | 3,540,036,148 | 35.00% | 40.00% | 36.19% |
| 3 | Vlore | Supervizioni i kontratave të ndërtimit | 329,762,016 | 80.00% | 80.00% | 79.39% |
| TOTALI | | | 8,106,463,281 | 55.12% | 59.92% | 54.68% |

Programi i Konektivitetit të Rrugëve Rajonale dhe Lokale

Ky Program synon të mbështesë zhvillimin e turizmit dhe bujqësisë dhe konektivitetin rajonal përmes përmirësimit të aksesit rrugor, si faktorët kryesorë të rritjes ekonomike dhe punësimit në Shqipëri. Gjithashtu Programi i Konektivitetit synon të zhvillojë një kornizë të përgjithshme investimesh në infrastrukturën e transportit me fokus në rrjetin rrugor rajonal në zonat me potencial bujqësor dhe turistik në të gjithë vendin.

Prioritetet e investimeve janë zhvilluar bazuar në një metodologji prioritizimi që përqendrohet në sektorët kryesorë prodhues dhe veçanërisht bujqësinë dhe turizmin. Fillimisht u hartua një listë e gjatë prej 1,400 km rrugësh kandidate bazuar në konsultimet midis FSHZH dhe 61 Njësi Vendore duke marrë parasysh rëndësinë e turizmit, potencialin bujqësor, popullsinë përfituese dhe treguesit e efikasitetit ekonomik. Në fazën e parë, u finalizua një listë financimi për vitin e parë të programit, për rreth 60 km rrugë që kanë një ndikim të rëndësishëm në turizëm, për të cilat, me dakordësinë e Bankës Botërore dhe fondet e buxhetit të shtetit, u krye procesi i prokurimit dhe kontraktimit të projektimit.

Deri më sot ky program po financohet nga Qeveria Shqiptare mes marrëveshjeve të huasë me Bankën Botërore dhe BERZH me vlerë financimi 100 milionë USD.

Pjesa tjetër e nevojave për financim, do të plotësohet me anë të marrëveshjeve të reja financimi në vazhdim, duke plotësuar kështu fazat e mëposhme të këtij programi.

Faza e parë – financimi nga Banka Botërore

Faza e I-rë e Programit të Konektivitetit financohet nga një hua e IBRD prej 50 milion USD dhe ka për synim realizimin e komponentëve si me poshtë:

- Komponenti 1: Përmirësimi i aksesit (Kostoja totale 46.88 milion dollarë; IBRD 46,88 milion dollarë amerikanë). Ky komponent do të financojë rehabilitimin e rrugëve rajonale dhe lokale; shërbime projektimi, mbikëqyrjen e punëve civile, auditimin e sigurisë rrugore; implementimin e masave për përmirësimin e sigurisë rrugore.
- Komponenti 2: Ngritja e kapaciteteve për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (Kostoja totale 1,0 milion dollarë amerikanë; IBRD: 1,0 milion dollarë amerikanë). Ky komponent do të sigurojë mbështetje për NjVV- të në dy fusha të përgjegjësive të tyre, që janë menaxhimi dhe mirëmbajtja e rrjeteve të tyre rrugore dhe mbështetja në zbatimin e programeve të zhvillimit rural që mund të financohen nga vete NjVV-të, nga Qeveria apo partnerë të tjerë të zhvillimit
- Komponenti 3: Mbështetja e Menaxhimit të Zbatimit (Kostoja totale 2.0 milion dollarë; IBRD: 2.0 milion dollarë). Ky komponent përfshin koston operacionale të FSHZH-së, zhvillimin dhe mirëmbajtjen e një sistemi informacioni gjeografik (GIS) dhe bazës së të dhënave për rrugët rajonale dhe lokale, vlerësimin afatmesëm dhe ngritjen e kapaciteteve për FSHZH-në.

Tabela 16. Informacion mbi realizimin e Programit të Konektivitetit të Rrugëve Rajonale dhe Lokale, BB

| Nr. | Qarku | Projekti | Vlera | Planifikim Punime | Realizim Fizik | Realizimi Financiar |
|---------------|-------------------|--|----------------------|-------------------|----------------|---------------------|
| 1 | Gjirokastr | Rikonstruksion i rrugës Lekdush-Bëncë-Tepelene, Loti 2 | 250,572,791 | 40.00% | 45.00% | 37.45% |
| 2 | Vlore, Gjirokastr | Rikonstruksion i rrugës Gusmar-Kuç" | 585,269,651 | 45.00% | 45.00% | 42.63% |
| 3 | Shkoder | Rikonstruksion i rrugës Qafe Thore -Theth", Shkodër" | 736,302,708 | 60.00% | 65.00% | 61.34% |
| 4 | Korce | Rikonstruksion i rrugës Pogradec-Tushemisht" | 377,388,382 | 80.00% | 85.00% | 82.12% |
| 5 | Berat, Fier | Rikonstruksion rruga Roskovec - Poshnje | 698,203,020 | 0.00% | 0.00% | 0.00% |
| 6 | Tirane | Rikonstruksion Zona Turistike Golem - Kavaje (rrugët paralele) | - | 0.00% | 0.00% | 0.00% |
| 7 | Korce | Rikonstruksion i rrugës Pogradec-Tushemisht" Loti2 | - | 0.00% | 0.00% | 0.00% |
| 8 | Vlore, Gjirokastr | Supervision Services for the roads reconstruction (approx. 45Km) | 82,622,430 | 25.00% | 25.00% | 22.83% |
| 9 | Shkoder | Supervision Services for the roads Qafe Thore -Theth Road, Bashkia Shkodër | 39,588,000 | 87.00% | 87.00% | 86.47% |
| TOTALI | | | 2,769,946,983 | 41.96% | 44.43% | 41.81% |

Faza e dytë – financimi nga BERZH

Në këtë fazë janë përfshirë ndërtimi dhe rehabilitimi i rrugëve Shëngjin Baks-Rrjoll, Ujë i Ftohtë-Orikum dhe ndërtimin e 2 bypass-eve, dhe segmenti rrugor Zgosht-Ura e Çerenecit. Me këtë hua do të mbulohet edhe financimi i mbikëqyrjes së punimeve për këto objekte. Gjatë 2020, FSHZH realizoi Studimin e Fizibilitetit për Rrugën Zgosht-Ura e Çerenecit, si dhe projektet teknike për akset rrugore të përfshira në këtë fazë.

Tabela 17. Informacion mbi realizimin e Programit të Konektivitetit të Rrugëve Rajonale dhe Lokale, BERZH

| Nr. | Qarku | Projekti | Vlera | Planifikim Punime | Realizim Fizik | Realizimi Financiar |
|---------------|----------------|---|----------------------|-------------------|----------------|---------------------|
| 1 | Elbasan, Diber | Sistemim Asfaltim i Rrugës Zgoshit - Çerenec | - | 0.00% | 0.00% | 0.00% |
| 2 | Vlore | Rehabilitation of Vlore - Orikum Road (10.6km) | 1,518,853,859 | 0.00% | 0.00% | 0.00% |
| 3 | Shkoder, Lezhe | Rehabilitation of Shëngjin – Baks-Rrjoll Road (13km) | 878,267,470 | 0.00% | 0.00% | 0.00% |
| 4 | | Supervision of rehabilitation of three national roads section: Vlore - Orikum Road (10.6km), Shëngjin – Baks-Rrjoll Road (15.1km) and Zgoshit-Ura e Çerenecit Road (47.1km) | 99,848,700 | 0.00% | 0.00% | 0.00% |
| TOTALI | | | 2,496,970,029 | 0.00% | 0.00% | 0.00% |

PROJEKTI PËR ZHVILLIMIN E INTEGRUAR URBAN DHE TURISTIK

Projekti për Zhvillimin e Integruar Urban dhe Turistik (PZHIUT), i financuar nga Banka Botërore po zbatohet nga Fondi Shqiptari Zhvillimit që prej muajit Prill 2017. Ky është një program i cili mbështet Qeverinë Shqiptare në financimin e projekteve të infrastrukturës në qendrat urbane të Sarandës, Gjirokastrës, Beratit dhe Përmetit. Programi i investimeve shtrihet edhe në zona të tjera plotësuese pranë këtyre qendrave që kanë interes kulturor dhe natyror. Objektivi i projektit është përmirësimi i infrastrukturës urbane, nxitja e turizmit dhe forcimi i kapaciteteve institucionale për të mbështetur turizmin dhe zhvillimin e ekonomisë lokale në zonat e përzgjedhura në jug të Shqipërisë Gjirokastrë, Berat, Përmet dhe Sarandë.

Puna për zbatimin e projektit është e organizuar sipas tre komponentëve kryesorë.

Gjatë kësaj periudhe, FSHZH ka punuar intensivisht me ekipin e Bankës Botërore, Njësitë e Qeverisjes Vendore dhe MZHU me qëllim realizimin e objektivave të zbatimit të projektit. Gjatë vitit 2020 është punuar për:

Komponenti 1: Projektimi urban dhe përmirësimi i infrastrukturës (44.3 milionë Euro) i cili financon hartimin e projekteve për zbatimin e projektimit urban dhe investime për përmirësime të infrastrukturës bashkiake në katër qendrat urbane: Saranda, Gjirokastra, Berati dhe Përmeti.

Përsa i përket komponentit të parë vlen të theksohet se kanë përfunduar punimet për:

- Ndriçimin e rrugës hyrëse në Përmet;
- Rehabilitimin e rrugës këmbësore për në Kalanë e Beratit dhe pikës panoramike jugore të Kalasë së Beratit "Tabja";
- Rehabilitimin e shkallareve në qendrën e qytetit të Sarandës;
- Rehabilitimin e infrastrukturës dhe restaurimin e kalldrëmeve në pazarin e Gjirokastrës.

Janë akoma ne proces zbatimi kontratat e mëposhtme:

- Për kontratën **“Rigjenerimi Urban i Shëtitores ekzistuese “Naim Frashëri”** në Sarandë” ka përfunduar procesi i vlerësimit të tenderit të punimeve civile dhe është nënshkruar kontrata me fituesin në datë 16.09.2019. Punimet për këtë objekt kanë filluar në datë 04.03.2020 dhe po vazhdojnë me ritme të mira. Aktualisht, realizimi i punimeve është rreth 75% e vlerës totale të punimeve, ndërkohë që vlera e paguar referuar Situacionit të punimeve është rreth 70% e vlerës totale të punimeve;
- **“Rikonstrukcioni i rrugës automobilistike “Muzak Topia” për në Kalanë e Beratit”**. Në datë 20.12.2019 ka dalë Leja e Infrastrukturës nga Bashkia Berat (me kufizime pronësie). Në datë 30.12.2019 është caktuar data e fillimit të punimeve, duke lejuar punimet të përqendrohen në 560 m e para të kontratës, në zonën ku nuk ka shpronësime. Punimet për këtë segment kanë përfunduar që në muajin gusht 2020. NjMS ka rishikuar RAP dhe ka marrë miratimin nga Banka Botërore. Në përputhje me politikën e BB, NjMS ka kryer inspektime dhe takime me personat e ndikuar nga projekti. Dosja e shpronësimit, e përgatitur sipas kërkesave dhe udhëzimeve të BB, ndodhet në MIE për miratim. Nga pikëpamja e realizimit të kontratës, punimet e likuajuara janë 26%. Me daljen e VKM-së për shpronësimet të cilat do të zbatohen sipas procedurës së Bankës Botërore, mund të fillojnë punimet edhe në segmentin e mbetur nga progresivi 0+560m deri tek km 1+820.

FSHZH po vijon punën për përgatitjen e projekteve teknike dhe dokumentacionit të tenderimit për projektet e mëposhtme:

- Identifikimi, projektimi i masave të prioritarizimit për të adresuar shqetësime urgjente për sigurinë dhe parandalojnë humbjen e strukturave të kalasë së Gjirokastrës;
- Përmirësimi i integruar urban i infrastrukturës në qytetin e Gjirokastrës;
- Përmirësimi i integruar urban i infrastrukturës për qytetin e Sarandës;
- Përmirësimi i integruar urban i infrastrukturës për qytetin e Beratit;
- Hartimi i projekteve të zbatimit dhe supervizioni i ndërtimit të infrastrukturës së pikave panoramike përgjatë korridorit turistik në jug të Shqipërisë për të cilin është ndërprerë kontrata fillestare. Është përfunduar rishikimi i Termave të Referencës me qëllim rihapjen e procedurës së prokurimit dhe aktualisht jemi në fazën e vlerësimit të ofertës;
- Konsulenca “Eksperti Internacional i specializuar në shërbime në trashëgiminë kulturore dhe inxhinieri strukturore në Gjirokastrë”.

Të gjitha objektet janë kontrolluar për komponentin e “safeguards” në mjedis dhe çështjet sociale në mënyrë që projektet të jenë në linjë me kërkesat dhe politikat e Bankës Botërore.

Komponenti 2: Përmirësimi i siteve turistike (8.4 milionë Euro) financon investime që kanë për qëllim përmirësimin e siteve turistike të përzgjedhura përgjatë korridorit turistik në Shqipërinë e Jugut.

Lidhur me komponentin e dytë, aktualisht janë përfunduar projektet e zbatimit për 2 site turistike, për të cilat është marë N.O. i tyre dhe ESMP (Environmental Social Management Plans), nga Banka Botërore dhe është bërë kërkesa të fillojë procedura e prokurimit për punimet civile:

- Nartë-Zvërnec;
- Ujërat Termale të Bënjës.

Është punuar gjithashtu dhe për identifikimin e siteve turistike shtesë të cilat mund të përfshihen nën këtë komponent, duke bërë një identifikim dhe listim të siteve turistike potenciale.

Ka një vendimmarrje të përbashkët ndërmjet NjKP (Njësisë së Koordinimit të Projektit), FSHZH (Fondi Shqiptar i Zhvillimit) si dhe BB (Bankës Botërore), për të përfshirë në listën e siteve turistike Kalanë e Gjirokastrës, siç dhe është propozuar tek Strategjia e Zhvillimit të Produktit për Jugun e Shqipërisë.

Gjithashtu, për t'u përfshirë në listën e siteve turistike ku do ndërhyhet për përmirësimin e tyre, po merren në konsideratë dhe tre site të reja, të cilat janë diskutuar gjatë misionit të muajit maj 2020 me Bankën Botërore:

- Kalaja e Kaninës;
- Kalaja e Borshit;
- Shpella e Ciklopit.

Aktualisht, është bërë “Safeguards Screening” nga FSHZH dhe i është përcjellë Bankës Botërore për aprovim. Paralelisht, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka dorëzuar dhe kërkesën zyrtare tek BB për përfshirjen e këtyre siteve turistike si pjesë e projektit PIUTD. Procesi për momentin është frenuar pasi Ministria e Kulturës ka kërkuar që ndërhyrja në Kalanë e Borshit të përfshijë dhe përforcime të shpateve, për të cilën Banka Botërore ka kërkuar paraprakisht që Ministria e Kulturës të dorëzojë Termat e Referencës, për të kuptuar dhe vlerësuar ndërhyrjen e parashikuar.

Komponenti 3: Gjatë 2020 është punuar për konsulentat e mëposhtme:

- Zhvillimi i tregut të turizmit për 4 bashkitë përfutuese dhe jugun e Shqipërisë. Janë hartuar termat e references, ka përfunduar procesi i prokurimit, si dhe ka filluar zbatimi i saj.
- Zhvillim produkti – paketa e parë, eventet. Janë hartuar termat e references, ka filluar procesi i prokurimit.
- Zhvillim produkti – paketa e dytë, outdoor dhe muze. Janë hartuar termat e references, ka filluar procesi i prokurimit.
- Statistikat në turizëm. Është punuar për hartimin e termave të referencës.
- Partneriteti për menaxhimin e destinacioneve si dhe përgjigjja ndaj COVID-19. Është punuar për hartimin e termave të referencës.

PIUTD+

Gjatë periudhës kohore të vitit 2020 janë përgatitur një set dokumentesh të nevojshme si: projekt propozim, rishikim i indikatorëve ekzistues të projektit dhe propozim për ndryshime, përditësim i manualit operacional të projektit, etj. në bashkëpunim të ngushtë dhe me ekipin e Bankës Botërore. Është dakordësuar midis FSHZH dhe BB për amendimin e Marrëveshjes së Huasë dhe të Projektit dhe hapi i radhës konsiston në ndjekjen e procedurave të brendshme ligjore cilat përfshijnë miratimin e saj në parim nga Qeveria Shqiptare dhe më pas ratifikimin e saj nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

Tabela 18. Informacion mbi realizimin e Projekti për Zhvillimin e Integruar Urban dhe Turistik

| Nr. | Qarku | Projekti | Vlera | Planifikim Punime | Realizim Fizik | Realizimi Financiar |
|---------------|-------------|---|----------------------|-------------------|----------------|---------------------|
| 1 | Vlore | Saranda Staircase Rehabilitation Project | 90,846,945 | 100.00% | 100.00% | 100.00% |
| 2 | Vlore | Urban Regeneration of the Existing Promenade "Naim Frasheri" in Saranda | 570,335,643 | 75.00% | 74.00% | 68.33% |
| 3 | Vlore | Saranda Tourism Gateway Integrated Urban Upgrading | 897,748,531 | 0.00% | 0.00% | 0.00% |
| 4 | Gjirokaster | Ali Pasha historic trail and slopes stabilization - Gjirokastra | 202,183,092 | 0.00% | 0.00% | 0.00% |
| 5 | Gjirokaster | Bazaar cobble stone roads rehabilitation | 137,774,433 | 100.00% | 100.00% | 95.00% |
| 6 | Gjirokaster | Gjirokastra Museum City Integrated Urban Upgrading | 806,716,816 | 0.00% | 0.00% | 0.00% |
| 7 | Gjirokaster | Upgrading and renovation of system of museums | 129,340,444 | 0.00% | 0.00% | 0.00% |
| 8 | Berat | Rehabilitation of Cobblestone Road "Mihal Komneno" to Berat castle | 148,120,404 | 100.00% | 100.00% | 100.00% |
| 9 | Berat | Upgrading of vehicle access road "Muzak Topia" to Berat castle | 299,960,703 | 25.00% | 26.00% | 21.42% |
| 10 | Berat | Berat Town of Integrated Urban Upgrading | 1,226,466,924 | 0.00% | 0.00% | 0.00% |
| 11 | Gjirokaster | Permet integrated urban upgraded | 398,547,169 | 0.00% | 0.00% | 0.00% |
| 12 | Gjirokaster | Street lighting - Permet | 4,601,667 | 100.00% | 100.00% | 100.00% |
| 13 | | Construction of view points | 56,161,970 | 0.00% | 0.00% | 0.00% |
| 14 | | Integrated upgarding of Zvernec -Narta &Benja Thermal Waters (works) | 101,091,546 | 0.00% | 0.00% | 0.00% |
| 15 | | Market Research in 4 Municipalities | 40,658,861 | 100.00% | 100.00% | 100.00% |
| 16 | | Market Development in 4 Municipalities | 97,854,685 | 5.00% | 5.00% | 5.00% |
| 17 | | Tourism Product development in 4 municipalities (Museum and Outdoors) - Consultancy | 72,458,838 | 0.00% | 0.00% | 0.00% |
| 18 | | Tourism Product development in 4 municipalities (Museum and Outdoors) - Works | 161,746,473 | 0.00% | 0.00% | 0.00% |
| 19 | | Tourism Product development in 4 municipalities (Events) | 204,291,955 | 0.00% | 0.00% | 0.00% |
| TOTALI | | | 5,646,907,100 | 16.46% | 16.41% | 15.61% |

PROGRAMI PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM NË ZONAT E PREKURA NGA TËRMETI: OBJEKTET ARSIMORE

Programi është i përbërë nga 51 Kontrata, si më poshtë:

- 23 Kontrata të Zbatimit;
- 21 Kontrata të Mbikeqyrjes;
- 7 Kontrata të Kolaudimit.

Në totalin e programit nuk ka patur kosto të shtuara mbi vlerat e programit dhe vlera e kontratave të lidhura ka qënë gjithmonë më e ulët se fondi limit i shpallur.

Tabela 19. Informacion mbi realizimin e për Rindërtim dhe Zhvillim në Zonat e Prekura nga Tërmeti: Objektet Arsimore

| Nr. | Qarku | Projekti | Vlera | Planifikim Punime | Realizim Fizik | Realizimi Financiar |
|---------------|--------|---|----------------------|-------------------|----------------|---------------------|
| 1 | Lezhe | Rindërtimi i objektit të ri: shkollës së mesme "Arif Hahil Sulaj" | 120,092,000 | 70.00% | 60.00% | 50.00% |
| 2 | Lezhe | Rindërtimi i objektit të ri: shkollës 9 - vjeçare "Dan Bajrami" & Mesme e bashkuar Llesh Nik Daka" | 277,400,000 | 75.00% | 85.00% | 80.00% |
| 3 | Durrës | Rindërtimi i objektit të ri: 9 - vjeçare dhe Kopsht "Ramazan Jangozi" & Kopshti "Kastriot" Derveni | 152,165,757 | 75.00% | 85.00% | 80.00% |
| 4 | Durrës | Rindërtimi i objektit të ri: Mesme e bashkuar "Selman Daci" | 122,510,000 | 0.00% | 0.00% | 0.00% |
| 5 | Durrës | Rindërtimi i objekteve të reja: 9-vjeçare dhe parashkollor "Larushkë Hajdar Hoxha" dhe 9-vjeçare dhe kopshtit "Gjon Luka Luz" Bashkia | 187,393,703 | 70.00% | 80.00% | 80.00% |
| 6 | Durrës | Rindërtimi i objektit të ri: shkollës 9 - vjeçare dhe Kopshti "Bedrie Bebeziqi" dhe Kopshti "Met Hasa" | 125,743,421 | 70.00% | 80.00% | 80.00% |
| 7 | Durrës | Rindërtimi i objektit të ri: shkollës 9 - vjeçare "Hasan Koci" | 185,927,669 | 90.00% | 90.00% | 90.00% |
| 8 | Durrës | Rindërtimi i objektit të ri: 9 vjeçare, "Neim Babameto" | 224,500,000 | 75.00% | 90.00% | 90.00% |
| 9 | Durrës | Rindërtimi i objektit të ri: 9 - vjeçare "Qemal Mici" | 281,400,000 | 70.00% | 80.00% | 80.00% |
| 10 | Durrës | Rindërtimi i objektit të ri: Shkolla 9-vjeçare "Njazi Mastori" dhe Shkolla fillore dhe Kopshti "Perlat" | 249,999,999 | 70.00% | 80.00% | 80.00% |
| 11 | Durrës | Rindërtimi i objektit të ri: Shkollës 9 - vjeçare & Kopsht "Adem Gjeli", dhe 9 - vjeçare "Xhelal Shtufi Shkafanaj" | 130,700,000 | 80.00% | 90.00% | 90.00% |
| 12 | Durrës | Rindërtimi i objektit të ri: 9 - vjeçare "Shaqe Mazreku", 9 - vjeçare dhe kopsht "Vëllezërit Haradina", Durrës | 321,073,500 | 15.00% | 15.00% | 10.00% |
| 13 | Tiranë | "Rindërtimi i objektit të ri: Shkolla 9-vjeçare "Gosë" | 110,100,100 | 70.00% | 90.00% | 90.00% |
| 14 | Tiranë | "Rindërtimi i objektit të ri: Shkolla 9-vjeçare "Shtodhër" dhe Profesionale "26 Marsi" | 209,056,073 | 70.00% | 80.00% | 80.00% |
| 15 | Durrës | Rindërtimi i objektit të ri: Rezidencë studentore kolektive "Konvikti Golem" Kavaje | 69,712,050 | 60.00% | 50.00% | 50.00% |
| 16 | Tiranë | Rindërtimi i objektit të ri: 9-Vjeçare "Jashar Hoxha" | 74,013,931 | 80.00% | 80.00% | 80.00% |
| 17 | Tiranë | "Rindërtimi i objektit të ri: Kopshti "Niko Hoxha" | 88,888,888 | 80.00% | 80.00% | 80.00% |
| 18 | Tiranë | Rindërtimi i objektit të ri: Shkollës 9 - vjeçare "Halit Coka" | 235,087,777 | 80.00% | 80.00% | 80.00% |
| 19 | Tiranë | Rindërtimi i objektit të ri: Kopshti "Halit Coka" dhe Kopshti "Lidhja e Prizrenit", Kamëz. | 200,000,000 | 80.00% | 80.00% | 80.00% |
| 20 | Tiranë | Rindërtimi i objektit të ri: Shkollës 9-vjeçare "Ahmetaq" dhe shkollës 9-vjeçare "Ramazan Subashi" | 145,636,977 | 90.00% | 90.00% | 90.00% |
| 21 | Tiranë | "Rindërtimi i objektit të ri: Kopshti "Muçaj" & Kopshti "Nr. 1" & Mesme "16 Shtatori" | 137,361,200 | 90.00% | 90.00% | 90.00% |
| 22 | Durrës | Rindërtimi i objektit të ri: Mesme e Bashkuar "Kajo Karafil", Shijak | 123,500,562 | 90.00% | 90.00% | 90.00% |
| 23 | Durrës | Rindërtimi i objektit të ri: Kopshti "Kodër Bërnuallë", Kopshti "Marqinet", 9 - vjeçare "Lidhja e Prizrenit" + "Patrit Llafliu" | 201,000,000 | 75.00% | 75.00% | 73.20% |
| TOTALI | | | 3,973,263,607 | 69.11% | 74.10% | 72.76% |

PROGRAMI PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM NË ZONAT E PREKURA NGA TËRMETI: INFRASTRUKTURA PUBLIKE

Programi është i përbërë nga 45 Kontrata, si më poshtë:

- 15 Kontrata të Projektimit;
- 15 Kontrata të Zbatimit;
- 15 Kontrata të Mbikëqyrjes.

Në totali nuk ka patur kosto të shtuara mbi vlerat e programit dhe vlera e kontratave të lidhura ka qënë gjithmonë më e ulët se fondi limit i shpallur.

Tabela 20. Informacion mbi realizimin e për Rindërtim dhe Zhvillim në Zonat e Prekura nga Tërmeti: Banesat Individuale

| Nr. | Qarku | Projekti | Vlera | Planifikim Punime | Realizim Fizik | Realizimi Financiar |
|---------------|----------------|--|----------------------|-------------------|----------------|---------------------|
| 1 | Durres, Tirane | Rindërtimi i 677 banesa individuale ,ndertimi dhe rikonstruksioni I infrastruktures publike ne funksion te tyre | 1,772,870,000 | 65.00% | 55.00% | 50.52% |
| 2 | Durres | Rindërtimi i 743 banesa individuale ,ndertimi dhe rikonstruksioni I infrastruktures publike ne funksion te tyre | 2,004,560,000 | 25.00% | 25.00% | 21.63% |
| 3 | Durres | Rindërtimi i 248 banesa individuale ,ndertimi dhe rikonstruksioni I infrastruktures publike ne funksion te tyre | 624,300,000 | 45.00% | 45.00% | 40.21% |
| 4 | Tirane | Rindërtimi i 162 banesa individuale ,ndertimi dhe rikonstruksioni I infrastruktures publike ne funksion te tyre. | 429,140,000 | 0.00% | 0.00% | 0.00% |
| 5 | Tirane | Rindërtimi i 148 banesa individuale ,ndertimi dhe rikonstruksioni I infrastruktures publike ne funksion te tyre. | 395,910,000 | 30.00% | 30.00% | 27.93% |
| TOTALI | | | 5,226,780,000 | 39.28% | 35.89% | 32.35% |

PROGRAMI PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM NË ZONAT E PREKURA NGA TËRMETI: BANESAT KOLEKTIVE

Në kuadrin e rindërtimit nga pasojat e tërmetit, një tjetër tipologji banesash ka marrë rrugë pas përfundimit të PDyV-ve, ato të njësive të banimit kolektiv. Duke qënë se i është dhënë prioritet objekteve arsimore, banesave individuale si edhe infrastrukturës publike, në fund të muajit qershor është përgatitur dhe shpalluar marrëveshja kuadër për projektimin e njësive të banimit kolektiv.

Janë miratuar të gjitha zonat e reja për zhvillim në të cilat janë përfshirë dhe saktësuar edhe kërkesat për strehim në banesat kolektive Pallat. Me miratimin e tyre ka filluar menjëherë edhe procesi i projektimit të këtyre njësive. Këto njësi janë ndarë në dy grupe:

- Banesa kolektive në zonat e reja sipas PDyV-ve;
- Banesa kolektive pikësore me PDyV të vençatë.

Këto të fundit janë kryesisht pallate në zonën e Bashkisë Durrës dhe janë objekte që po rindërtohen në të njëjtin vend ku banesa kolektive ka qënë edhe para tërmetit.

Procesi i rindërtimit është kryer në bashkëpunim me institucione të tjera ku secila prej tyre ka dhënë kontributin përkatës. Është lidhur Marrëveshje me

ARrSh me qëllim përdorimin e laboratorit të tyre të testimit të materialeve të ndërtimit me qëllim certifikimin e punimeve në të cilin janë kryer testime për mbi 11 objekte.

Grupe të përbashkëta inspektimi janë ngritur me Bashkitë me qëllim marrjen në dorëzim të objekteve apo evidentimit të problemeve të zbatimit. Po ashtu, në bashkëpunim dhe me kompanitë projektuese është bërë rishikimi i përbashkët i projekteve.

Është mbajtur koordinim i vazhdueshëm me AKPT me qëllim rishikimin e PDyV të zonave të miratuara apo ndryshimet e mundshme në projekte.

Tabela 21. Informacion mbi realizimin e për Rindërtim dhe Zhvillim në Zonat e Prekura nga Tërmeti: Banesat Individuale

| Nr. | Qarku | Pershkrimi i kontrates | Data e fillimit | Data e mbarimit | Vlera | Planifikim Punime | Realizim Fizik | Realizim Financiar |
|---------------|--------|--|-----------------|-----------------|--------------------------|-------------------|----------------|--------------------|
| 1 | Durrës | Rindërtimi i njesive te banimit (pallat)per 2 ndërtesa gjkesore N.1, 'Krugra 26 Nentori'dhe N.4 Bulevardi 'Dyrrah',sipas PDVY-se ne zonen e re per zhvillim 'Lejes Zhvillimore dhe projektit teknik,NJ.Administrative Durres,Bashkia Durres | 28/10/2020 | 11/04/2021 | 233,852,000.00 | 40% | 10% | 10% |
| 2 | Durrës | Rindërtimi i njesive te banimit ne ndërtesa (pallat) per Zona e re per zhvillim Marikaj, Njesia administrative Marikaj,Bashkia Vore, (Paketa A) | 21/12/2020 | 04/06/2021 | 446,312,961.02 | 10% | 5% | 0% |
| 3 | Lezhë | Rindërtimi i njesive te banimit ne ndërtesa (pallat) per Zona e re per zhvillim Lezhe 1 ,Njesia administrative Lezhe ,Bashkia Lezhe. | 25/11/2020 | 09/05/2021 | 467,500,000.00 | 30% | 10% | 20% |
| 4 | Lezhë | Rindërtimi i njesive te banimit ne ndërtesa (pallat) per Zona e re per zhvillim Lac 1/2 (paketa A) ,Njesia administrative Lac ,Bashkia Kurbin | 16/12/2020 | 30/05/2021 | 692,291,100.00 | 10% | 5% | 0% |
| 5 | Lezhë | Rindërtimi i njesive te banimit ne ndërtesa (pallat) per Zona e re per zhvillim Lac 1/2 (paketa B) ,Njesia administrative Lac ,Bashkia Kurbin | | | 517,000,000.00 | 10% | 5% | 0% |
| 6 | Tiranë | Rindërtimi i njesive te banimit ne ndërtesa (pallat) per Kavaje ,Bashkia Kavaje , Paketa A | 04/12/2020 | 18/05/2021 | 705,700,000.00 | 10% | 10% | 10% |
| 7 | Tiranë | Rindërtimi i njesive te banimit ne ndërtesa (pallat) per Zona e re per zhvillim Kavaje ,(paketa B),Njesia administrative Kavaje ,Bashkia Kavaje , Paketa B | 15/12/2020 | 29/05/2021 | 293,884,272.00 | 10% | 5% | 0% |
| 8 | Tiranë | Rindërtimi i njesive te banimit ne ndërtesa (pallat) per Zona e re per zhvillim Kavaje ,Njesia administrative Kavaje ,Bashkia Kavaje , Paketa C. | 15/12/2020 | 29/05/2021 | 660,449,463.00 | 10% | 5% | 0% |
| 9 | Tiranë | Rindërtimi i njesive te banimit ne ndërtesa (pallat) per Zona e re per zhvillim Golem ,Njesia administrative Golem ,Bashkia Kavaje . | 28/12/2020 | 11/06/2021 | 247,389,993.00 | 5% | 0% | 0% |
| 10 | Durrës | Rindërtimi i njesive te banimit ne ndërtesa (pallat) per Zona e re per zhvillim Thumanë, Objektet 1,2,3,5,6,7,8,9,10,Njesia administrative Thumanë, Bashkia Krujë , Paketa A | 15/12/2020 | 01/06/2021 | 581,830,670.00 | 10% | 10% | 0% |
| 11 | Durrës | Rindërtimi i njesive te banimit ne ndërtesa (pallat) per Zona e re per zhvillim Thumanë, Objektet 11,12,13,14,Njesia administrative Thumanë, Bashkia Krujë , Paketa B | 16/12/2020 | 25/05/2021 | 434,509,034.68 | 10% | 10% | 0% |
| 12 | Durrës | Rindërtimi i njesive te banimit ne ndërtesa (pallat) per Zona e re per zhvillim Thumanë, Objekti 4,Njesia administrative Thumanë, Bashkia Krujë . | 16/12/2020 | 25/05/2021 | | 10% | 5% | 0% |
| 13 | Durrës | Rindërtimi i njesive te banimit ne ndërtesa (pallat) per Zona e re per zhvillim Babiq,Njesia administrative Babiq ,Bashkia Kruje(Obj A,B, H2,B3,C1,C2,C3). | 28/12/2020 | 25/06/2021 | 167,624,376.03 | 5% | 0% | 0% |
| 14 | Durrës | Rindërtimi i njesive te banimit ne ndërtesa (pallat) per Zona e re per zhvillim Shijak,(Paketa A),Njesia administrative Shijak,Bashkia Shijak (Obj 3.1,3.2,3.3,3.4,3.5,4.1,7.1,8.1,8.2). | 28/12/2020 | 25/05/2021 | 580,387,500.00 | 5% | 0% | 0% |
| 15 | Durrës | Rindërtimi i njesive te banimit ne ndërtesa (pallat) per Zona e re per zhvillim Shijak,(Paketa B),Njesia administrative Shijak,Bashkia Shijak (Obj 5.1,5.2,5.3,5.4,5.5,5.6,5.7). | 28/12/2020 | 06/06/2021 | 630,000,000.00 | 5% | 0% | 0% |
| 16 | Durrës | Rindërtimi i njesive te banimit ne ndërtesa (pallat) per Zona e re per zhvillim Shijak,(Paketa C),Njesia administrative Shijak,Bashkia Shijak (Obj 5.8, 5.9, 5.10, 5.11, 5.12). | 28/12/2020 | 15/06/2021 | 430,000,000.00 | 5% | 0% | 0% |
| 17 | Durrës | Rindërtimi i njesive te banimit ne ndërtesa (pallat) per Zona e re per zhvillim Shijak,(Paketa D),Njesia administrative Shijak,Bashkia Shijak (Obj 3.13,5.14,5.15,5.16,5.17). | 28/12/2020 | 30/05/2021 | 508,000,000.00 | 5% | 0% | 0% |
| 18 | Durrës | Rindërtimi i njesive te banimit ne ndërtesa (pallat) per Zona e re per zhvillim Shijak,(Paketa E),Njesia administrative Shijak,Bashkia Shijak (Obj 5.18, 5.18, 5.20, 5.21, 6.1). | 28/12/2020 | 09/06/2021 | 574,581,326.00 | 5% | 0% | 0% |
| 19 | Tiranë | Rindërtimi i njesive te banimit ne ndërtesa (pallat) per Zona e re per zhvillim Vore ,(Paketa A) ,Njesia administrative Vore ,Bashkia Vore (Objektet BN.1.13, BN.1.02, BN.1.03, BN.5.02). | 05/01/2020 | 23/07/2020 | 390,000,000.00 | 0% | 0% | 0% |
| 20 | Tiranë | Rindërtimi i njesive te banimit ne ndërtesa (pallat) per Zona e re per zhvillim Vore ,(Paketa B) ,Njesia administrative Vore ,Bashkia Vore (Objektet BN.1.04 , BN.1.05, BN.1.07, BN.1.08, BN.1.09, BN.1.10, BN.1.11). | 05/01/2020 | 04/07/2020 | 417,400,000.00 | 0% | 0% | 0% |
| 21 | Tiranë | Rindërtimi i njesive te banimit ne ndërtesa (pallat) per Zona e re per zhvillim Vore ,(Paketa C) ,Njesia administrative Vore ,Bashkia Vore (Objektet BN.2.01 , BN.2.02, BN.2.03, BN.2.04, BN.2.05, BN.2.06). | 07/01/2020 | 05/07/2020 | 475,600,000.00 | 0% | 0% | 0% |
| 22 | Tiranë | Rindërtimi i njesive te banimit ne ndërtesa (pallat) per Zona e re per zhvillim Vore ,(Paketa D) ,Njesia administrative Vore ,Bashkia Vore (Objektet BN.3.01 , BN.3.02, BN.3.03, BN.3.04, BN.3.05, BN.3.07, BN.3.08, BN.3.09, BN.3.10, BN.3.11). | 07/01/2020 | 06/07/2020 | 592,046,165.00 | 0% | 0% | 0% |
| 23 | Tiranë | Rindërtimi i njesive te banimit ne ndërtesa (pallat) per Zona e re per zhvillim Vore ,(Paketa E) ,Njesia administrative Vore ,Bashkia Vore (Objektet BN.6.01 , BN.6.02, BN.6.03). | 07/01/2020 | 05/07/2020 | 609,120,800.00 | 0% | 0% | 0% |
| 24 | Durrës | Rindërtimi i njesive te banimit ne ndërtesa (pallat) per Zona e re per zhvillim Pushë - Kruje, (Paketa A) ,Njesia administrative Pushë - Kruje ,Bashkia Krujë (Objektet 1-6) | 19/01/2020 | 18/06/2020 | 348,760,697.00 | 0% | 0% | 0% |
| 25 | Durrës | Rindërtimi i njesive te banimit ne ndërtesa (pallat) per Zona e re per zhvillim Pushë - Kruje, (Paketa B) ,Njesia administrative Pushë - Kruje ,Bashkia Krujë (Objektet 7-12) | 19/01/2020 | 09/07/2020 | 377,050,145.47 | 0% | 0% | 0% |
| 26 | Durrës | Rindërtimi i njesive të banimit në ndërtesa (pallat) për zonen e re për zhvillim Krujë, Paketa A, njesia administrative Krujë, Bashkia Krujë" Objektet A+J, B, C, D+G, E, F+H, I | 24/02/2021 | 16/08/2021 | 650,000,000.00 | 0% | 0% | 0% |
| 27 | Durrës | "Rindërtimi i njesive të banimit në ndërtesa (pallat) për zonen e re për zhvillim Krujë, Paketa B, njesia administrative Krujë, Bashkia Krujë" Objektet K, X, Y, Z. | 24/02/2021 | 13/08/2021 | 560,648,914.00 | 0% | 0% | 0% |
| 28 | Lezhë | "Rindërtimi i njesive të banimit në ndërtesa (pallat) për zonen e re për zhvillim Mirditë, Objektet 1A, 2A, 1B, 1C, si dhe 2 njesi banimi gjkesore, njesia administrative Rreshen, Bashkia Mirditë. | 04/03/2021 | 17/08/2021 | 395,016,580.00 | 0% | 0% | 0% |
| 29 | Tiranë | Rindërtimi i njesive të banimit në ndërtesa (pallat) për zonen e re për zhvillim Valias, Blloku 1, Objektet 1,2,3,4,5,6 dhe 7 njesi banimi ne ndërtesa (pallat), njesia administrative Valias, Bashkia Kamez. | 05/03/2021 | 20/08/2021 | 555,000,000.00 | 0% | 0% | 0% |
| 30 | Tiranë | Rindërtimi i njesive të banimit në ndërtesa (pallat) për zonen e re për zhvillim Valias, Blloku 2, Objektet 1,2,3,4,5, dhe 6 njesi banimi ne ndërtesa (pallat), njesia administrative Valias, Bashkia Kamez | 05/03/2021 | 27/08/2021 | 322,447,300.00 | 0% | 0% | 0% |
| 31 | Tiranë | Rindërtimi i njesive të banimit në ndërtesa (pallat) për zonen e re për zhvillim Valias, Blloku 3, Objektet 1,2,3,4,5,6,7,8,9,10,11 dhe 12 njesi banimi ne ndërtesa (pallat), njesia administrative Valias, Bashkia Kamez | 16/03/2021 | 07/09/2021 | 656,970,000.00 | 0% | 0% | 0% |
| TOTALI | | | | | 14,821,373,297.20 | 0.20% | 0.00% | 0.00% |

PROGRAMET IPA

Fondi Shqiptar i Zhvillimit është përzgjedhur si partner në 12 projekte IPA (Instrumenti i ndihmës së para-aderimit). Zbatimi i këtyre projekteve ka për qëllim nxitjen e bashkëpunimit dhe solidaritetit midis shteteve partnere në këto programe, përfitimin nga zhvillimet e ndërsjellta në burimet e pasura natyrore, kulturore dhe njerëzore, si dhe kontribut në rritjen e kohezionit ekonomik, social dhe territorial në rajon. Programet IPA përfshijnë komponentët e mëposhtëm:

- Programe për zhvillimin e ekonomisë, turizmit, mjedisit, bujqësisë dhe blegtorisë;
- Programi “Para për punë publike në Bashkitë e Shkodër, Fier dhe Dimal”;
- Skema e granteve për zhvillimin rajonal.

6.2. MENAXHIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT

Procesi i menaxhimit të kontratave monitorohet ngushtë nga Njësia përkatese nëpërmjet specialistëve të cilësisë, pjesë e kësaj Njësie. Po ashtu, në bashkëpunim edhe me njësi të tjera si ajo e Auditit të Brendshëm, Njësia e Teknike dhe institucioneve të tjera, janë kryer teste të specializuara të materialeve. Është lidhur një Marrëveshje e Veçantë me ArrSh-në me qëllim përdorimin e laboratorit të tyre të testimit të materialeve të ndërtimit, për çertifikimin e tyre pas vendosjes në vepër. Janë kryer teste shtesë për mbi 11 objekte në këtë laborator, përveç testeve në laboratorët e licensuar apo mbikqyrësve të cilët kryejnë periodikisht testet e performancës.

Një grup i vecantë *ad hoc* i përbërë nga inxhinierë, juristë, arkitektë, pjesë e stafit të FSHZH-së është ngritur për kontrollin final të objekteve të “Programit për Rindërtim dhe Zhvillim në Zonat e Prekura nga Tërmeti” që kanë përfunduar, me qëllim kontrollin e tyre final përpara dorëzimit pranë bashkive.

Grupe të përbashkëta inspektimi janë ngritur po ashtu me Bashkitë, për marrjen në dorëzim të objekteve apo evidentimit të problemeve të zbatimit. Në bashkëpunim dhe me kompanitë projektuese është bërë rishikimi i përbashkët i projekteve në rastet kur nevojitet.

Është mbajtur koordinim i vazhdueshëm me AKPT, Institutin e Ndërtimit, Entin e Banesave, Ministrinë e Arsimit, bashkitë, me qëllim rishikimin e PDyV-ve të zonave të miratuara apo ndryshimet e mundshme në projekte në Programin për Rindërtim dhe Zhvillim në Zonat e Prekura nga Tërmeti.

Kontrolli i cilësisë është kryer edhe për procedurat e përgatitjes së dosjeve të objekteve, si urdhër-ndryshimet, amendimet etj. Rruga e ndjekur sipas strukturës së re të FSHZH filtron çdo ndryshim projekti në 4 njësi përpara miratimit të tyre.

7. ZBATIMI I PROGRAMEVE

7.1. PROJEKTIMI

Gjatë periudhës kohore 2020 në FSHZH janë përgatitur dhe kontrolluar rreth 420 projekt-propozime të zhvillimit, sipas përcaktimeve të programeve të FSHZH-së, nga të cilat mbi 80% e tyre janë konsideruar si projekte të maturuara dhe mund të vijonin procesin e detajimit apo prokurimit. Gjithashtu, për të garantuar cilësinë, si dhe certifikimin e projekteve, FSHZH ka siguruar oponentë teknike nga institucionet përkatëse për rreth 360 projekte zbatimi.

Për realizimin e këtyre projekt-propozimeve, janë kryer të gjitha fazat e kontrollit sasior dhe cilësor, si edhe janë realizuar Termat e Referencës për projekt-propozimet e kërkuara, përkatësisht sipas programeve të mëposhtme:

PROGRAMI I NDËRHYRJEVE TË FINANCUARA NGA BUXHETI I SHETIT

Gjatë periudhës kohore 2020, janë kontrolluar 57 projekte të sjella nga Donatorë dhe Njësi të Vetqeverisjes Vendore, si kërkesa për financim, si pjesë e investimeve nga Infrastruktura Vendore Rajonale 2019-2021; Projekti i Investimeve Prioritare me impakt të lartë në zhvillimin ekonomik dhe promovimin e turizmit; Projekti për Zhvillim të Integruar Urban dhe Turistik; Programi i Furnizimit me Ujë i Zonave Rurale IV.

Këto projekte kanë pasur natyrë zhvillimi të fokusuar në fusha të ndryshme sipas prioriteteve strategjike të zonave të ndërhyrjeve, si: turizëm, akses dhe infrastrukturë rrugore, ujësjellësa e kanalizime, infrastruktura në shërbim të rekreacionit, shesheve publike si dhe ndërhyrjeve për rritjen e efikasitetit energjitike në objekte apo lagje specifike, në bashki të ndryshme.

PROGRAMI I FURNIZIMIT ME UJË TË ZONAVE RURALE III DHE IV

Gjatë vitit 2020, në kuadër të “Programit të Furnizimit me Ujë të Zonave Rurale III dhe IV”, është kontrolluar dhe përgatitur për fazën e prokurimit 1 projekt.

PROGRAMI I KONEKTIVITETIT TË RRUGËVE RAJONALE DHE LOKALE

Gjatë vitit 2020, në kuadër të “Programit të Konektivitetit të Rrugëve Rajonale dhe Lokale”, është kontrolluar dhe përgatitur për fazën e prokurimit 6 projekte.

PROJEKTI PËR ZHVILLIMIN E INTEGRUAR URBAN DHE TURISTIK

Gjatë vitit 2020, në kuadër të programit “Për Zhvillimin e Integruar Urban dhe të Turizmit (PZHIUT)” i cili është i financuar me hua të akorduar nga Banka Botërore për Qeverinë Shqiptare janë kontrolluar dhe përgatitur për fazën e prokurimit 38 projekte.

PROGRAMI PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM NË ZONAT E PREKURA NGA TËRMETI

- Janë realizuar Termat e Referencës për zhvillimin e projekt-ideve dhe projekteve të zbatimit në të gjitha zonat e rindërtimit, të përcaktuar nga planet territoriale PDyV, me një sipërfaqja totale shfrytëzimi territorial prej rreth 156 Ha (1,561,449 m²). Këto terma reference kanë shërbyer si hap parësor për realizimin e detyrës së projektimit për projektet e infrastrukturave publike, objekteve të banimit, shërbimit dhe atyre arsimore si, kopshte dhe shkolla;
- Janë kontrolluar dhe përgatitur për prokurim 17 projekte zbatimi të Infrastrukturave në Zonat e Rindërtimit, të përcaktuara nga planet territoriale PDyV, për qendrat e banuara: Laç, Thumanë, Shijak, Lezhë, Krujë, Bubq, Vorë, Marikaj, Durrës, Manëz, Kavajë, Golem, Mirditë;
- Janë kontrolluar 256 projekt ide të Objekteve të Banesave Kolektive/ Pallat (objekte të veçuara apo/ose të bashkëlidhura), të përcaktuara nga planet territoriale PDyV, për qendrat e banuara Laç, Thumanë, Mirditë, Shijak, Lezhë, Krujë, Bubq, Vorë, Marikaj, Durrës, Manëz, Kavajë, Golem. Nga këto projekte pallatesh të realizuara, mbi 90 % e tyre janë në proces zbatimi/ndërtimi nga FSHZH dhe donatorë të tjerë të përfshirë në procesin e rindërtimit;
- Për banesat individuale, janë kontrolluar dhe realizuar projektet tip (3 modele), tipologjia 1+1; 2+1; 3+1; këto modele tip më pas janë replikuar për zbatim, për çdo zonë rindërtimi, sipas përcaktimeve të PDyV-ve pikësore;
- Për ndërtimin e Objekteve Arsimore, janë realizuar dhe kontrolluar 41 projekte të përbëra nga kopshte dhe shkolla, sipas nevojave të përcaktuara nga çdo bashki e prekur nga zona e tërmetit.

7.2. LEJET

Gjatë vitit 2020, FSHZH në zbatim të legjislacionit shqiptar për pajisjen me lejet përkatëse të të gjitha projekteve ka aplikuar dhe bërë të mundur plotësimin e të gjithë dokumentacionit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM), leje mjedisi, leje ndërtimi, Vlerësimin e Impaktit Social, Ruajtjen dhe Sigurinë në Punë për 116 objekte, përkatësisht sipas programeve të mëposhtme:

PROGRAMI I NDËRHYRJEVE TË FINANCUARA NGA BUXHETI I SHTETIT

Gjatë periudhës kohore 2020, janë kontrolluar 57 Raporte të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të projekteve të sjella nga Donatorë dhe Njësi të Vetqeverisjes Vendore, si kërkesa për financim, si pjesë e investimeve nga Infrastruktura

Vendore Rajonale 2019-2021, Projekti i Investimeve Prioritare me impakt të lartë në zhvillimin ekonomik dhe promovimin e turizmit, Projekti për Zhvillim të Integruar Urban dhe Turistik, Programi Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale IV.

Për këto projekte janë kryer aplikimet për leje mjedisi dhe leje ndërtimi, si dhe janë siguruar përkatësisht 57 leje mjedisi dhe 46 leje ndërtimi. Objektet që nuk janë pajisur akoma me leje ndërtimi, kanë kryesisht problematika me pronësinë ose me vonesa në vendimmarrje nga institucionet përkatëse për pajisjen me lejet dhe autorizimet që kërkohen për këto objekte.

Për të gjitha objektet që janë në fazë zbatimi, janë kryer monitorime në terren nga specialistët e mjedisit, socialë, si dhe të shëndetit dhe sigurisë në punë. Në total janë kryer 138 inspektime në terren.

Gjatë inspektimeve janë konstatuar problematika të tilla si: mungesë dokumentacioni lejesh dhe liçencash në kantier, mungesë të lejes së vendepozitimit, pluhura gjatë punimeve, dëmtime të bimësisë dekorative ekzistuese, mbetje të hedhura në skarpata, të cilat janë raportuar dhe dërguar kontraktorit dhe supervizorit për të marrë masat përkatëse. Në inspektimet e rradhës, gjendja është gjetur e përmirësuar. Në lidhje me objektet që kanë komponent gjelbërimi, hasen problematika të tilla si: përmasa jo të duhura të gropave të pemeve, ankorimi, cilësia dhe gjendja vegetative, vaditja, të cilat, pasi janë raportuar tek kontraktori dhe supervizori, në inspektimet e rradhës janë gjetur të përmirësuara.

PROGRAMI I FURNIZIMIT ME UJË TË ZONAVE RURALE III DHE IV

Gjatë vitit 2020, në kuadër të “Programit të Furnizimit me Ujë të Zonave Rurale III dhe IV”, është kontrolluar Raporti i VNM-së dhe është aplikuar për Leje Mjedisit për një projekt në programin IV, si dhe ndodhet në proces aplikimi dhe për leje ndërtimi. Janë bërë tre takime në bashki në lidhje me çështjet sociale të shpronësimeve dhe është finalizuar RAP (plani i veprimit të risistemimit) sipas politikave të donatorit.

Për sa i përket programit III, janë pajisur me leje mjedisi dhe ndërtimi të gjitha projektet para vitit 2020, gjithsej 4 lote.

PROGRAMI I KONEKTIVITETIT TË RRUGËVE RAJONALE DHE LOKALE

Gjatë vitit 2020, në kuadër të “Programit të Konektivitetit të Rrugëve Rajonale dhe Lokale”, janë kontrolluar raportet e VNM-ve dhe janë kryer aplikimet për leje mjedisi dhe ndërtimi për 6 projekte. Me leje mjedisi janë pasjitur të 6 objektet, kurse leje ndërtimi ka vetëm njëri prej objekteve. Problematikat kryesore në krijimin e vonesave janë çështjet e pronësisë dhe mungesa e informacionit

juridik, që duhet të merret zyrtarisht nga Zyrrat Kadastrale, të cilat e japin informacionin me vonesë, te pjesshem ose nuk e japin fare, çka krijon ngërç në procesin e marrjes së lejes së ndërtimit dhe procedurave të shpronësimit.

Janë kryer 5 konsultime me publikun, ku janë prezantuar VNM-të dhe impaktet mjedisore dhe sociale të projekteve.

Për objektet që janë në fazë zbatimi, janë kryer monitorime në terren nga specialistët e mjedisit, socialë, si dhe të shëndetit dhe sigurisë në punë. Në total janë kryer 10 inspektime në terren.

Për sa i përket impaktit social, për rrugën Pogradec-Tushemisht, ka pasur ankesa nga komuniteti në lidhje me shpronësimet dhe janë bërë takime të shpeshta dhe verifikime në terren, për të adresuar çeshtjet së bashku me bashkinë.

Për dy nga rrugët në zbatim Qafë Thore-Theth dhe Bënçë-Lekdush, ka pasur probleme për venddepozitim të inerteve dhe bashkë me bashkitë përkatëse është zgjidhur problematika, duke caktuar venddepozitimet e tyre.

PROJEKTI PËR ZHVILLIMIN E INTEGRUAR URBAN DHE TURISTIK

Gjatë vitit 2020, në kuadër të programit “Për Zhvillimin e IntegrUAR Urban dhe të Turizmit (PZHIUT)” i cili është i financuar me hua të akorduar nga Banka Botërore për Qeverinë Shqiptare janë kontrolluar raportet e VNM-ve për 38 projekte dhe është aplikuar për leje mjedisi dhe ndërtimi për 9 objekte. Lejet e mjedisit kanë dalë për të 9 objektet, kurse me leje ndërtimi janë pajisur vetëm 6 objekte. Pjesa tjetër e objekteve janë në fazë miratimi nga institucionet përkatëse.

Janë kryer 9 konsultime me publikun, ku janë prezantuar VNM-të, si dhe impaktet mjedisore dhe sociale të projekteve.

Projekte në kuadër të PZHIUT kanë hasur problematika sociale, të cilat janë shqyrtuar nga specialisti social i FSHZH dhe janë adresuar për t’iu dhënë zgjidhja. Janë paraqitur 5 ankesa, të cilat janë adresuar dhe prej tyre janë zgjidhur 2; pjesa tjetër e ankesave janë në proces shqyrtimi dhe diskutimi.

PROGRAMI PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM NË ZONAT E PREKURA NGA TËRMETI

- Janë kontrolluar Raportet e VNM dhe është aplikuar për leje mjedisi për 13 projekte zbatimi të Infrastrukturave në zonat e rindërtimit, të përcaktuara nga planet territoriale PDyV, për qendrat e banuara Laç, Thumanë, Shijak, Lezhë, Krujë, Bubq, Vorë, Marikaj, Durrës, Manëz, Kavajë, Golem, Mirditë, nga të cilat kanë leje mjedisi 10 objekte.

- Janë kryer 13 aplikime për leje ndërtimi nga të cilat vetëm 10 janë miratuar. Problematikat me vonesat në pajisjen e objekteve me leje ndërtimi janë ato të pronësisë të cilat e kanë penguar shpeshherë procesin për marrjen e lejes në kohë.
- Janë kryer në total 322 inspektime në terren nga specialistët mjedisorë, socialë, si dhe të shëndetit dhe sigurisë në punë, për ndërtimin e Objekteve Arsimore të përbëra nga Kopshte dhe Shkolla, sipas nevojave të përcaktuara nga çdo bashki e prekur nga zona e tërmetit.
- Për banesat individuale janë kontrolluar dhe realizuar projektet tip (3 modele), tipologjia 1+1; 2+1; 3+1; këto modele tip më pas janë replikuar për zbatim, për çdo zonë rindërtimi, sipas përcaktimeve të PDyV-ve pikësore; Jane kryer në total 14 aplikime për leje ndërtimi, duke përfshirë banesat individuale në të gjitha zonat e reja për zhvillim.

Informacioni në mënyrë të përmbledhur mbi Lejet e Mjedisit dhe Lejet e Ndërtimit sipas programeve gjendet në tabelën e mëposhtme:

Tabela 22. Informacion mbi Lejet e Mjedisit dhe Lejet e Ndërtimit sipas programeve

| Nr | PROGRAMI | LEJE MJEDISI | | LEJE NDERTIMI | |
|---------------|---|--------------|------------|---------------|------------|
| | | Aplikuar | Marre leja | Aplikuar | Marre leja |
| 1 | RINDERTIMI - Infrastruktura Publike | 10 | 10 | 10 | 10 |
| 2 | RINDERTIMI - Objekteve arsimore + Kopshte | | | | |
| 3 | RINDERTIMI - Banesat Individuale | 0 | 0 | 14 | 13 |
| 4 | IVR - Rivitalizimi urban i zonave me potencial te larte turistik ne Rajonin 4 | 1 | 1 | 1 | 0 |
| 5 | IVR - Permiresimi i infrastruktures se shtresave sociale ne funksion te zhvillimit ekonomik rajonal | 1 | 1 | 1 | 1 |
| 6 | IVR - Permiresimi i infrastruktures turistike ne funksion te zhvillimit ekonomik rajonal | 1 | 1 | 1 | 0 |
| 7 | IVR - Zhvillimi i atrkasionit turistik mbeshtetur mbi potencialet lokale | 4 | 4 | 4 | 4 |
| 8 | IVR - Nderhyrje ne Infrastrukure 2020 | 9 | 9 | 9 | 7 |
| 9 | IVR - Permiresimi i shtresave rrugore | 0 | 0 | 8 | 8 |
| 10 | GOA - Permiresimi i shtresave rrugore | 0 | 0 | 8 | 8 |
| 11 | GOA - Investimeve ne Infrastrukture (Programe Zhvillimi 01) | 15 | 15 | 15 | 10 |
| 12 | GOA - Investimeve ne Infrastrukture (Akti Normativ) | 21 | 21 | 21 | 19 |
| 13 | PZHIUT - Programi i Zhvillimit te Integruar Urban dhe Turizmin | 4 | 4 | 4 | 2 |
| 14 | PRLRL - Programi i Rrugeve Lidhese Rajonale dhe Lokale | 5 | 5 | 5 | 1 |
| TOTALI | | 71 | 71 | 101 | 83 |

7.3. NDËRTIMI

Gjatë vitit 2020 kanë qënë në proces dhe janë ndjekur punimet për rreth 830 objekte sipas programeve:

- Programi i Ndërhyrjeve të Financuara nga Buxheti i Shtetit: GoA-01 me 48 objekte;
- Programi i Ndërhyrjeve të Financuara nga Buxheti i Shtetit: IVR me 42 objekte;
- Projekti për Zhvillimin e Integruar Urban dhe Turistik me 2 objekte;
- Programi për Rindërtim dhe Zhvillim në Zonat e Prekura nga Tërmeti me 708 objekte sipas bashkive, përkatësisht:

- . Bashkia Durrës me 459 objekte;
 - . Bashkia Kavajë me 48 objekte;
 - . Bashkia Shijak me 201 objekte.
- Programi Lumi i Vlorës, si dhe i Konektivitetit të Rrugëve Rajonale dhe Lokale me 9 objekte;
 - FUZR me 19 objekte.

Gjatë këtij viti janë realizuar volumet e punimve kryesore, si më poshtë:

- Gërmim/Mbushje 4,5 milionë m³;
- Betone 500 mijë m³;
- Shtresa Asfaltike 2 milionë m².

7.4. SHËNDETI, SIGURIA, MJEDISI DHE PËRGJEGJËSIA SOCIALE

Gjatë vitit 2020, FSHZH ka kontrolluar dhe inspektuar për sigurinë dhe shëndetin në punë objektet sipas programeve, përkatësisht:

PROGRAMI I NDËRHYRJEVE TË FINANCUARA NGA BUXHETI I SHTETIT

Janë kryer 25 inspektime dhe janë përgatitur raportet përkatëse, ku janë dhënë këshilla dhe rekomandime për çdo objekt të inspektuar. Inspektimet janë kryer në mënyrë periodike dhe në varësi të problematikave në terren. Në objektin “*Rivitalizimi i Rrugës Andon Pofka dhe hapësirave përreth saj*”, Bashkia Fier, ka patur problematika deri në pezullim të punimeve, çfarë ka sjellë impakt të mirë për sigurinë në kantier.

PROGRAMI I KONEKTIVITETIT TË RRUGËVE RAJONALE DHE LOKALE

Në total janë kryer 7 inspektime. Gjatë moniotimeve periodike është konstatuar se objekti “Qafë Thore-Theth”, ka pasur problematika në zbatimin e sigurisë në kantier me sinjalistikën, dokumentacionin, dhe veshjen e punës. Ndërkohë, është për t’u vlerësuar mbajtja dhe standardi i sigurisë në kantieret e Pogradec-Tushemisht, Gusmar–Kuç, Lekdush-Bënçë–Tepelenë.

PROJEKTI PËR ZHVILLIMIN E INTEGRUAR URBAN DHE TURISTIK

FSHZH ka kryer 6 inspektime përgjatë vitit 2020 në dy objektet që janë në zbatim.

Nga inspektimet e kryera është vënë re që objekti “Rikonstruksioni i rrugës automobilistike ‘Muzak Topia’ për në Kalanë e Beratit” ka pasur disa problematika, të cilat janë mbyllur sipas masave dhe rekomandimeve të paraqitura në raportin përkatës.

Viti 2020 për çeshtjet e sigurisë dhe shëndetit në punë, ka qënë një vit i suksesshëm, me Zero incident/aksident. Impakti dhe kontrollet e shpeshta në terren nga specialistët e HSE kanë qënë të frytshme pasi, kantieret kanë patur një ndryshim të madh duke u nisur që nga mobilizimi dhe deri të implementimi i sistemit të menaxhimit të risqeve dhe sigurisë teknike në terren.

PROGRAMI I REHABILITIMIT TË RRUGËS SË LUMIT TË VLORËS

Gjatë vitit 2020 programi Rehabilitimi i Rrugës së Lumit të Vlorës, është inspektuar dhe monitoruar nga FSHZH në mënyrë periodike (4 inspektime HSE dhe 2 inspektime mjedisore brenda vitit 2020). Nga inspektimet e kryera në terren për HSE, është konstatuar standard shumë i mirë i sigurisë në kantier.

PROGRAMI PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM NË ZONAT E PREKURA NGA TËRMETI

Për ndërtimin e Objekteve Arsimore, janë realizuar dhe kontrolluar 41 projekte të përbëra nga Kopshte dhe Shkolla, sipas nevojave të përcaktuara nga çdo bashki e prekur nga zona e tërmetit dhe janë kryer 200 inspektime për sigurinë dhe shëndetin në punë.

Duke u nisur që në periudhën Qeshor - Dhjetor 2020, që përkon me fazën e fillimit të punimeve, në programin e Rindertimit, specialsistët e Sigurisë dhe Shëndetit në punë kanë kryer inspektime periodike javore në 6 zona të reja për zhvillim si: Fushë Krujë, Kavajë, Bubq, Shijak, Vorë, Thumanë. Inspektimet janë kryer një herë në javë në çdo objekt dhe në varësi të problematikave të gjetura në terren. Objektet në zbatim, monitorohen në terren vazhdimisht me kontrolle për HSE dhe shoqërohen me raportet përkatëse.

Informacioni në mënyrë të përmbledhur mbi monitorimet në terren për komponentët e sigurisë, shëndetit, mjedisit dhe social sipas programeve gjendet në tabelën e mëposhtme:

Tabela 23. Informacion mbi Monitorimet në terren për HSE

| Nr | PROGRAMI | Monitorime ne terren | |
|---------------|---|----------------------|-----------------|
| | | Mjedisore | H&S |
| 1 | RINDERTIMI - Infrastruktura Publike | 10 | 48 + 2 (vora) |
| 2 | RINDERTIMI - Objekteve arsimore + Kopshte | | 200 |
| 3 | RINDERTIMI - Banesat Individuale | 13 | 0 |
| 4 | IVR - Rivitalizimi urban i zonave me potencial te larte turistik ne Rajonin 4 | 0 | 2 |
| 5 | IVR - Permiresimi i insfrastruktures se sherbimeve sociale ne funksion te zhvillimit ekonomik rajonal | 1 | 1 |
| 6 | IVR - Permiresimi i infrastruktures turistike ne funksion te zhvillimit ekonomik rajonal | 0 | 0 |
| 7 | IVR - Zhvillimi i atrkasionit turistik mbeshtetur mbi potencialet lokale | 4 | 0 |
| 8 | IVR - Nderhyrje ne Infrastrukure 2020 | 7 | 0 |
| 9 | IVR - Permiresimi i shtresave rrugore | 8 | 4 |
| 10 | GOA - Permiresimi i shtresave rrugore | 8 | 0 |
| 11 | GOA - Investimeve ne Infrastrukture (Program e Zhvillimi 01) | 10 | 7 |
| 12 | GOA - Investimeve ne Infrastrukture (Akti Normativ) | 19 | 11 |
| 13 | PZHIUT - Programi i Zhvillimit te Integruar Urban dhe Turizmin | 2 | 6 |
| 14 | PRLRL - Programi i Rrugeve Lidhese Rajonale dhe Lokale | 1 | 7 |
| TOTALI | | 83 | 288 |

7.5. DORËZIMET, KOLAUDIMET, DHËNIA NË PËRDORIM E OBJEKTEVE

Gjatë vitit 2020, punimet kanë përfunduar në 59 objekte, dhe janë dorëzuar tek Njësitë e Vetqeverisjes Vendore 11 objekte.

Gjatë vitit 2020 në kuadër të projekteve zhvillimore, FSHZH ka nënshkruar 95 Marrëveshje Investimi dhe Bashkëpunimi me NJVV-të dhe ARRSH me qëllim vendosjen e urave të bashkëpunimit për kryerjen në kohë, afat dhe me cilësi të projekteve zhvillimore.

Tabela 24. Informacion mbi objektet e dorëzuara sipas programeve

| Nr. | Programet e Zhvillimit | Sasia |
|---------------|---------------------------------|-----------|
| 1 | Buxheti i Shtetit | 8 |
| | Programe Zhvillimi (GoA 01) | 7 |
| | Infrastruktura Vendore Rajonale | 1 |
| 2 | Financim i Huaj | 1 |
| | Projekti i Turizmit (PIUTD) | 1 |
| 3 | Programi i Rural Water | 2 |
| | Rural 3 | 2 |
| TOTALI | | 11 |

Gjithashtu, gjatë 2020 janë monitoruar për defekte të mundshme sipas afatit të garancisë rreth 25 objekte.

8. AKTIVITETI I BRENDSHËM

Në kuadër të mbështetjes së organizatës për kryerjen me efikasitet të funksioneve të saj, drejtimet kryesore të aktivitetit kanë qenë përshtatja e strukturës dhe procedurave në përputhje me funksionet e reja të deleguara gjatë vitit 2020, menaxhimi i burimeve njerëzore për të garantuar cilësinë profesionale, si dhe sigurimi i infrastrukturës dhe logjistikës së nevojshme për mbarëvajtjen e aktivitetit. Fokus i veçantë i është dhënë sigurisë në punë dhe masave të marra për ruajtjen dhe parandalimin prej Covid -19.

8.1. STRUKTURAT DHE NJËSITË RAJONALE, RISHIKIMI I PROCEDURAVE DHE AKREDITIMI I FSHZH

Gjatë vitit 2020 FSHZH është përballur me sfidën për riorganizimin e brendshëm, adaptimin e funksioneve të reja dhe hartimin e procedurave të brendshme.

Dy kanë qenë risitë që kanë përcaktuar nevojën për rishikimin e funksioneve strukturës dhe procedurave:

- Përcaktimi i FSHZH-së si njësi zbatuese e Programit për Rindërtim dhe Zhvillim nga pasojat e Tërmetit.
- Përcaktimi i FSHZH-së si Autoriteti Menaxhues i Programit Operacional të Zhvillimit Rajonal sipas përcaktimit të ligjit nr.102/2020 “Për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin.

Për t’iu përgjigjur kësaj sfide, është bërë një analizë e funksioneve të reja, nevojave, strukturës aktuale dhe procedurave dhe janë marrë masat për adaptimet përkatëse nga FSHZH.

FUNKSIONET SI NJËSI ZBATUESE E PROGRAMIT TË RINDËRTIMIT

Me qëllim përgjigjen në kohë për organizimin e punës për rindërtimin e objekteve shkolla, banesa etj., me volume të mëdha dhe afate të shkurtra, me efikasitet dhe efektivitet, struktura e institucionit ka pësuar ndryshimet e mëposhtme:

- Është krijuar Njësia e Menaxhimit të Projekteve të Rindërtimit dhe Zhvillimit;
- Është krijuar Njësia për Shpronësimin, Lejet dhe Dorëzimin e Objekteve;
- Pozicioni i Specialistit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë është krijuar për menaxhimin e punës në kuadër të rritjes së sigurisë dhe shëndetit në punë brenda organizatës dhe të kujdeset që këto standarte të sigurohen dhe zbatohen edhe nga kontraktorë, supervisorë që zbatojnë projekte me FSHZH;

- Është ridizenjuar struktura e zyrave rajonale bazuar në kërkesat e ligjit për zhvillimin rajonal.

Për të gjitha strukturat e mësipërme janë hartuar procedurat përkatëse operacionale dhe janë reflektuar në Manualin e Procedurave të FSHZH-së si dhe janë kryer procedurat për plotësimin e pozicioneve të reja me stafin ekzistues apo me rekrutime të reja.

FUNKSIONET SI AUTORITET MENAXHUES

Funksionet e reja si Autoritet Menaxhues i Programit Operacional të Programit të Zhvillimit Rajonal dhe Kohezionit e vendosin FSHZH-në përpara dy sfidave:

- Rishikimi i strukturës dhe procedurave për të përshtatur funksionet e reja;
- Akreditimi i institucionit si strukturë menaxhuese e Fondeve të BE me synim përgatitjen për financimin nga fondet strukturore të programit Operacional të ZHRK.

Për sa më sipër në përmbushje të rolit si Autoritet Menaxhues i Programit Operacional, si dhe arritjen e certifikimit për menaxhimin e fondeve të BE-së nga FSHZH, gjatë 2020 nisi procesi i auditimit të Sistemit të Menaxhimit dhe Kontrollit brenda institucionit. Konkretisht, gjatë këtij viti është bërë një analizë e situatës ku u identifikuan 35 linja veprimi për t'u përmirësuar, të cilat përfshinin fusha si: përmirësimi i politikave, planeve, procedurave të departamenteve e njësisive të ndryshme si: burimet njerëzore, financa, prokurimet, ligjori, monitorimi dhe auditimi i organizatës.

Në këtë kuadër, gjatë vitit 2020 janë përgatitur draftet finale të të gjitha procedurave të operacioneve të identifikuara në FSHZH, të Politikës së Mbajtjes së Stafit, të Kodit të Etikës, të Metodologjisë së Ngarkesës në Punë.

Këto drafte finale pritet që së bashku me ndryshime të tjera që janë në proces, të bëhen pjesë e Manualit të përditësuar të Procedurave të institucionit.

Gjithashtu, në proces janë duke u përgatitur procedura të tjera kuadër për funksionimin në nivel makro të institucionit, si dhe dokumente të tjerë të nevojshëm.

Në përfundim të këtij procesi, synohet arritja e një sistemi të brendshëm të përmirësuar sipas kriterëve dhe standardeve të BE-së, si dhe i hapet rruga për aplikimin, për vlerësimin dhe certifikimin e FSHZH-së si menaxhues i fondeve të BE-së.

8.2. MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE

Numri i punonjësve në strukturën e FSHZH është 164 punonjës, nga të cilët në fund të vitit 2020 janë 139 punonjës. Gjatë vitit 2020 u punësuan 14 punonjës; u larguan 5 punonjës nga të cilët tre për shkak të daljes në pension.

Për vitin 2021, me qëllim tërheqjen e talenteve më të mira për punësim, në organizatë është përgatitur Programi i Praktikave të Punës që ka si objektivi Zbatimin e Programit si një instrument strategjik për të identifikuar burime njerëzore potenciale me kosto të ulët dhe të provuara në mjedis profesional; dhe krijimin e një platforme profesionale me talentet e reja të identifikuara në fushat që kanë interes për FSHZH-në, si një burim i rëndësishëm kapacitetesh njerëzore.

8.3. SHËNDETI DHE SIGURIA NË PUNË

Për menaxhimin e situatës së krijuar nga Pandemia e Covid 19, FSHZH ka marrë të gjitha masat për parandalimin e infeksionit brenda institucionit. Me shpalljen e situatës së jashtëzakonshme është hartuar plani i masave (Urdhri nr. 12 datë 12.03.2020 “Për planin e masave në FSHZH”) në zbatim rigoroz të udhëzimeve të Ministrisë së Shëndetësisë. Në mënyrë ditore Specialisti i Shëndetit dhe Sigurisë në punë është kujdesur për ndjekjen e situatës, frenimin e shpërndarjes së infeksionit nëpërmjet kryerjes së testimeve të nevojshme dhe duke qëndruar në kontakt të vazhdueshëm me punonjësit. Gjatë vitit rezultojnë 50% e punonjësve të infektuar me Covid-19.

8.4. INFRASTRUKTURA MBËSHTETËSE DHE LOGJISTIKA E FSHZH-SË

FSHZH operon në zyrën qendrore Tiranë dhe në zyrat: Korçë, Shkodër, Vlorë dhe Gjirokastrë.

Zyra Qendrore nga pikpamja teknike është e amortizuar dhe në gjendje jo të mirë. Në bazë të vlerësimit të kryer nga Instituti i Ndërtimit, godinës së FSHZH-së, janë evidentuar dëmtime strukturore të shkallës DS3, nga ku lind nevoja e ndërhyrjeve për përmirësimin e strukturës mbajtëse të objektit dhe ndërhyrje të tjera rehabilituese të nevojshme, në funksion të rritjes së sigurisë në ambjentet e punës së punonjësve të FSHZH-së. Këto ndërhyrje janë planifikuar për t'u implementuar në projektin e Ngritjes së Qendrave të Ekselencës për Zhvillimin Rajonal dhe Vendor.

Zyra Rajonale Tiranë është vendosur pranë godinës Betahaus, ende e papërfunduar me standardet e kërkuara, është në zbatim projekti që parashikon

kondicionimin, krijimin e ambjenteve të arkivës & kushteve të përshtatshme. Këto ndërhyrje janë planifikuar për t'u implementuar në projektin e ngritjes së Qendrave të Ekselencës për Zhvillimin Rajonal dhe Vendor.

Zyra Rajonale Vlorë është e vendosur në ambjent me qira deri në fund të vitit 2021. Në fund të këtij viti do të shikohet mundësia e operimit të zyrës rajonale në një nga qendrat e integruara të zhvillimit rajonal.

Zyra Gjirokastrë është e vendosur në ambjent me qera, kontratë e cila do të ndërpritet në fund të muajit mars 2021, pasi më tej do të përdoren ambjente të bashkisë Gjirokastrë pa kosto qiraje.

Zyra Rajonale Shkodër aktualisht është vendosur në ambjent me qira, afër Bashkisë së këtij qyteti.

Flota e mjeteve që ka sot FSHZH është krijuar nga projekte të mëparshme që ka implementuar. Gjatë këtij viti, përveç investimeve dhe aktiviteteve që kryhen zakonisht, në FSHZH është shtuar edhe veprimtaria në lidhje me rindërtimin e zonave të dëmtuara nga tërmeti. Ky shtim i aktivitetit të Fondit është shoqëruar me rritje të pashmangshme të aktivitetit të flotës së mjeteve që janë përdorur në kantiere ndërtimi dhe terrene të vështira.

Kryesisht flota e mjeteve është e amortizuar pasi shumë mjete kanë mbi 200.000 km dhe vit prodhimi përpara 2009. Duke analizuar gjendjen teknike të flotës del e domosdoshme në vitet në vazhdim rigjenerimi i flotës, si një element që rrit efektivitetin, ul koston e shërbimeve dhe mirëmbajtjes së tyre, i përgjigjet dinamikës së zhvillimit të projekteve. si dhe rrit sigurinë e lëvizjes dhe transportit të punonjësve të FSHZH-së.

8.5. PROTOKOLLI, ARKIVA, MARRËDHËNIA ME TË TRETËT

Gjatë vitit 2020 janë protokolluar në Fondin Shqiptar të Zhvillimit gjithsej 7533 shkresa, ndër të cilat 4752 shkresa janë hyrëse, 2153 janë shkresa dalëse dhe 628 janë kontrata të ndryshme.

Shkresat hyrëse vijnë kryesisht nga institucione të ndryshme, nga operatorë ekonomikë, si dhe nga qytetarët, dhe më konkretisht nga 4752 shkresa hyrëse në fond, pesha specifike e tyre është:

- 3085 të shkresave hyrëse kanë ardhur nga operatorë ekonomikë;
- 1571 nga institucionet si: bashki, gjykata, ministri, Instituti i ndërtimit, ARRS, KESH, etj.;
- 96 shkresa nga qytetarë që i janë drejtuar FSHZH-së më shumë për problematika të cënimit të pronës së tyre.

Shkresat hyrëse në FSHZH hyjnë nëpërmjet postës ose sillen dorazi pranë zyrës së protokollit dhe pasi protokollohen, skanohen për t'u vendosur në arkivën elektronike dhe dërgohen për ndjekje tek personat përgjegjës, të cilët për disa lloje shkresash kryejnë veprime proceduriale që nuk kanë nevojë për përgjigje me shkresë, ndërsa për disa përgjigjen me shkresë zyrtare dalëse nga FSHZH-ja.

Shkresat që marrin përgjigje me veprime proceduriale ose me veprime konkrete në terren përbëjnë rreth 70% në total të shkresave hyrëse në FSHZH, si psh. dorëzime të raporteve mujore të punimeve, të situacioneve dhe faturave, njoftimet për fillim, pezullim ose përfundim të punimeve në objekte të ndryshme, kërkesat për lirim sheshi ndërtimi, për shtyrje të afatit të punimeve, kërkesat për financime, fletë-thirrjet për në gjykatë, vendimet, ankimet dhe çështje të tjera ku FSHZH është palë, aplikimet për leje ndërtimi etj.

Ndërsa *shkresat që kërkojnë përgjigje në formë shkresore përbëjnë rreth 30% të shkresave hyrëse* ku mund të përmendim kërkesat për informacion mbi projektet e zhvilluara ndër vite nga FSHZH, kërkesat për formularë vlerësimi, ankesat për procedura tenderi, delegimin e kërkesave dhe ankesave të qytetarëve, kërkesat nga ish punonjësit e FSHZH-së për dokumentacione ose vërtetime etj.

9. AKTIVITETI EKONOMIK

9.1. INSTRUMENTË TË RINJ

Në zbatim të kompetencave dhe objektivave të ligjit të saj, FSHZH vazhdimisht ka konsideruar mundësitë e zgjerimit të aktiviteteve për të përmbushur sa më mirë rolin e saj si organizatë për nxitjen e zhvillimit në nivel rajonal dhe vendor.

FSHZH ka nisur dhe vijon procesin e integritit të investimeve në formatin e ndërhyrjeve vendore e rajonale, duke synuar të përmbyllë një orientim të investimeve të ndarë sipas rajoneve, bazuar në potencialet zhvillimore të tyre.

Miratimi i ligjit për zhvillimin Rajonal dhe funksionet e programimit dhe menaxhimit të programit operacional, kanë parashtruar nevojën jo vetëm për një riformëzim të strukturës dhe funksioneve të brendshme të FSHZH-së, por edhe analizimin, planifikimin dhe jetëzimin e instrumenteve të rinj, autonomë, që të operojnë në mbështetje të funksioneve dhe aktivitetit të organizatës.

Kompleksiteti i ndërhyrjeve dhe shtrirja kapilare në territor, angazhimi gjerësisht i aktorëve lokalë si pjesë e strukturave të zhvillimit rajonal, formati i ri i zbatimit të ndërhyrjeve që parasheh një angazhim të drejtpërdrejtë të qeverisjes vendore, nevoja për menaxhim dhe funksionim efikas të ndërhyrjeve të integruara zhvillimore, shtron nevojën urgjente për:

- Sigurimin e një menaxhimi cilësor të investimeve që kryhen nga FSHZH dhe kthimi i tyre në të vetqëndrueshme;
- Zbatimi i ndërhyrjeve të drejtpërdrejta ekonomike për të zhbllokuar potencialin ekonomik që nuk është vetrregulluar nga tregu;
- Ngritjen dhe mbështetjen e modeleve të reja ekonomike në nivel vendor e rajonal;
- Ngritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore dhe krijimin e sistemeve efçente që ju përgjigjen funksioneve administrative dhe shërbimeve ndaj publikut;
- Ngritjen dhe aftësimin e strukturave jo qeveritare me fokus interesin publik që të mund të luajnë rolin e rregullatorit në një sërë fushash si turizmi, bujqësia, ekonomia etj, të cilat duhet të përfaqësojnë si interesin publik ashtu edhe atë privat.
- Ngritjen e kapaciteteve lidhur me hapjen e bizneseve të reja, menaxhimin, cilësinë e shërbimeve, standardet, krahun e kualifikuar të punës etj.
- Organizim të aktorëve kyç në komunitetet lokale, apo të bashkësive të interesit si për shembull shoqatat për menaxhimin e destinacionit turistik, shoqatat e biznesit në distriktet e biznesit, shoqatat në fushën e bujqësisë, etj., të cilat do të ofronin një kontribut kyç në optimizimin e ndërhyrjeve,

funksionimin dhe qëndrueshmërinë afatgjatë, dhe arritjen e zhvillimit ekonomik dhe social;

Për sa më sipër, në përputhje me hapësirat ligjore të parashikuara nga ligji i FSHZH-së, si dhe në respektim të legjislacionit përkatës për organizimin e shoqërive tregtare dhe organizatave jofitimprurëse, FSHZH ka iniciuar procesin për krijimin e 4 strukturave të reja që do t'i përgjigjen sfidave të mësipërme dhe do të kompletojnë instrumentat zhvillimorë në dispozicion të saj. Këto struktura janë si më poshtë:

1. Agjencia Ekonomike Mbështetëse Shpk

Agjencia Ekonomike Mbështetëse, një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar (SH.P.K), me ortak të vetëm FSHZH, operon prej korrikut të vitit 2018 si agjent ekonomik për FSHZH-në.

2. Shoqëria Tregtare për Menaxhimin e Aseteve Rajonale dhe Lokale

Shoqëria tregtare synon të nxisë zhvillimin ekonomik rajonal nëpërmjet menaxhimit dhe vënies në efikasitet të aseteve publike të degraduara apo me potencial të pazhvilluar, duke angazhuar kapitalin e FSHZH-së, kapital publik apo nëpërmjet partneritetit publik privat.

3. Organizate jofitimprurëse, e organizuar në formën e shoqatës me anëtarësi.

Organizata jofitimprurëse, në varësi të FSHZH-së ka si objekt:

- ofrimin e këshillimit për organizatat publike, private dhe joqeveritare, për përmirësimin e performancës së tyre nga pikëpamja e strukturave të brendshme organizative përmes asimilimit të praktikave më të mira ndërkombëtare, si dhe mbështetjes nëpërmjet ndryshimeve në proceset e punës, organizimin, burimet njerëzore dhe sistemet organizative, si dhe dhënin e këshillimit për krijimin dhe vënien në funksion të organizatave sektoriale dhe tematike në komunitet;
- ofrimin e këshillimit për bizneset lokale në mënyrë që këto të fundit në bashkëpunim dhe me mbështetjen edhe të organeve të vetqeverisjes vendore, të organizohen në organizma më të mëdha (shoqata), që do të kenë si antarësi të gjithë bizneset që operojnë në një fushë të caktuar.

4. Qendra e Ekselencës për Zhvillimin Rajonal

Kjo Qendër, që do të funksionojë në formatin e një OJF-je, do të ketë synim aftësimin e vazhdueshëm të kapitalit njerëzor në sektorin publik dhe privat për të arritur standardin më të lartë në vendet e tyre të punës, si dhe koordinimin

dhe optimizmin e kapitalit intelektual në funksion dhe mbështetje të zhvillimit rajonal nepermjet dhënies së asistencës teknike dhe kryerjes së trajnimeve, për ngritjen e kapaciteteve institucionale të pushtetit vendor, kryerjen e veprimtarive të ndryshme, në funksion të zbatimit të politikave e të instrumenteve të zhvillimit rajonal dhe vendor, si dhe aktiviteteve të tjera që lidhen me rritjen e kapaciteteve.

Agjencia Ekonomike Mbeshtetese është e vetmja strukturë që është ngritur dhe është aktive momentalisht. Tre strukturat e tjera që ishin parashikuar të ngriheshin gjatë vitit 2020 nuk janë formësuar për shkak të angazhimeve të shtuara të FSHZH-së në kuadër të Programit për Rindërtim dhe Zhvillimin e Zonave të Prekura nga Tërmeti dhe të Reformës së Zhvillimit Rajonal, si dhe në kushtet e kufizimeve të shtuara për shkak të pandemisë COVID-19.

Ky aktivitet pritet të finalizohet gjatë vitit 2021.

AGJENCIA EKONOMIKE MBËSHTETËSE

Misioni i Agjencisë është të jetë një aktor aktiv me interes publik në mjedisin e biznesit që, nëpërmjet ndërhyrjeve të drejtpërdrejta financiare apo në partneritet me sipërmarrje publike apo private, vendase apo të huaja, të nxisë zhvillimin ekonomik në nivel lokal, rajonal dhe qendror.

Funksionet kryesore të kompanisë janë:

- Menaxhon dhe operon investimet e kryera nga FSHZH;
- Rrit atraktivitetin dhe potencialin ekonomik në një territor zhvillimor;
- Mbështet dhe aftëson sipërmarrjen lokale;
- Inkubon dhe piloton teknologji te reja dhe të qëndrueshme;
- Gjeneron të ardhura për mbështetjen e aktivitetit të FSHZH-së.

Gjatë vitit 2020, AEM ka vijuar të përmbushë objektivat e saj për operimin e projekteve ekonomike në menaxhim dhe përgatitjen e projekteve të reja.

Buxheti i miratuar për Agjencinë Ekonomike Mbeshtetëse arrin në vlerën 70,985 milionë Lekë. Buxheti i realizuar gjatë vitit 2020 është rreth 55 milionë Lekë ose 77% të buxhetit vjetor.

Plani i realizimit për periudhën janar-dhjetor 2020 është në nivelin 66% e të ardhurave të parashikuara.

Ky nivel i ulet i të ardhurave krahasuar me planin është si rezultat i:

- Rënive të të ardhurave nga parkimi i QSUT, si pasojë e situatës epidemiologjike në vend, aktivitet ekonomik që është kontribues kryesor në të ardhurat e kompanisë;

- Kriza e sektorit të turizmit si pasojë e kufizimeve në lëvizje për shkak të pandemisë, ku operon me dy aktivitete, qendrat e turizmit Vermosh dhe Valbonë;
- Vënia në funksionim të dy qendrave të zhvillimit të turizmit jashtë sezonit turistik;
- Probleme teknike në ndërtimin e objekteve dhe mungesa në arredimin funksional të tyre, të paparashikuara në projektin teknik.

Agjencia Ekonomike Mbështetëse fokusoi aktivitetin e saj në keto drejtime kryesore:

- I. Menaxhimi i projekteve ekonomike:
 - Parkimi publik QSUT;
 - Qendra e Turizmit Valbonë;
 - Qendra e Turizmit Vermosh;
 - Qendra Multifunktionale për Mbështetjen e Shërbimeve për Sipërmarrjet e reja, Tiranë (QMMSHSR).
- II. Kërkimi i tregut dhe përgatitja e projekteve të reja:
 - Studim tregu;
 - Hartim plane biznesi;
 - Hartim dhe aplikim projekte;
 - Identifikimi dhe shfrytëzimi i pronave publike të papërdorura;
 - Identifikimi i granteve/kredive/investitoreve dhe kërkimi i financimit.
- III. Ngritja dhe konsolidimi i strukturës:
 - Konsolidimi i strukturës së menaxhimit;
 - Proçedurat e brendshme;
 - Ngritja dhe funksionimi i degëve.

9.2. AKTIVITETI I NJËSIVE EKONOMIKE

9.2.1. ADMINISTRIMI DHE FUNKSIONIMI I SHËRBIMIT TË PARKIMIT BRENDA QSUT

Mbështetur në planin e aktiviteteve të miratuara nga AEM gjatë vitit 2020, një rëndësi e veçantë i është dhënë respektimit të marrëveshjes së bashkëpunimit mes QSUT dhe AEM, si autoriteti menaxhues i territorit të QSUT.

Janë kryer një sërë takimesh zyrtare midis AEM dhe administratës së QSUT në lidhje më ecurinë e shërbimit të parkimit, në kuadër të situatës epidemiologjike të shkaktuar nga pandemia COVID-19.

Në zbatim të nenit 3 të Akt-Marrëveshjes së lidhur me QSUT mbi listën e prioritetëve të investimeve të miratuar nga MSHMS, AEM ka ndjekur nga afër

ecurinë e investimeve infrastrukturore që po kryhen në QSUT. Gjatë këtyre takimeve janë kryer raportime të vazhdueshme dhe është ngritur një bashkëpunim efektiv midis palëve, me synim përmbylljen në afatet e miratuara kohore dhe në përputhje të plotë me projektet teknike të këtyre investimeve.

Janë kryer kontrole dhe monitorime të vazhdueshme nga ana e administratës së AEM të projektit “Shërbim parkimi në QSUT”, me qëllim sigurimin dhe garantimin e standardeve të cilësisë së shërbimeve, performancës së punonjësve dhe evidentimin e problematikave në territor.

Një rëndësi e veçantë i është kushtuar dhe forcimit të kapaciteteve menaxhuese, administrative dhe teknike të punonjësve të angazhuar në këtë projekt. Kjo është realizuar përmes zhvillimit të sesioneve periodike të trajnimit me fokus sigurimi teknik dhe masat mbrojtëse nga COVID-19.

Treguesit ekonomikë dhe financiarë në përfundim të vitit 2020 dëshmojnë se AEM sh.p.k ka arritur të përmbushë në mënyrë jo të plotë detyrat dhe objektivat e vendosura nga programi financiar për muajt tetor-dhjetor 2020. Ajo që mund të evidentohet për ecurinë e realizimit të të ardhurave në këtë tremujor është fakti i mos realizimit të të ardhurave të planifikuara, si rezultat i situatës së krijuar nga pandemia COVID-19. Masat e marra dhe urdhërat e nxjerrë nga institucionet përgjegjëse gjatë kësaj periudhe shkaktuan një rënie të nivelit të të ardhurave.

Një shkak tjetër i cili ndikoi në përmbushjen e objektivave financiarë në këtë aktivitet ekonomik ishte dhe fakti i hapjes së Spitalit COVID 3 në territorin e QSUT, i cili ndikoi në uljen e frekuentimit të automjeteve në territor.

Gjatë kësaj periudhe, AEM ka disiplinuar lëvizjen dhe qëndrimin e automjeteve në territorin e jashtëm të Godinës QMSHSR përmes vendosjes së tarifave mujore për automjetet të cilat shfytëzojnë këtë hapësirë.

Gjatë muajit nëntor, AEM testoi në mënyrë të suksesshme menaxhimin e dy aktiviteteve të organizuara në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë në hapësirat e brendshme të Godinës së QMSHSR.

Aktivitetet e organizuara ishin Workshopshop “Nanoalb & Zbatimi industrial” më datë 18.11.2020 dhe Konferenca Ndërkombëtare “Gjeoshkenca dhe Inxhinieria e tërmeteve, sfidat e rajonit të Ballkanit” më datë 26-28.11.2020.

9.2.2. NDËRTIMI I GODINËS SË PARKIMIT DHE HAPËSIRAVE MBËSHTETËSE NË BERAT

Në rrugët tek shëtitorja “Osumi”, sheshi “Agjencia” dhe në rrugën “Antipatrea”, të cilat përfaqësojnë edhe akset e qarkullimit që sigurojnë aksesin në qendrën e

qytetit, parkohet numri më i madh i mjeteve, rreth 200 automjete, të cilat shfrytëzojnë hapësirat në rrugë, hapësirat e brendshme të pallateve, pa llogaritur edhe numrin e automjeteve të vizitorëve. Kjo është edhe zona më e frekuentuar e qytetit nga qytetarët dhe vizitorët.

Me ndërtimin e strukturës së re të parkimit nëntokë do ti jepet një clirim këtyre akseve rrugore dhe hapësirave përreth. Kjo do të bëhet e mundur edhe përmes rregulloreve të reja të qarkullimit nga ana e Bashkisë në këtë zonë për ndalimin e parkimit në këto hapësira. Projekti ndodhet në proces zbatimi.

9.2.3. NDËRTIMI I GODINËS SË PARKIMIT DHE HAPËSIRAVE MBËSHTETËSE NË GJIROKASTËR

Projekti “Ndërtimi i Godinës së parkimit dhe hapësirave mbështetëse në Gjirokastër” parashikon ndërtimin e një parkimi nëntokësor me tre nivele parkimi, i cili do të mundësojë shmangien e problematikave të parkimit të krijuara nga mjetet në këtë shesh, dhe kthimin e kësaj hapësirë historike në një zonë në shërbim të turistëve dhe qytetarëve të qytetit.

Kjo ndërtesë do të shërbejë edhe si një pikë lidhëse midis infopoint dhe hapësirave të shërbimeve në qytet. Ajo do të jetë e pajisur më të gjithë infrastrukturën e nevojshme të shërbimeve publike. Ajo do të garantojë ruajtjen e një qarkullimi normal të mjeteve në qytet. Ndërtesa e re e parkimit planifikon ofrimin e këtij shërbimi me një kapacitet për 293 mjete në të tre nivelet e ndërtesës. Projekti ndodhet në proces zbatimi.

9.3. QENDRAT E TURIZMIT: VALBONË, VERMOSH, KORÇË

Në mbështetje të Vendimit Nr. 38, datë 10.08.2020 të Fondit Shqiptar të Zhvillimit për “Miratimin e kalimit të përgjegjësisë së Operimit/ Menaxhimit të Qendrës së Zhvillimit të Turizmit Valbonë” nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit tek Agjencia Ekonomike Mbështetëse, vazhdoi ofrimi i shërbimeve të akomodimit në këtë Qendër.

Për të përmbushur objektivat dhe qëllimet e QZHT Valbonë është kryer promovimi dhe marketing-u përmes vendosjes së kontakteve me operatorë turistikë, institucione, kompani biznesi dhe OJF. Janë aktive faqet e rrjeteve sociale dhe website i QZHT Valbonë.

Njëkohësisht ka vazhduar ngritja e kapaciteteve të stafit të rekrutuar, përmes trajnimeve dhe workshopshopeve të zhvilluara në fushën e turizmit dhe menaxhimit të shërbimeve.

AEM ka ndjekur me prioritet problematikat e shfaqura gjatë funksionimit të QZHT Valbonë, dhe ka punuar në drejtim të zgjidhjes apo minimizimit të efektit të tyre në mbarëvajtjen e shërbimeve.

Problematika kryesore mbetet mungesa e një gjeneratori për furnizimin alternativ me energji elektrike, pasi kjo zonë shfaq shkëputje 30-ditore të energjisë elektrike gjatë muajit dhjetor 2020.

Një faktor me ndikim në funksionimin e qendrës kanë qenë dhe kushtet e pazakonta atmosferike, të cilat sollën pengesa në infrastrukturën rrugore të zonës gjatë muajit dhjetor.

Gjatë kësaj periudhe raportimi, stafi lokal i Projektit është mbështetur direkt me prani fizike dhe profesionale nga stafi i AEM nga zyrat qendrore.

Gjatë periudhës së raportimit AEM vuri në funksionim “Qendrën e Akomodimit Rural Vermosh, në mbështetje të Vendimit Nr. 40, datë 29.09.2020 të Fondit Shqiptar të Zhvillimit për “Miratimin e kalimit të përgjegjësisë së Operimit/ Menaxhimit të Qendrës së Akomodimit Rural Vermosh” nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit tek Agjencia Ekonomike Mbështetëse.

Gjatë muajit tetor 2020 u zbatua një plan veprimi afatshkurtër për vënien në operim të plotë të QAR Vermosh me të gjitha shërbimet e planifikuara. Plani i veprimit konsistonte në vënien në funksion të strukturave pritëse, akomoduese, dyqanit të suvenirëve dhe të shërbimit të mëngjesit në kapacitet të plotë. Njëkohësisht filloi dhe procesi i rekrutimit të stafit lokal, i cili do të anagazhohet në Projektin Qendra e Akomodimit Rural Vermosh. Prosesi i rekrutimit u mbyll në mënyrë të suksesshme dhe u plotësua organika e Projektit mbështetur në skemën e menaxhimit të miratuar. Përveç shërbimit të akomodimit, pranë QZHT Valbonë filloi dhe funksioni i zyrës së informacionit për vizitorët dhe komunitetin e zonës së Valbonës. Stafi i angazhuar në QAR Vermosh iu nënshtrua një trajnimi tre-ditor për rritjen e kapaciteteve mbi menaxhimin e destinacioneve turistike me fokus zona e Vermoshit.

Gjatë muajit nëntor u zhvillua dhe trajnimi i organizuar nga Qendra për Aftësi Konkurruese me temë “Zbatimi i Protokollit COVID-19 në bizneset partnere të Projektit GIZ-SRD”. Në këtë trajnim mori pjesë stafi i QAR Vermosh. Gjatë kësaj periudhe, stafi lokal i Projektit është mbështetur direkt me prani fizike dhe profesionale nga stafi i AEM nga zyrat qendrore.

Në datën 28.10.2020 QAR Vermosh filloi funksionimin e plotë me të gjitha shërbimet për vizitorët e saj. AEM arriti të menaxhonte me sukses aktivitetin e organizuar nga FSHZH “Team Retreat”.

Për të promovuar shërbimet e ofruara nga kjo qendër, u aktivizuan platformat e rrjeteve sociale dhe faqja zyrtare, të cilat mundësojnë njohjen me këtë qendër të sapo hapur në Vermosh.

QAR Vermosh ka tërhequr vëmendjen dhe interesin e shumë vizitorëve, të cilët janë njohur me standardet dhe kushtet e ofruara. Problematika kryesore mbetet mos shfrytëzimi i kapaciteteve të QAR Vermosh në mënyrë plotë për shkak të mbylljes së sezonit turistik.

Njëkohësisht janë krijuar marrëdhënie bashkëpunimi me operatorë turistikë për të rritur mundësitë e promovimit të QZR Vermosh.

Gjatë periudhës së raportimit janë identifikuar dhe disa probleme teknike të cilat kanë ndikuar në realizimin e planit të të ardhurave.

Shqetësimi kryesor mbetet furnizimi me energji elektrike në mënyrë të pamjaftueshme duke rritur kostot e shërbimeve për shkak të aktivizimit të burimeve alternative si motogeneratorë.

Gjatë kësaj periudhe veprimtaria e AEM u fokusua në drejtim të një menaxhimi dhe administrimi sa më të mirë të aktivitetit ekonomik, duke e parë këtë zhvillim të lidhur ngushtë me situatën shëndetësore në Shqipëri dhe me misionin dhe objektivat e vendosura nga Shoqëria.

Për këtë arsye u krye riorganizimi i këtij shërbimi në përputhje me situatën e krijuar në QSUT dhe pajisjen e punonjësve të angazhuar në terren me mjetet e nevojshme mbrojtëse nga pandemia COVID-19.

Si rezultat i situatës epidemiologjike në Shqipëri, gjatë periudhës së raportimit u krye një riplanifikim i angazhimit të punonjësve me qëllim mbrojtjen dhe parandalimin nga pandemia COVID-19. U krye një ndërthurje midis punës online në banesë dhe punës në ambientet e zyrës.

Gjatë periudhës së raportimit përfundoi përgatitja e dy manualeve të operimit për QZHT Valbonë dhe QAR Vermosh.

Fondi Shqiptar i Zhvillimit vijon suportin e tij ndaj zhvillimit të turizmit, si fillim në skajet veriorë, me Valbonën e në Vermosh për të siguruar ambiente pritëse të ngrohta, për të gjitha grupmoshat, e më pas në Korçë.

Objekti në fjalë do të rikonceptohet si një godinë që krahas ambienteve të hotelit do të ofrojë një sërë mundësish, duke u kthyer kështu në një qendër promovuese ndaj zhvillimit të turizmit dhe vlerave kulturore të objektit. Kjo e fundit është e vendosur në bulevardin “Fan Noli, “në zemër të qytetit” kufizohet ne jug nga rruga 6 Dëshmorët, për të shfrytëzuar deri në orët e shëtitjeve të pasditës, në vijim të aktiviteteve familjare. Dhe jo vetëm, një mundësi e mirë për organizime

të Workshopshopeve nga institucionet, për shkak të mënyrës si janë konceptuar hapësirat.

Gjatë vitit 2020 është përgatitur Plani i Biznesit të QZHT Korçë në përputhje me planifikimin e investimeve që FSHZH po kryen në rehabilitimin e ish-Maternitetit të qytetit të Korçës. Projekti ndodhet në proces zbatimi dhe po vijon puna normalisht.

9.4. QENDRAT E TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT

9.4.1. LABORATORI I FERTILIZIMIT TË INOVACIONIT FILA

Projekti FILA synon të krijojë në rang ndërkufitar laboratorët FILA, të cilët janë “mjedise inovacioni” ku do të favorizohet bashkëpunimi ndërmjet aktorëve të sistemit të inovacionit (sipërmarrës të rinj, biznese të vogla e të mesme, organizata që mbështesin bizneset, qendra kërkimore, investitorë) për të përmirësuar aksesin në proceset kërkimore dhe në rezultatet e sipërmarrjeve bujqësore, pra për të stimuluar kërkimin e zgjidhjeve inovative dhe investimeve të mëtejshme në inovacion, si dhe për të mbështetur start-up-e.

Gjatë fillimit të projektit, është punuar për të përcaktuar një model të ri të Laboratorëve të Fertilizimit të Inovacionit – FILA, për përmirësimin e lidhjes midis kërkimit dhe SME-ve. Në modelin paraprak u identifikuan disa pika të dobëta si: qasja nga poshtë-lart, kapaciteti i dobët menaxhues, përfaqësi e ulët e komponentit territorial, lidhje jo të forta ndërkombëtare mes nismave dhe orientim i ulët i tregut, të cilat synohet të përmirësohen nëpërmjet projektit FILA.

Më konkretisht, është finalizuar mbledhja e të dhënave dhe hartimi i databazës së OG-ve (operational groups) në Shqipëri. Gjithashtu u organizuan tre takime të “Laboratorëve të Gjallë” me aktorët e fushës së agro-ushqimit dhe inovacionit si: insitucione shtetërore rajonale, qendra kërkimore, fermerë, universitete, organizata lokale etj, për të identifikuar problematikat kyçe në këtë sektor, si dhe përgatitja e analizës sintezë të këtyre tre takimeve.

Pas finalizimit të modelit FILA, fokusi kaloi në konkretizimin e modelit me realizimin e tre laboratorëve FILA në Itali, Mal të Zi, Shqipëri dhe investime tematike. Struktura ekzistente në zyrat Rajonale Korçë të Fondit Shqiptar të Zhvillimit u rikonstrua dhe u përshtat për akomodimin e një laboratorit të inovacionit agro-ushqimor. Në këtë laborator u kryen investime tematike për pajisjen e laboratorit FILA, që do të ofrojë shërbime për sipërmarrësit dhe aktorët e inovacionit si dhe për të siguruar bashkëpunimin ndërkufitar midis laboratorëve. U finalizua me sukses pajisja e laboratorit me mobilje zyre (tavolina, karrige, rafta, etj.), pajisjet elektronike (PC, laptop, dron, projektor, etj.)

dhe pajisjet bujqësore (kite testerash, etj.). Që prej ngritjes së këtij laboratorit janë kryer:

- Tre workshope tematike për nevojat inovative në sektorin e agro-ushqimit.
- Aktivitetet e rritjes së kapaciteteve ndër-kufitare, si Trajnimi 5-ditor i dhjetë Ndërmjetësuesve të Inovacionit, të cilët u përfshinë më tej në procesin e identifikimit të problematikave të SME-ve dhe ndërlidhjen e tyre me specialistë nga fusha e kërkimit për të implementuar inovacione në këto sipërmarrje të reja e SME.
- Aksioni Pilot i Inkubacionit të Sipërmarrjeve të reja". Ky aktivitet siguroi transferimin e njohurive dhe aftësive për krijimin e biznesit dhe ndryshimin në sektorin agro-ushqimor, duke përdorur modelin FILA.

Në vijim ky laborator do të shërbejë OG-ve (grupeve operationale) agro-ushqimore për të organizuar takime nëpërmjet vënies në dispozicion të laboratorit dhe pajisjeve elektronike dhe bujqësore për testime dhe kërkime të ndryshme inovative.

9.4.2. REHABILITIMI I ISTN, BETAHAUS-TIRANA

Projekti për Rehabilitimin e kësaj ndërtese ka pasur si qëllim ripërdorimin e ndërtesës ekzistuese dhe kthimin e përshtatjen e saj në një ndërtesë shumëfunktionale të përbërë nga hapësira për “co-workshping” fleksibël dhe të qëndrueshme, me salla eventesh, zyra biznesesh, punishte dhe garazhe, kafe letrare, restorant, salla trajnimesh, laboratorë dhe bibliotekë, si edhe hapësira të hapura relaksuese. Projekti ka qenë inovativ dhe ka synuar të sjellë në qytet përvojat ndërkombëtare për të mbështetur qytetarët dhe bizneset që të jenë krijuar dhe inovativë duke punuar në një hapësirë inovative sociale, duke ndarë idetë e tyre, duke ju ofruar trajnime, mbështetje dhe shërbime për zhvillimin e kompetencave në fushën e inovacionit dhe konkurrencës. Projekti ndodhet në proces zbatimi dhe po vijon puna normalisht.

9.4.3. PROJEKTI PËR ZHVILLIMIN E TURIZMIT NË LIQENIN MARINEZ, BASHKIA BELSH

Projekti për zhvillimin e turizmit në Liqenin Marinëz, turizmit në zonën turistike Seferan dhe Rehabilitimi i shtigjeve turistike që lidh Liqenet e Rahmanit - Marinës, Bashkia Belsh përfshin një hapësirë të sheshtë, të pashtuar dhe të hijëzuar. Ndërhyja në natyrë do të jetë minimale, pra përcaktimi i vëndeve të parkimit do të bëhet me pemë, të cilat do të shërbejnë edhe për hijëzim. Në liqenin e Marinës janë parashikuar të pozicionohen 9 shtëpiza druri dhe një ambient shërbimi restorant. Projekti ndodhet në proces zbatimi dhe po vijon puna normalisht.

10. ANEKSE

10.1. ANEKS 1: MIRATIMI I BUXHETIT FAKTIK SIPAS KATEGORIVE PËRKATËSE

| Nr. | Kategoria | Ishte (në mijë lekë) | Bëhet (në mijë lekë) | Ndryshimi (në mijë lekë) |
|-----|---|-------------------------|-------------------------|-----------------------------|
| 1 | Investime në Infrastrukturë | 13,695,354 | 14,053,662 | 358,308 |
| 2 | Projektim Supervizion | 702,146 | 677,931 | -24,215 |
| 3 | Konsulencë /Asistencë Teknike | 67,075 | 67,075 | - |
| 4 | Trajnime | 33,934 | 25,964 | -7,970 |
| 5 | Investime dhe paisje | 29,041 | 29,041 | - |
| 6 | Kosto operacionale miratuar Vendim KD 197, dt. 04.03.2020 | 570,496 | 570,496 | - |
| 7 | Fondi rezervë | 4,000 | 4,000 | - |
| 8 | Kosto menaxhimi e projekteve (2017-2018) | 205,719 | 205,719 | - |
| 9 | (Transferim kapital) Poli i Drejtesisë | | 790,200 | 790,200 |
| | Total | 15,307,765 | 16,424,088 | 1,116,323 |

10.2. ANEKS 2: INFORMACION MBI NUMRIN E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA SIPAS KATEGORIVE DHE PROGRAMEVE

| Nr | PROGRAMI/PROJEKTI | Nr. Marrëveshjeve/Kontratave të nënshkruara | | | Total |
|---------------|---|---|----------------------------------|-----------|------------|
| | | Punë civile | Shërbime/ Shërbime konsulence | Mallra | |
| 1 | Programi për Rindërtim dhe Zhvillim në Zonat e Prekura nga Tërmeti | 61 | 100 | 0 | 161 |
| 2 | Programi i Infrastruktura Vendore dhe Rajonale 2019-2021 | 19 | 31 | 0 | 50 |
| 3 | Projekti i Investimeve Prioritare me impakt të lartë në zhvillimin dhe promovimin e turizmit, 2018-2019 | 11 | 10 | 0 | 21 |
| 4 | Projekte nga Buxheti i Shtetit, Programe Zhvillimi, Kapitulli 01. | 18 | 27 | 0 | 45 |
| 5 | Projekti i Rrugëve Lidhëse Rajonale (BB) | 0 | 2 | 3 | 5 |
| 6 | Programi për Zhvillimin e Alpeve Shqiptare dhe Zonës Bregdetare të vendit (CEB) | 1 | 7 | 2 | 10 |
| 7 | Projekti "Immediate post-earthquake reconstruction programme activities in Albania" (Grant CEB) | 0 | 29 | 0 | 29 |
| 8 | Projekti i Rrugëve Lidhëse Rajonale (BERZH) | 2 | 1 | 0 | 3 |
| 9 | Projekti për Zhvillimin e Integruar dhe Turizmin (BB) | 0 | 5 | 2 | 7 |
| 10 | Projekti i Lumit te Vlores (Fondi Kuvajtjan) | 1 | 1 | 0 | 2 |
| 11 | Programet e financuara nga IPA, (BE) | 0 | 16 | 5 | 21 |
| 12 | Projekti "Para për punë në bashkitë Shkodër, Fier dhe Dimal" (GIZ) | 0 | 0 | 1 | 1 |
| 13 | Blerje/Shërbime per nevojat e brendshme të FSHZH-së - (Kosto operacionale) | 0 | 4 | 3 | 7 |
| Totali | | 113 | 233 | 17 | 362 |

10.3. ANEKS 3: INFORMACION MBI VLERËN E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA SIPAS KATEGORIVE DHE PROGRAMEVE

| Nr | PROGRAMI/PROJEKTI | Vlerat për kontratat e nënshkruara (Lekë me TVSH) | | | Total (Leke me TVSH) |
|---------------|---|---|------------------------------|-------------------|-----------------------|
| | | Punë civile | Shërbime/Shërbime konsulence | Mallra | |
| 1 | Programi për Rindërtim dhe Zhvillim në Zonat e Prekura nga Tërmeti | 20,068,115,090 | 386,208,040 | 0 | 20,454,323,130 |
| 2 | Programi: "Infrastruktura Vendore dhe Rajonale 2019-2021" | 4,240,668,254.68 | 265,854,786.60 | 0 | 4,506,523,041 |
| 3 | Projekti i Investimeve Prioritare me impakt të lartë në zhvillimin dhe promovimin e turizmit, 2018 - 2019 | 3,385,189,704.80 | 37,475,817.80 | 0 | 3,422,665,522 |
| 4 | Projekte nga Buxheti i Shtetit, Programe Zhvillimi, Kapitulli 01. | 4,621,282,072.11 | 78,776,603.80 | 0 | 4,700,058,676 |
| 5 | Projekti i Rrugëve Lidhëse Rajonale (BB) | 0 | 87,078,267 | 5,765,750 | 92,844,017 |
| 6 | Programi për Zhvillimin e Alpeve Shqiptare dhe Zonës Bregdetare të vendit (CEB) | 21,078,456 | 91,417,307 | 3,328,282 | 115,824,045 |
| 7 | Projekti "Immediate post-earthquake reconstruction programme activities in Albania" (Grant CEB) | 0 | 58,897,582 | 0 | 58,897,582 |
| 8 | Projekti i Rrugëve Lidhëse Rajonale (BERZH) | 2,841,032,686 | 118,339,200 | 0 | 2,959,371,886 |
| 9 | Projekti për Zhvillimin e Integruar dhe Turizmin (BB) | 0 | 106,013,116 | 1,223,852 | 107,236,968 |
| 10 | Projekti i Lumit te Vlores (F.Kuvajtjan) | 3,540,036.16 | 71,252,345 | 0 | 74,792,382 |
| 11 | Programet e financuara nga IPA, (BE) | 0 | 36,729,153 | 5,375,715 | 42,104,868 |
| 12 | Projekti "Para për punë në bashkitë Shkodër, Fier dhe Dimal" (GIZ) | 0 | 0 | 3,779,400 | 3,779,400 |
| 13 | Blerje/Shërbime per nevojat e brendshme të FSHZH-së - (Kosto operacionale) | 0 | 24,648,983 | 14,756,840 | 39,405,823 |
| Totali | | 35,180,906,300 | 1,362,691,201 | 34,229,839 | 36,577,827,340 |